Kelmendi, në librin e tij "Sfidat e radhës", u shërbehet lexuesve me një realizëm të ashpër, por jo të rreptësuar kot si koti. (...) Ndryshe nga analistët e Shqipërisë shtetërore, të cilët, për shkak të një realiteti pak më ndryshe, të njëjtat probleme i shtrojnë kryesisht si çështje të përsosjes së demokracisë dhe të forcimit të shtetit të së drejtës, I. Kelmendi me të drejtë trembet që korruptimi i një pjese të klasës qeverisëse në Kosovë mund të shpjerë deri tek korruptimi të paktën i përkohshëm i së drejtës për shtetësinë.

Prof. Dr. Shaban Sinani

Duke zbardhë proceset politike në Kosovë gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, autori lehtësisht zhvesh konceptin e elitës politike deri ne palcë, me qëllim që të komunikohet me lehtë me të, jo nga pozita e nënshtrimit, por duke e edukuar fillimisht atë elitë, e po ashtu, në të njëjtën kohë, edhe qytetarin politik shqiptarë. Qytetarit politik ia mëson hapat e parë të ecjes nëpër "teh të shtetit", shpesh duke e qortuar atë lidhur me atë se si duhet qas shtet-bërjes kosovare. I. Kelmendi assesi nuk ka për qëllim, ti qesin lexuesit "vetën nga qejfi", por, përkundrazi ti shtojë atij vetëbesimin e duhur jo më si lexues, por si individ politik që në mënyrë sa më sovrane të kacafytet me devijime që bëjnë politikanët në emër të shtetit.

Prof. Dr. Martin Berishaj

Që Ibrahim Kelmendit i pëlqejnë sfidat dhe të fton të debatosh rreth tyre, kjo është tashmë një gjë që dihet. Kjo është në natyrën e tij, ndoshta e gjithë jeta e tij politike ka kaluar përmes sfidash. Tani vjen një ditë që Kelmendi shtron në fushën e ideve "Sfidat e Kohës", si pjesë e qenësishme e mënyrës së tij të të menduarit dhe të të konceptuarit të punëve, të gjërave, të së shkuarës dhe të asaj që do të vijë. "Sfidat e radhës" është një libër që dëshmon edhe një herë se sa fort dhe sa kuptueshëm, nganjëherë deri në dhimbje, e do Kelmendi vendin e tij, i do njerëzit e tij. Shumë njerëz, edhe ata që të njohin, do të ndjehen disi të habitur. Sepse kanë pritur prej Kelmendit më shume mërzi në libër, ngaqë, jo rrallë, e matin me kutin e tyre. Do të ketë njerëz që do të thonë se "çfarë i duhet", "çfarë fiton", do të ketë të tjerë që do të llogaritin se "kujt ia ka futur" dhe "cilin ka marrë në mbrojtje".

Bedri Islami

ISBN 978-9951-8503-1-5

Çmimi: 1.- €

IBRAHIM KELMENDI • SFIDAT E RADHËS

IBRAHIM KELMENDI

SFIDAT E RADHËS

(KOSOVA: RRUGA E MUNDIMSHME DREJT SHTETIT)

RECENSIONE / VLERËSIME:

- Prof. dr. Shaban Sinani
- Prof. Dr. Martin Berishaj
- Valbona Myteveli M.A.
- Bedri Islami
- Shpend Vinca
- Xhevat Ukshini
- Mr. Hajdin Abazi
- Mehrije (Daci) Haxhisefa
- Hajdar Muneka
- Ekrem Krasniqi
- Rexhë Iberdemaj
- Salih Kabashi
- Prof. A. Vinca
- Ulmar Qvick
- Fatos Aliu
- Prof. Nexhmedin Spahiu

Ibrahim Kelmendi

SFIDAT E RADHËS

(Kosova: rruga e mundimshme drejt shtetit)

Recensione / vlerësime:

- Prof. dr. Shaban Sinani (Tiranë)
- Prof. Dr. Martin Berishaj (Lublanë)
- Valbona Myteveli M.A. (Gjermani)
- Bedri Islami (Gjermani)
- Shpend Vinca (Strugë)
- Xhevat Ukshini (Gjermani)
- Mr. Hajdin Abazi (Prishtinë)
- Mehrije (Daci) Haxhisefa
- Hajdar Muneka (Kuala Lampur, Malajzi)
- Ekrem Krasniqi (Bruksel)
- Rexhë Iberdemaj (Gjermani)
- Salih Kabashi
- Prof. A. Vinca (Prishtinë)
- Ulmar Qvick (shkrimtar suedez)
- Fatos Aliu (Prishtinë)
- Prof. Nexhmedin Spahiu

Shaban Sinani - Redaktues / Recensues

Faqosje - Desingnhouse, Prishtinë

Botues: Gazeta “Epoka e re”, Prishtinë, 2008

© Ibrahim Kelmendi, 2008

ISBN 978-9951-8503-1-5

PËRMBAJTJA:

SHQETËSIMET DHE SFIDAT E RADHËS 5

1. Shtet-bërja dhe shtet-ndërtimi 7
1.a. Bashkështetasit tanë serbë për momentin janë penguesit kryesorë të shtet-bërjes e të shtet-ndërtimit. 10
1.b. Edhe disa bashkështetas shqiptarë janë pengesë serioze për shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin 17
1.c. Krimi i organizuar vështirëson seriozisht shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin. 21
1.d. Korrupsioni "shtetëror" kundërshtar shumë serioz i shtet-bërjes, i shtet-ndërtimit dhe i zhvillimit ekonomik... 26
1.e. Vonesa e mosnjohjes nga shumica e shteteve të botës dhe vonesa e mos-anëtarësimit në OKB, po e vështirëson shtet-bërjen, por kjo nuk duhet të na alarmojë 33
1.f. Insistimi i tashëm për të pasur ushtri-armatë, më shumë e dëmton shtet-bërjen e Republikës së Kosovës. 35
2. Zhvillimi demokratik 38
2.a. Rrugëtimi i demokracisë. 38
2.b. Profilizimi, demokratizimi e rritja e partive politike përshpejtojnë shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin. 50
2.c. Mënyrat dhe kriteriet e qasjes ndaj të kaluarës. 57
2.d. Gjallërimi i shoqërisë civile (qytetare) faktor tjetër me rëndësi për zhvillim demokratik. 62
3. Zhvillimi ekonomik: 67
3.a. Energjia elektrike duhet të jetë orientim kryesor për zhvillim të përshpejtuar ekonomik. 71
3.b. Nxjerrja dhe industria përpunuese e xeheve. 80

3.c. Firmat e mesme janë shpirti i zhvillimit të përshpejtuar 82
3.d. Rigjallërimi dhe zhvillimi i hovshëm i bujqësisë dhe i blegtorisë është tepër i domosdoshëm. 85
3.e. Bankat dhe firmat e sigurimeve duhet të disiplinohen..... 92
3.f. Shëndetësia tashmë po menaxhohet si biznes, prandaj duhet të reformohet. 95
3.g. Roli i emigracionit në zhvillimin e përshpejtuar 99

Për mbyllje: Katarsis ("pastrim i shpirtit") 102

RECENSIONE E VLERËSIME PËR "SFIDAT E RADHËS" 108

- **Prof. dr. Shaban Sinani (Tiranë)** 109
- **Prof. Dr. Martin Berishaj (Lublanë)** 115
- **Valbona Myteveli M.A. (Gjermani)** 119
- **Bedri Islami (Gjermani)** 122
- **Shpend Vinca (Strugë)** 129
- **Xhevat Ukshini (Gjermani)** 133
- **Mr. Hajdin Abazi (Prishtinë)** 141
- **Mehrije (Daci) Haxhisefa** 142
- **Hajdar Muneka (Kuala Lampur, Malajzi)** 146
- **Ekrem Krasniqi (Bruksel)** 148
- **Rexhë Iberdemaj (Nyrnberg, Gjermani)** 150
- **Salih Kabashi** 154
- **Prof. A. Vinca (Prishtinë)** 155
- **Ulmar Qvick (shkrimtar suedez)** 156
- **Fatos Aliu (Prishtinë)** 157
- **Prof. Nexhmedin Spahiu**..... 159

SFIDAT E RADHËS

Sakrificat dhe përpjekjet e popullit tonë, ndërhyrja e forcave të NATO-s, veçmas përkrahja e SHBA-ve dhe e shteteve të Perëndimit për të shpëtuar popullin tonë nga gjenocidi serb, na ndihmuan, më në fund, të bëjmë shtetin tonë - Republikën e Kosovës. Kjo është fitore vërtet e madhe.

Populli shqiptar i kësaj hapësire ishte i pushtuar me shekuj. Po të numëronim të gjithë pushtuesit, që kanë përzënë njëri-tjetrin në hapësirën tonë, mbase do na merrej fryma. Dhe vërtet është një mrekulli e llojit të vet, se si populli ynë në këtë hapësirë, ka arritur të mbijetojë e të mos asimilohet i tëri.

Për nivelin e angazhimit kolektiv dhe individual për të arritur deri të pavarësimi i tanishëm shtetëror, është folur e shkruar goxha shumë, por edhe për ata që nuk janë angazhuar ose që kanë qenë kundër. Herë me vërtetësi e herë kuturu. Varësisht nga këndvështrimi. Asgjë e veçantë. Edhe historitë e popujve të tjerë janë pothuajse të ngjashme. Dallojnë sidomos për faktin se shumë popuj pavarësimin e tyre shtetëror e kanë arritur në mënyrën e tyre më herët dhe shumë më herët. Por, fatkeqësisht, ka ende popuj që mbahen të pushtuar.

Për përkrahjen dhe ndihmën që na kanë dhënë, sidomos shtetet e zhvilluara demokratike të Perëndimit, në këtë proces vendimtar, ende nuk janë bërë analiza të gjithanshme. Këto duhet dhe kanë për t'u bërë në të ardhmen. Megjithëkëtë është bindja ime se NATO-ja nuk ndërhyri ushtarakisht për të ndalur gjenocidin serb në Kosovë për interesa të ngushta kolonialiste, siç ndodhte në të kaluarën, as edhe për dofarë interesash strategjike. Them kështu pasi më rastis të lexoj e të dëgjoj mendime të njëanshme, se gjoja Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-ja, kanë ndërhyrë në Kosovë për interesa të tyre strategjike.

Kësaj radhe këto shtete ndërhynë thjesht për të penguar katastrofën humanitare, pasi gjenocidi serbomadh i atyre përmasave nuk mund të tolerohej e pranohej më në Evropë, si në kohë të shkuara.

Edhe për fatin, i cili kësaj radhe ishte në anën tonë, mbase do të shkruhet, sidomos kur do të kemi parasysh se kemi pasur potencial që të angazhohemi edhe më shumë, por nuk jemi angazhuar e nuk kemi vepruar bollshëm, që të mobilizojmë gjithë energjitë e popullit tonë. Megjithatë fati na ndihmoi kësaj radhe dhe Kosova u pavarësua. Ndonjëherë kam menduar se fatin na e dërgoi Zoti, meqë i erdhi keq për ne fatkëqijtë e deridjeshëm dhe prandaj shpërbleu shumëfish përpjekjet e angazhimet çlirimtare të popullit tonë, na shpërbleu, sidomos për hir të sakrificave të mëdha njerëzore.

Gjithsesi duhet të jemi të lumtur dhe këtë lumturi tani nuk duhet të na e turbullojë as ndonjë garë e individëve e rrahagjoksëve se kanë dhënë kontribut më shumë se të tjerët. Në mos tjetër, historia do të vlerësojë meritat e secilit, nga se, po vlerësuam veten tonë, ne aktorët e përjetuesit e ngjarjeve, druaj se do të ishim tepër subjektiv. Tani prej nesh do kërkohej që të rrëfenim sa më sinqerisht për angazhimet e përjetimet tona dhe t'ua lëmë ato si informim pasardhësve që t'i bëjnë (ç)vlerësimet.

Për momentin nuk kemi kohë dhe nevojë që të harxhojmë shumë energji duke u marrë teprueshëm me të kaluarën. Mjafton të merremi vetëm aq sa është e nevojshme, për të ditur se **si** kemi ardhur deri këtu, që t' ia qëllojmë sa më mirë se **si** do të ecim drejt të ardhmes. Dhe që t' ia qëllojmë sa më mirë, duhet të përcaktohemi për prioritete, të cilat, unë, kësaj radhe, po i quaj paksa në gjuhë poetike: *sfidat (përballjet) e radhës*.

Si sfidat aktuale dhe kryesore të radhës do i veçoja tri:

1) Shtet-bërja dhe shtet-ndërtimi;
2) Zhvillimi demokratik;
3) Zhvillimi ekonomik.

1. SHTET-BËRJA DHE SHTET-NDËRTIMI

Tashmë u bëmë me shtet konkret, të cilin, edhe për aq sa e kemi, mund ta ndiejmë e ta prekim. Të gjithë i jemi gëzuar kësaj fitoreje. Janë gëzuar edhe ata që më herët nuk angazhoheshin për të. Shumë mirë edhe kjo. Gëzimin nuk na e kanë zbehur shumë as përfoljet, analizat, garat, se shtetin mund ta kishim bërë më herët, se mund ta kishim bërë më mirë, se ndonjëri ka merita më shumë se sa tjetri, etj. Gjithandej ka të vërteta, gjysmë të vërteta dhe spekulime të gjithëllojshme. Mirë që nuk ndrydhen mendimet dhe as spekulimet e individëve. Kjo është dëshmi e parë e lirisë se të menduarit dhe të shprehurit në shtetin tonë, gjegjësisht një dëshmi fragmentare e demokracisë pluraliste. Gëzimin nuk do të na e zbehë shumë as fakti se shtetin tonë ende nuk e kemi bërë krejtësisht të pavarur dhe sovran. Jemi në rrugë të mbarë dhe të pakthim për ta bërë shumë shpejt. Për këtë na ngushëllon edhe fakti se pothuajse asnjë shtet i botës më nuk është plotësisht i pavarur dhe sovran, pasi zhvillimet e hovshme teknologjike, informative e shoqërore e kanë shndërruar planetin tonë në një *fshat të vogël*, siç po praktikohet të thuhet në mënyrë simbolike. Synimi ynë i përgjithshëm, se **sa**, **kur** dhe **si** mund ta bëjmë shtetin tonë sa më të pavarur dhe sa më sovran, na bënë që të jemi më konstruktiv, më optimistë, më të përmbajtur dhe më pak euforikë. Por kemi sa të duash edhe kritikë e skeptikë ndaj shtet-bërjes dhe shtet-ndërtimit tonë. Ata druajnë dhe kritikojnë, se realizimin e pavarësisë e të sovranitetit nuk po e bëjmë shpejt, sa duhet dhe si duhet. Edhe këta kanë të drejtë nga këndvështrimi i tyre. Kurse analizat nga këndvështrimi im më rezultojnë: Kështu e kaq ditëm e mundëm, po të kishim ditur më mirë, po të kishim mundur më shumë, nuk do ishim kaq të vonuar dhe nuk do kishim këtë gjendje. Prandaj analizat duhet të kenë për bazë mundësitë e rrethanat reale në kohë e hapësirë e jo dëshirat.

Fakt është që deri tani nuk kemi ditur e nuk kemi mundur të realizojmë shtet gjithëkombëtar, të pavarur e sovran, në nivel të

dëshiruar e të synuar. Kishim një gjysmë-shtet të pavarur, Shqipërinë "londineze" (nga viti 1913), kurse sa i përket Kosovës, tek tani ia arritëm të mvtetësojmë. Që do të thotë: nuk kishim shtet më se dy mijë vjet, kishim një Shtet të tkurrur (Shqipërinë) dhe kishim një Kosovë si *krahinë*, para gjashtëdhjetë vjetësh, pastaj autonomi federative në kuadër të ish-Jugosllavisë, para tridhjetë e katër vjetësh, shtet virtual pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë (1991) dhe tek tani po bëjmë shtet konkret. Plotësisht të pavarur e sovran nuk do ta kemi as pas 15 qershorit, kur fuqizuam **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**. Por, edhe kaq sa e kemi, sigurisht që i gëzohemi, pasi jemi të bindur se ia kemi vënë themelet e sigurta. Sidomos njohja e Republikës së Kosovës nga të gjitha shtetet më të zhvilluara demokratike dhe nga ndonjë shtet që nuk është gjithaq i zhvilluar e demokratik, është një garanci e fortë se shteti ynë po shkon drejtë realizimit të plotë. Nuk duhet të na dëshpërojë shumë as mosnjohja e menjëhershme nga të gjitha shtetet dhe as mos-anëtarësimi i shpejtë në OKB, sepse ka nga ato shtete që parapëlqejnë sistemin nacionalist e etatist serb, ka nga ato shtete ku sundimtarët nuk duan t'ia dinë për liritë dhe për të drejtat e njeriut dhe të popujve. Nuk duhet të na dekurajojë as Rezoluta e Asamblesë së OKB-së, që pavarësimit të Kosovës t'i bëhet gjyq ndërkombëtar. Mbase kjo mund të na dal për mbarë, sepse shpeshherë planifikimet dhe bëmat obstruksioniste e nacionaliste antishqiptare të serbëve nacionalistë u janë kthyer atyre si bumerang(?).

Për ngushëllim për mos-anëtarësim të deritanishëm në OKB do të duhej të kemi parasysh Tajvanin. Për shumë dekada nuk e kanë njohur shumë shtete të botës dhe, për rrjedhojë, nuk është as anëtare në OKB, kryesisht për shkak të qëndrimit dhe pretendimit të Kinës. Por unë, sigurisht edhe shumë banorë të Kinës, më parë do të kishim pranuar të jetonim në Tajvanin "e panjohur" si shtet e si anëtar të OKB-së, se sa në Kinën sovrane, superfuqi e shtet me të drejtë vetoje në Këshillin e Sigurimit.

Edhe pse e kemi këtë shtet, me pavarësi e sovranitet të kufizuar, nuk do duhej të hutohemi që ta vlerësonim si të vetëmjaftueshëm dhe

të sigurt. Shteti ynë është në sprovë. Duhet ta bëjmë e ta ndërtojmë që të jetë i mjaftueshëm dhe i vlefshëm së pari për vetë shtetasit e tij, por edhe për të plotësuar kriteret që i kërkojnë nga ne, sidomos shtetet që e kanë njohur shtetin tonë. Nuk guxojmë të zhgënjejmë vetën tonë, dhe as miqtë, që po na përkrahin e ndihmojnë që të bëjmë shtet sa më të konsoliduar në aspektin e zhvillimit demokratik, ekonomik, social, kulturor, me një fjalë që të bëjmë shtet sa më të qytetëruar. Prandaj duhet të vetëdijesohemi, sa më shumë që të jetë e mundur, për përgjegjësitë tona konstruktive në kohë dhe hapësirë.

Shteti është "produkt" i mundësive dhe i marrëveshjes së qyteta-rëve të tij, është kontratë kolektive për formë të bashkëjetesës e të organizimit, por është i kushtëzuar edhe nga njohja ndërkombëtare. Prandaj secili duhet të respektojë këtë proces, dhe të angazhohet për ndërtimin e për përparimin e shtetit tonë, siç interesohet **njeriu** për të krijuar familje dhe për të ndërtuar shtëpi të tij.

Do të ishte idealizëm iluzionist sikur të prisnim që secili bashkë-shtetas menjëherë ta mirëpriste formimin e këtij shteti dhe secili të angazhohej maksimalisht për ndërtimin e zhvillimin e mbarë të tij. Çdo shtet i botës ka banorë pasiv të tij, por gjithsesi ka edhe kundërshtarë të brendshëm dhe të jashtëm. Numri i banorëve pasivë zvogëlohet në raport me zhvillimin e shtetit që prodhon rritje të mirëqenies sociale dhe rritje të vetëdijes qytetare të shtetasve. Edhe numri i kundërshtarëve të brendshëm e të jashtëm bie në raport me nivelin e ndërtimit e të zhvillimit demokratik, ekonomik e shoqëror të shtetit.

Aktualisht ne nuk mund të ndërtojmë shtetin tonë sipas dëshirave, bindjeve dhe përcaktimeve tona, sepse jam i mendimit që nuk do të dinim dhe nuk do të mundnim, nuk kemi përvojë dhe kapacitete për të qenë në gjendje të ndërtojmë menjëherë shtet të zhvilluar demokratik. Por këto deficite po na i kompensojnë përkrahësit e shtetit tonë - shtetet e zhvilluara demokratike (kryesisht ato të Aleancës Veri-Atlantike, të G7, të BE-sw, etj.). Lum si ne që këto shtete po na ndihmojnë e po e mbikëqyrin ndërtimin e shtetit tonë!

1.a. Bashkështetasit tanë serbë për momentin janë penguesit kryesorë të shtet-bërjes dhe të shtet-ndërtimit.

Për momentin kundërshtuesit më me ndikim të shtet-bërjes dhe shtet-ndërtimit të shtetit tonë të përbashkët janë pothuajse të gjithë bashkështetasit tanë serbë. Sigurisht kundërshtues ka edhe pak bashkështetas shqiptarë, por ata nuk po e bëjnë publik kundërshtimin e tyre. Bashkështetasit tanë serbë janë kundër, sepse ashtu janë "të ndërtuar" në shekuj dhe aktualisht atë "ndërtim" po ua nxit e shpërdoron klasa politike nacionaliste e Beogradit. Që t'i sqarojmë, bindim e kthjellojmë bashkështetasit tanë serbë për bashkëjetesë dhe të kundërshtojmë angazhimin nacionalist të Beogradit, ne, bashkështetasit shqiptarë, sikur nuk jemi angazhuar si e sa duhet që kur Kosova u çlirua nga pushtimi serb. Bashkështetasve tanë serbë nuk u kemi ofruar, mjaftueshëm e bindshëm bashkëjetesë, siguri e perspektivë, të paktën jo në ato përmasa sa ta bindim shumicën e tyre për bashkëjetesë. Disa shqiptarë, të frustruar nga Lufta; disa shqiptarë, post-trima dhe patriotë njëdimensionalë, i fajësuan kolektivvisht bashkështetasit tanë serbë për gjenocidin shtetëror serb ndaj popullit tonë. Në disa raste ata nuk u përmbajtën as nga hakmarrja individuale ndaj ndonjë serbi të pambrojtur. Por rastet fatmirësisht ishin të pakta, po të bënim krahasime me çka kishin përjetuar shqiptarët nga terrori shtetëror serb pak kohë më parë. Gjithsesi, edhe po t'i mbajmë parasysh ato rrethana, rastet e hakmarrjeve ishin të tepërta, ishin jonjerëzore, ishin raste kriminale dhe assesi nuk ishin as në interesin tonë kombëtar e politik. Në rrethana të tilla të pas-luftës as Beogradi nuk vetëpërmbahej nga kryerja e ndonjë krimi makabër ndaj bashkështetasve tanë serbë, që pastaj t'ua mvishte e të akuzonte shqiptarët. Të përmendim rastin e fëmijëve serbë në fshatin Grozhdec të Pejës, rastin e liderit serb Momçillo Trajkoviqit, rastin e krimit makabër në Fushë-Kosovë, etj., të cilat, jam për momentin jam i bindur, se i kanë planifikuar dhe kryer kriminelët serbë, të organizuar nga shërbimet e ndryshme të fshehta të Beogradit. Tanimë është bërë

e qartë edhe për më naivët se qeveria e Beogradit nuk ka hezituar të planifikojë e të kryejë krime në emër të interesa madhore kombëtare e shtetërore serbe, për të alarmuar Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe "për t'i treguar" opinionit ndërkombëtar: "Ja ç'bëjnë shqiptarët, ata që i mbrojtët JU". Qe bërë praktikë tepër e dyshimtë: Sa herë që paralajmërohej ardhja për vizitë e ndonjë personalit të Brukselit në Prishtinë, ndaj minoritarëve serbë ndodhte ndonjë krim i rëndë. Beogradi sforconte lajmet eksplozive për krimin e ndodhur, të cilat lajme alarmante ngjanin të kishin qenë të parapërgatitura. Për ilustrim konkret po sjell një shembull: Pak orë para se të arrinte Komisioneri Evropian Havier Solana në Prishtinë, Momqillo Trajkoviq (atëherë lideri kryesor serb në Kosovë), largoi badigardet e UNMIK-ut. Pak qaste para se Solana të arrinte në Aeroport të Prishtinës, ndodhi plagosja e Trajkoviçit në këmbë. Shqetësim i jashtëzakonshëm, fajësime të sforcuara ndaj nacionalistëve shqiptarë, edhe pse nuk ishte kapur dorasi. Fajësime të sforcuara ndaj gjithë Kosovës. Kryeadministratori Kushner (Couchner) u paraqit tepër nervoz dhe i hidhëruar para gazetarëve dhe kamerave, shprehu e shfaqi gjithë hidhërimin e tij për pabesinë që i kishin bërë shqiptarët me atë sulm plagosës ndaj liderit serb Trajkoviç. Pasuan prononcime nervoze e hidhëruese edhe të Komisionerit Solana. Pasdite Kushner na mori me vete në aeroplan mua dhe Bardhyl Mahmutin për në Paris. Gjatë fluturimit, nga hidhërimi, Kushner nuk po fliste me ne. Tjetër njeri nuk kishim me vete, pos anëtarët e ekuipazhit. Pas disa momenteve iu drejtova Kushnerit, duke i thënë se nuk kishte përse të ishte i hidhëruar ndaj nesh që të mos na fliste. Ai u arsyetua me hidhërimin e madh që kishte ndaj shqiptarëve për atë pabesi që i kishin bërë në prag të vizitës se Solanës. I thash se atë akt kriminal e kishin inskenuar dhe bërë nacionalistët e specializuar serbë. Me kundërshtoi, duke me kërkuar argument. Iu përgjigja, se nuk kisha mundësi të siguroj argumente, pasi nuk mund urdhëroja që Trajkoviçi të hulumtohet nëse paraprakisht i kanë bërë anestezi lokale, në vendin ku e kanë plagosur. Përndryshe, - i thoja Kushnerit, - po të ishte shqiptar ai që ka shtënë, do ia zbrazte gjithë plumbat në gjoks dhe jo vetëm një plumb në tul të

këmbës. Heshti dhe ra në mendim. Shkoi në kabinë të pilotëve. Urdhëroi që andaj t'i bëhej analiza Trajkoviçit. Mëpastaj u relaksua pakësa, meqë dukej që qe bindur për këtë variant që i shfaqa. Pas rreth dy orëve erdhi njëri nga kabina për dhe i tha diç që ne nuk mundëm ta dëgjonim. Ngjau sikur Kushner qe sqaruar... Mëpastaj Trajkoviq iku nga skena e liderizmit serb... Megjithatë, inskenimi, krimi dhe propaganda serbe arrinin efektin që duhet ta kishin paraplanifikuar, si në ketë rast, edhe në shumë raste të tjera. Fatkeqësisht as UNMIK-u nuk ishte i vendosur për t'i zbardhur ato krime dhe për të kapur e dënuar kriminelët, ose ndoshta i zbardhte, por i heshtte, për të mos nervozuar Beogradin e tërbuar. Por të shpresojmë se tani organet tona përkatëse, do të duan dhe do të mundin, të ndihmuara edhe nga EULEX që me vonesë po "akomodohet" në Kosovë, t'i zbardhin një për një ato raste dhe kriminelet të dënohen meritueshëm.

Edhe tani, shumica e shtet-bërësve dhe shtet-formuesve shqip-tarë po vazhdojnë t'i kundrojnë, t'i mirëkuptojnë e t'i tolerojnë bashkështetasit tonë kundërshtues serbë. Ndaj tyre qeveritarët tanë po sillen me tolerancë të arsyeshme, duke mos rënë në grackën e provokimeve të ndryshme, meqë e kanë kuptuar se është në interes të shtet-bërjes e të shtet-ndërtimit të shtetit tonë, është në interes të sigurisë, të paqes dhe të ardhmërisë sonë të përbashkët. Më në fund është në interes të paqes në rajon krijimi i një klime në përputhje me synimet dhe rrjedhat e botës së qytetëruar. Për këtë arsye bashkështetasve tanë serbë duhet t'u japim ende kohë që të kuptojnë se cila është ardhmëria e tyre në Republikën e Kosovës. Atyre duhet t'u japim kohë që të kuptojnë realitetin e ri. Atyre duhet t'u japim kohë që të kuptojnë se është edhe në interes të tyre që të çlirohen nga privilegjet e të kaluarës si pushtues e sundimtarë dhe t'i kthehen së ardhmes - bashkëjetesës së barabartë si bashkëqytetarë.

Ne i vlerësojmë dhe i çmojmë të gjithë serbët etnikë të Kosovës me të cilët kemi bashkëjetuar me shekuj në Kosovë. Ne respektojmë edhe të drejtat e serbëve kolonistë, të cilët qeveria mbretërore e Beogradit i kishte sjellë në Kosovë, në kuadër të politikës kolonizuese e serbizuese të Kosovës, në vitet 1912-1941, mëpastaj qeveria komuniste serbe në

vitet 19945-1990. Kurse serbët që pushteti i Millosheviqit i ka sjellë në Kosovë pas vitit 1990 mendoj se nuk duhet të gëzojnë me "automatizëm" (*ipso iure*) të drejtë shtetësie. Arsyetimet për këtë përcaktim mbase dihen. Serbia ia pat suspenduar Kosovës, me dhunë, atë farë autonomie që kishte, në vitin 1989 dhe pastaj ajo përzuri pothuajse të gjithë të punësuarit shqiptarë, duke sjellë në vend të tyre punëtorë, policë e administratorë serbë, një pjesë e të cilëve ishin refugjatë serbë nga Bosnja e Kroacia.

E drejta e shtetësisë duhet t'u njihet me "automatizëm" të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës, po vetëkuptohet, edhe të gjithë refugjatëve dhe emigrantëve shqiptarë, serbë e të tjerëve refugjatë minoritarë të Kosovës, të cilët kanë jetuar para vitit 1990 në Kosovë ose si refugjatë të pëndjekur në Evropën Perëndijore e shtete të tjera. E dihet se kemi shumë më tepër refugjatë shqiptarë se sa refugjatë serbë, por për kthimin e refugjatëve shqiptarë në Kosovë as që po flitet tani. Kurse të gjithë atyre që janë vendosur në Kosovë pas vitit 1990, por që pretendojnë tani të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, nuk duhet t'u njihet shtetësia me "automatizëm" dhe kjo duhet të saktësohet e të sanksionohet në ligjin për shtetësinë.

Bashkështetasit tanë serbë duhet t'i përkrahim e t'i ndihmojmë që të kthehen në tokat, shtëpitë e banesat e tyre, duke u premtuar fqinjësi njerëzore dhe duke u garantuar se do trajtohen si bashkë-qytetarë të barabartë. Në aspektin juridik shteti ynë u ka siguruar, me Kushtetutë dhe me ligje përkatëse, të drejta sociale, kulturore e kombëtare, siç nuk i janë garantuar asnjë minoriteti në botë. Kosova është shembull unik në botë për këto të drejta që u janë rezervuar e garantuar minoritetit serb dhe minoritarëve të tjerë. Mjafton vetëm të bëjmë një krahasim me shtetin fqinj të Republikës së Maqedonisë dhe do të shohim se sa më shumë të drejta u janë rezervuar e garantuar serbëve në Kosovë në krahasim me të drejtat që kanë shqiptarët në Maqedoni. Në Maqedoni mbi 35 për qind e popullsisë janë shqiptare etnikë. Ata nuk i kanë as 50 për qind të drejtave që ka popullsia serbe, e cila përbën vetëm rreth 5 për qind të popullsisë së Republikës së Kosovës. Bile, shqiptarët

në Maqedoni, nuk gëzojnë të drejta gjuhësore e kombëtare as edhe sa rreth 10 mijë minoritarë turq në Kosovë. Edhe më pak të drejta kanë shqiptarët në Serbi, që numerikisht janë më shumë se sa numri i serbëve në Kosovë. Pakuptueshëm në Kosovë po hezitohet të paraqiten këto krahasime, të cilat dëshmojnë se në shtetin tonë minoritetet kanë shumë herë më tepër të drejta se sa ato të drejta që kanë shqiptarët në Maqedoni dhe në Serbi dhe në shtetet e tjera fqinje.

Tani duhet të shtrohet pyetja: Ç'duhet bërë nëse bashkështetasit tanë serbë, për kohë të gjatë, nuk duan të pranojnë realitetin e ri - njohjen e Republikës së Kosovës dhe bashkëjetesën e barabartë në shtetin tonë të përbashkët? Cila është zgjidhja në këtë rast?

Mendoj se zgjidhja më e shpejtë dhe më fatlume është demokrati-zimi i përshpejtuar i Serbisë, për çka po përpiqen Brukseli dhe Uashingtoni, ndonjëherë edhe me tepri naive. Lidhjet nacionaliste "shpirtërore" të Serbisë me Moskën po dalin më të fuqishme se sa privilegjet dhe ndihmat politike e financiare që po i ofrojnë Brukseli e Uashingtoni Beogradit. Këto privilegje që po i ofrojnë Brukseli e Uashingtoni po e llastojnë Beogradin nacionalist, i cili, qe shumë dekada, po shpërdoron ndihmën që i ka dhënë Perëndimi. Meqë ne jemi të pafuqishëm që të ndikojmë në marrëdhëniet e Brukselit dhe Uashingtonit me Beogradin, na mbetet që të presim e të shpresojmë se Beogradi do të demokratizohet sa më shpejt dhe rrjedhimisht, do të përcaktohet sa më shpejt për të njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës. Edhe subjektet tona partiake do të duhej të provonin që të bashkëpunonin me partitë politike në Serbi, sidomos me ato që kanë orientime e përcaktime demokratike. Kjo do të kishte dobi reciproke, sidomos në fushën e zbutjes së paragjykimeve.

Ne nuk duhet të përpiqemi t'i detyrojmë me çdo kusht bashkështetasit serbë që ta njohin Republikën e Kosovës dhe as që t'i mbajmë përdhunshëm në Kosovë, por duhet t'i privilegjojmë ata që ofrojnë luajalitetin e tyre për bashkëjetesë të barabartë, kurse kategorinë e dytë, e cila do të tolerojë realitetin e ri, duhet ta ndihmojmë që të integrohet. Serbët ekstremistë duhet t'i lirojmë nga detyrimi që të

jetojnë në Republikën e Kosovës, nëse nuk dëshirojnë. Këta të fundit nuk duhet t'i lusim me tepri që të rrinë këtu dhe nuk duhet t'i tolerojmë që të bëjnë veprimtari të dhunshme nacionaliste, sepse, kështu, ata do e shpërdorojnë tolerancën tonë dhe do të organizojnë trazira për përfitime nacionaliste e individuale. Mbase ka edhe alternativa të tjera më praktike e më pragmatike. Për këtë duhet të mendojnë e të angazhohen institucionet shtetërore dhe gjithë shoqëria. Koha po punon në favor të zgjidhjes paqësore të këtij problemi dhe toleranca jonë edhe në këtë rast do të shpërblehet.

Për momentin me këtë problematikë serioze duhet të merret më shumë bashkësia ndërkombëtare, e cila po dëshmon se nuk është zonja ose se nuk është vendosur që të angazhohet sa e si duhet për ta zgjidhur këtë problem. Bashkësia ndërkombëtare ishte e orientuar që ndaj shqiptarëve të praktikonte të ashtuquajturin "diskriminim pozitiv", me mendimin se kështu do të josheshin serbët e Kosovës që të pranonin më shpejt bashkëjetesën në Republikën e Kosovës. Kjo praktikë nuk dha rezultate. Tashmë edhe strukturat ndërkombëtare (UNMIK, KFOR, OSBE, etj.) duhet të jenë bindur se kanë gabuar që kanë toleruar armatosjen e serbëve në enklava, organizimin e tyre nacionalist në njësi paramilitare dhe organizimin e "pushtetit paralel". Sidomos KFOR-i gaboi që nuk e kontrolloi mjaftueshëm kufirin verior të Republikës së Kosovës për të përmbushur detyrimin në mbrojtje të sigurisë tërësore të Kosovës. Tani strukturat shtetërore të Republikës së Kosovës do të duhet të kërkojnë më me ngulm, sidomos nga KFOR-i, mëpastaj edhe nga EULEX, që të përmbushin premtimin dhe përcaktimin e tyre për mbrojtjen e kufijve të Kosovës dhe për të çarmatosur njësitë e organizuara nacionaliste serbe në enklava.

Qëndrimi nacionalist i serbëve të Kosovës dhe i Beogradit po e vështirësojnë shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin e Republikës së Kosovës edhe në aspektin ekonomik, që është faktor me rëndësi për ndërtimin e zhvillimin e shtetit. Nga Serbia po hyjnë në Kosovë ilegalisht mallra me shumicë, pa doganë dhe pa *tatim në vlerën e shtuar (tvsh)*. Ato mallra po konkurrojnë padrejtësisht prodhimin vendës dhe mallrat që po

importohen me doganë dhe *tvsh* nga shtetet e tjera. Meqë për momentin shteti i Kosovës nuk po është në gjendje t'i ndalojë e t'i kontrollojë këto hyrje ilegale, atëherë qytetarët duhet të vendosin që të mos i konsumojnë këto mallra të Serbisë. Kjo do të ishte metodë më efektive për momentin. Shqiptarët që po tregtojnë mallra serbe, të futura ilegalisht në Kosovë, janë kundërshtues të shtet-bërjes e shtet-ndërtimit, njësoj si edhe ekstremistët nacionalistë serbë. Kurse edhe qytetarët që blejnë e konsumojnë ato mallra, mbase duhet ta dinë vetë se sa pandërgjegjshëm po veprojnë kur po konsumojnë këto mallra, pavarësisht faktit se kështu po rrezikojnë edhe shëndetin e jetën e tyre.

Edhe një **gjest madhor** do të ndihmonte në akomodimin e përshpejtuar të bashkështetasve tanë serbë në shtetin tonë të përbashkët. Ky është gatishmëria e popullit tonë për pajtim me popullin serb, pavarësisht faktit se populli serb nuk po dënon krimet ndaj shqiptarëve dhe nuk po kërkon falje për krimet që i ka bërë shteti serb ndaj popullit tonë. Nuk e bëmë Kryengritjen çlirimtare për të filluar luftë hakmarrëse. Pajtimi, pos të tjerave, do stabilizonte edhe më shumë rajonin dhe do hapte shanse për zhvillimit të përshpejtuar ekonomik të dy shteteve tona fqinjë, do e përshpejtonte anëtarësimin e dy shteteve tona në Bashkësinë Evropiane dhe në NATO. Pajtimi nuk i fal krimet shtetërore e individuale serbe ndaj shqiptarëve, dëmshpërblimet shtetërore të Serbisë ndaj Kosovës, dhe as krimet që kanë bërë individualisht shqiptarët ndaj serbëve gjatë e pas Lufte. Dhe çka është me rëndësi të veçantë, pajtimi do i relaksonte bashkështetasit tanë serbë që të bëhen sa më shpejt bashkëqytetarë konstruktiv të Republikës së Kosovës. Prandaj, për të ofruar populli ynë gatishmërinë për pajtim, do duhej të formohej një këshill repre-zantiv shqiptar, anëtarë të të cilit do të duhej të ishin personalitete eminente të familjeve heroike, të familjeve të dëshmorëve e me shumë viktima, të shoqatave të të zhdukurve, veteranëve, invalidëve, personalitete morale e intelektuale, etj. Dhe për të nxitur klimë të fa-vorshme e reciproke për pajtim, duhet sidomos serbët demokratë, që e kanë vuajtur regjimin serbomadh të Millosheviqit, për shkak të qëndrimit të drejt të tyre karshi Kosovës, t'i ftojmë për vizita në Kosovë e t'i nderojmë meritueshëm, etj.

Vitin e kaluar u angazhuam disa individ, në një Nismë qytetare shqiptare për pajtim me popullin serb. Takuam personalitete të familjeve eminente, qoftë për nga heroizmi, qoftë për nga viktimizimi. Nuk e kundërshtuan Nismën tonë dhe nuk na keqkuptuan. Të shumtit që kontaktuam treguan gatishmëri, të shoqëruar me dhimbje të madhe. E arsyetonin gatishmërinë e tyre sublime për të falur e për t'u pajtuar me popullin serb me interesat e popullit e të shtetit tonë, me interesa të popullit serb, me interesa të zhvillimit e të ardhmërisë se rajonit e të Evropës sonë të përbashkët. Atë Nismë dhe atë gatishmëri e "materializoi" Ekipi ynë negociator në Vjenë, duke rritur vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare për të konkretizuar pavarësimin e Kosovës. Secili nga bashkëqytetarët shqiptarë që kontaktuam ishin të predispozuar që të ndihmohen fqinjët tanë serbë e malazias për t'u çliruar nga jeta e tyre në enklava, duke bërë jetë të lirë, në fqinjësi të mirë, në tokat, shtëpitë e banesat e tyre. Këtë gatishmëri e vullnet të mirë, këtë përcaktim njerëzor, duhet t'ua bëjmë me dije bashkështetasve tanë serbë, duhet t'ua shfaqim bindshëm, me shpresë se do e mirëpresin sa më parë, sepse është në interes reciprok, në interes të ardhmërisë sonë të përbashkët. Ky proces do të ndihmon edhe popullin tonë që të çlirohet nga ndjenja e hakmarrjes, për të shijuar sa më shumë e sa më mirë çlirimin tonë nga pushtimi i gjatë dhe i rëndë serb...

1.b. Edhe disa bashkështetas shqiptarë janë pengesë serioze për shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin e shtetit tonë

Sa u përket kundërshtuesve shqiptarë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që me vetëdije ose pa vetëdije janë kundër shtet-bërjes dhe shtet-ndërtimit të shtetit tonë, duhet thënë se ata po sillen e po veprojnë kështu, sepse kanë për bazë vetëm interesat e tyre të ngushta e primitive. Një pjesë tjetër po sillen e po veprojnë kështu, sepse kanë "konstrukt" destruktiv, kurse disa të tjerë nga se hala nuk dinë të sillen si shtet-bërës

e si shtet-ndërtues.

Si kundërshtues të qëllimshëm midis popullsisë shqiptare do të grupoja ata individë që po "menaxhojnë" firma serbe në Kosovë, ata individë që po vazhdojnë të punojnë për shërbime inteligjente nacionaliste serbe dhe të ngjashëm. E kam marrë me rezervë një infor-matë nga një gazetë prestigjioze beogradase, se në kohën e sundimit të Milosheviq-it qenka zgjedhur një taktikë perfide për të kamufluar shfrytëzimin ekonomik në Kosovë, që të mos dukej aq i vrazhdët si pushteti politik. Në këtë kuadër, qeveria serbe ka përzgjedhur rreth 300 shqiptarë "të ndershëm" dhe në emër të tyre ka regjistruar firma serbe. Ato firma të mëdha vetëm në dukje ishin firma të shqiptarëve, por në përmbajtje ishin firma serbe dhe përfitimet e tyre shkonin në Serbi. Ato firma zotëronin gjithë tregtimin e naftës, të cigareve, të sheqerit, të ilaçeve, të miellit, të kafesë dhe të importeve të tjera. Ndonjë tregtar i vogël shqiptar, i cili blinte mallin nga ato firma, për ta shitur me ndonjë përfitim pastaj, nuk duhet të ketë pasur peshë dhe nuk duhet parë me sy kritik, pasi kjo duhet të ketë ndodhur në kuadër të "luftës biologjike" për mbijetesë. Formimi i atyre firmave serbe, në emër të shqiptarëve, ishte taktikë e logjikshme, parë nga këndvështrimi i pushtuesit, pasi pushtuesi nuk e mban kot një vend të pushtuar, nuk e mban as për hir të dofarë romantizmave nacionaliste, por e mban kryesisht për përfitime ekonomike. Ata që kanë jetuar në atë kohë në shtetin virtual të Kosovës (1990-1998), tërësisht të pushtuar e të shfrytëzuar nga Serbia, mund të jenë më të saktë sesa unë, që kam qenë 25 vjet në ekzil, për të shpjeguar veprimtarinë e atyre firmave. Shërbime të afta inteligjente informative nuk kishim dhe nuk kemi, për të pasur të dhëna burimore, që të dëshmohet nëse gazeta beogradase ka informuar ose dezinformuar. Tani do të duhej të shtrohej pyetja: Ku mbetën ato firma pas Luftës, kur Kosova u çlirua nga pushtimi serb!? Them që as ato firma dhe as ata "pronarë" shqiptarë nuk janë avulluar, por janë ambientuar në rrethana të reja dhe kanë vazhduar bizneset e tyre. Ndonjë analist nuk është marrë seriozisht as me përfoljet në popull, në mungesë të të dhënave burimore. Unë po shfrytëzoj opinionin e popullit, kur nuk kam të dhëna burimore, pasi populli ka të angazhuar gjithandej shumë

sy vështrues e shumë veshë dëgjues. Ky opinion të bind se të tilla firma e "pronarë" kanë vazhduar të veprojnë në Kosovë edhe pas Çlirimit. Në kuadër të taktikave akomoduese e kamufluese, ata "pronarë" kanë koketuar me "të merituarit" e me "të fortët" shqiptarë, i kanë korruptuar e kompromettuar ata me ndonjë "ndihmë" financiare. Tregtimin e madh pas lufte mund ta bënin kryesisht ata "pronarë", sepse ata i kishin lidhjet dhe të hollat. Edhe Shërbimi Informativ (i PDK-së), për të cilin kohë më parë u polemizua shumë, nuk besoj ta ketë pasur si pistë kryesore vëzhgimin e këtyre firmave, pavarësisht faktit se ndonjërit nga drejtuesit e tij ia kam shfaqur këtë shqetësim timin. Faktet mbase do të na bindin se Kosova pas lufte ka qenë "El Dorado" për tregtarët e mëdhenj të naftës, të cigareve, të ilaçeve, të sheqerit, të materialit ndërtimor, etj. Ta zëmë, vetëm nga shitja e cigareve, 2-3 tregtarë kanë nxjerrë fitime neto prej rreth 400 milionë euro në vit. Ku është fitimi nga tregtia e cigareve dhe importeve të tjera shumë fitimprurëse!? Nuk po shohim gjëkundi të jetë investuar ai fitim voluminoz në Kosovë. Logjika të thotë se ai fitim u ka shkuar pronarëve të vërtetë në Beograd dhe se "pronarëve" shqiptarë u ka mbetur një shumë simbolike, për të blerë makina të mira, për të gjuajtur prostituta, duke e stimuluar kështu prostitucionin, për të ndërtuar vila që të na shesin tangërllëk prej pashallarëve të vegjël, për të paguar kriminelë mercenarë që të bëjnë vrasje politike, etj. Më ka rastisur që të dëgjoj nga një njeri i profesionit (sigurisht që nuk ka qenë shtetas i Kosovës), se Vitin e Ri 2002 janë parë ta kalojnë si mysafirë të djalit të Slobodan Milosheviqit pesë biznesmenë shqiptarë të Kosovës në hotelin e famshëm të Dubait. Dhe këta biznesmenë gëzonin e gëzojnë autoritet të madh në Kosovë, pasi vazhdimisht ishin në shoqërim me "të merituarit" e "të fortët" shqiptarë, edhe me disa udhëheqës partiakë e politikë. Bëhet e ndërtohet shteti i Kosovës me të tillë shqiptarë, të cilët përfitimet e pandershme financiare, të fituara në rrethanat që krijoi Lufta Çlirimtare e UÇK-së, nuk i investojnë në Kosovë, por i çojnë në Serbi!?

Në grupimin e dytë të shqiptarëve, që tani pavetëdijshëm janë kundër shtet-bërjes dhe shtet-ndërtimit, mund të klasifikohen të gjithë ata

qytetarë që blejnë mallra të prodhuara në Serbi, të cilat në Kosovë futen pa kurrfarë kontrolli të cilësisë dhe pa paguar taksë doganore. Si mund të arsyetohen, ta zëmë, tregtarët që na fusin në Republikën e Kosovës ilaçe të prodhuara në Serbi, pa qenë të licencuara të organet tona përkatëse të Kosovës dhe të pakon-trolluara për cilësinë e tyre? Le t'i lëmë anash, për momentin, tregtarët matrapazë, që karakterizohen për shpirtin e vogël të tyre, për të bërë pyetjen: Përse shumë mjekë në Kosovë shkruajnë receta për ilaçe serbe, përse shumë pronarë barnatoresh i tregtojnë ato, ndonëse e dinë se ilaçe më cilësore, të licencuara, të kontrolluara dhe të doganuara, janë me bollëk në tregun e Republikës së Kosovës?!!! Në fund të fundit, përse vetë qytetarët pranojnë t'i blejnë këto ilaçe, kur e dinë se kështu ndihmojnë ekonominë nacionaliste serbe dhe, ç'është edhe më keq, rrezikojnë shëndetin e tyre, meqë pranojnë të blejnë ilaçe të pakontrolluara?!!! A mos qytetarët, konsumues të këtyre ilaçeve, janë viktimë e mjekëve të pandershëm, që ua sugjerojnë këto ilaçe!? Sigurisht, qytetarët konsumues të këtyre ilaçeve, nuk janë të informuar, se mjekët që ua sugjerojnë këto ilaçe, marrin honorar ilegale për këtë shërbim nga prodhuesit serbë dhe nga tregtarët e pandershëm, që i tregtojnë ato ilaçe! Sa pandershëm po veprojnë këta mjekë e këta tregtarë! Qytetarët duhet të vetëmbrohen nga ky lloj kriminaliteti, duke mos blerë e konsumuar ilaçe serbe, përderisa ato nuk janë licencuar në Kosovë. Vetëm shprehitë nga e kaluara për të përdorur kryesisht ilaçe të prodhuara në Serbi, vërtet nuk do të duhej të bindin qytetarët e Kosovës që të konsumojnë këto ilaçe. Kështu ndodh edhe me prodhime të shumta ushqimore, që prodhohen në Serbi dhe që futen ilegalisht në Kosovë. Mbase një ditë konsumuesit e tyre do ta paguajnë shtrenjtë injorancën e tyre, se mund të ndodhë, larg qoftë, që nacionalistët kriminelë serbë t'u shtien ilaçeve e mallrave ushqimore, që po i fusin ilegalisht në Kosovë, preparate helmuese kimike me veprim afatgjatë.

1.c. Krimi i organizuar vështirëson seriozisht shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin

Grupimi tjetër tepër i dëmshëm, sidomos në aspektin e prodhimit të imazhit të keq për Kosovën dhe të ngecjes së zhvillimit ekonomik, janë pjesëtarët shqiptarë të bandave të organizuara kriminale.

Analizat e vëmendshme e kritike do të na bindnin se kriminaliteti i organizuar e ka zanafillën te shërbimet sekrete serbe të ish-Jugosllavisë. Në ish-RSFJ nuk do të mund të ndodhte krim i organizuar, nëse nuk do të kishte prapa shërbimin e UDB-së, të KOS-it, sepse ishte shtet i rreptë policor. Ato shërbime kanë caktuar oficerë të tyre që të merreshin me organizim të kontrabandimit të drogës, pasi e kishin si burim të madh financiar. Oficerët drejtues të sektorit të kontrabandimit të drogës ndërfutnin kontrabandistë në metropolet botërore dhe në rrjetet e tyre angazhuan edhe shqiptarë, sidomos në hallka të dyta e të treta. Më vonë, disa nga ata shqiptarë, pasi mësu-an zanatin nga ustallarët e tyre, u pavarësuan dhe organizuan banda të pavarura. Do të ishte meritore që tani oficerët shqiptarë, që dikur ishin të angazhuar në UDB dhe në KOS e shërbime të tjera, shumica e të cilëve kanë qenë të komanduar të angazhoheshin në sektor të kontrabandimit të drogës, të kishin kurajën qytetare për të rrëfyer atë mënyrë të organizimit shtetëror. Dhe ato shërbime, jo vetëm që e shihnin kontrabandimin e drogës si burim financiar, por në rastin e Kosovës, ato synonin të shkatërronin sidomos rininë shqiptare.

Aktualisht nuk kemi pse t'ia veshim fajin vetëm Serbisë, pasi kontrabandistët shqiptarë janë pavarësuar pothuajse krejtësisht, janë shumëzuar e kriminalizuar aq shumë, sa vërtet janë bërë shqetësim tepër serioz për Republikën e Kosovës dhe për shumë shtete perëndimore. Ky fakt ka rritur vështirësitë e shtet-bërjes sonë dhe do të vazhdojë të prodhojë vështirësi për shtet-ndërtim, për kohë të gjatë, po nuk u zhduken këto banda kriminale. Shtetin tonë, gjegjësisht ne, shtetasit e tij, krimi i organizuar duhet të na shqetësojë shumë. Qeveritarët

perëndimorë, që janë të predispozuar për të na ndihmuar gjatë shtet-bërjes dhe shtet-ndërtimit, mund të ndikohen negativisht kur të dëgjojnë se edhe fëmijët e tyre janë të rrezikuar nga kontrabandistët e Kosovës. Kryesisht rrjedhojë e "kriminalitetit tonë" të organizuar është shtrëngimi i dhënies së vizave, trajtimi denigrues që na bëhet nëpër konsullata, kur kërkojmë viza, trajtimi denigrues kur kalojmë kufijtë. Tani duhet shtruar pyetja: Është njerëzore që mbi dy milionë shqiptarë të Republikës së Kosovës dhe mbi një milionë emigrantë tanë ta vuajnë këtë imazh të keq e këtë keqtrajtim, "të prodhuara" kryesisht nga "krimi ynë" i organizuar!? Sigurisht, krim të organizuar ka gjithandej, por Republika e Kosovës, gjatë procesit të shtet-bërjes dhe të shtet-ndërtimit, është nën "prozhektorët e fortë" të bashkësisë ndërkombëtare (siç shprehet I. Kadare). Shtetet e mëdha mund ta përballojnë e "ta absorbojnë" krimin "e tyre" të organizuar, por jo shteti ynë, i cili po vëzhgohet me imtësi nga të gjitha anët e nga të gjitha këndvështrimet e mundshme.

Krimi i organizuar nuk është prodhim i drejtpërdrejtë i popullit tonë, por ama gjithsesi i përkrahur tërthorazi. Secili pjesëtar i këtij krimi të organizuar është pjesëtar i një familjeje në Kosovë. Sigurisht, ata nuk kanë pyetur familjet kur janë angazhuar në këtë kriminalitet, por përse duhet të gëzojnë respekt pastaj nga familjet e të afërmit e tyre, përse duhet të gëzojnë respekt në ambiente ku ata janë të pranishëm!? Vetëm për përfitime të vogla dhe për ndonjë pije që qerasin ata me karshillëk!? Përfitimet e mëdha të tyre ata i harxhojnë në bixhoz e për prostitucion, për automobila e bizhuteri të shtrenjta, për rrojtje në hotele luksi, për vila fodulle, etj., kurse pasojat e tyre duhet t'i vuajë gjithë populli dhe shteti ynë. Ata po nxisin e po stimulojnë prostitucionin, ata po rrezikojnë të rinjtë tanë, nga se fillimisht, ua imponojnë drogën dhe prostitucionin, ata po demoralizojnë të rinjtë tanë me paraqitjet e tyre. Duhet t'i tolerojnë prindërit në Kosovë të tillë kriminelë që rrezikojnë jetën e fëmijëve të tyre?! Duhet t'i tolerojmë, për të mos thënë t'i respektojmë, të tillë kontrabandistë që rrezikojnë fëmijët, ta zëmë, të prindërve zviceranë që aq shumë kanë ndihmuar popullin tonë para, gjatë e pas Luftës së UÇK-së, me punësim të emigrantëve tanë, me strehim të refugjatëve,

me përkrahje të theksuar politike gjatë shtet-bërjes dhe me ndihma financiare?! Përgjigjet duhet t'i gjejmë secili. Po nëse prindërit në Kosovë janë të pazotë për të mbrojtur fëmijët e tyre, ku janë ata trima që në Luftë vdisnin heroikisht për të mbrojtur fëmijët nga kriminelët serbë dhe tani zhgënjyeshëm e me urrejtje vështrojnë këta kriminelë rrezikues të rinisë sonë dhe të rinisë perëndimore? Tani që po bëjmë e ndërtojmë shtetin tonë, të gjithë qytetarët, edhe prindërit, vëllezërit e motrat e të afërmit e kontrabandistëve, duhet të vetëdijesohen e të angazhohen kundër kriminelëve "tanë", fillimisht me sqarimin e tyre për dëmet e rreziqet që po i shkaktojnë popullit e shtetit tonë, pastaj me lutje për të hequr dorë nga kriminaliteti i tyre. Po nuk dëgjuan, atëherë duhet t'i denoncojmë të organet përkatëse, brenda e jashtë Kosove, pasi populli dhe emigracioni i di e i njeh ata. Kjo do të ishte njerëzore, këtë ua kemi për borxh rinisë sonë dhe rinisë së shteteve që na kanë shpëtuar nga shfarosja masive serbe. Në fund të fundit, këtë ia kemi për borxh humanizmit tonë. Nuk është njerëzore të na hutojnë ato pak ndihma materiale (familjes) e qerasjet cinike (të tjerëve) që bëjnë kontrabandistët, pasi kështu ata po ndotin shoqërinë tonë.

Si masë e parë dhe tepër urgjente, konkrete, në luftën ndaj kontrabandimit të drogës në Kosovë është krijimi i qendrave për trajtim të atyre që i kemi të varur nga droga, duke përfshirë edhe dhënien e drogës në rrethana higjienike dhe pa pagesë, deri sa të shërohen nga varësia, ngjashëm me praktikën e suksesshme holandeze. Njëko-hësisht kontrabandistëve e narkodilerëve, që shesin pothuajse lirisht drogë para shkollave, në lokale të ndryshme, strukturat përkatëse shtetërore duhet t'ua tregojnë vendin e merituar. Por meqë këto struktura për momentin nuk i kemi aq të aftësuara dhe të forta, vërtet është me interes të gjithanshëm e madhor, që të angazhohen sa më shumë qytetarë në luftimin e këtyre kriminelëve, që nuk ngurrojnë të marrin jetë të të rinjve tanë dhe të rinjve në Perëndim, vetëm për përfitime të tyre të poshtra e kriminele. Ngjashëm duhet të angazhohet edhe emigracioni ynë, meqë ai është më i informuar dhe po i vuan më drejtpërsëdrejti paragjykimet e urrejtjet kundër popullit shqiptar dhe kundër Kosovës, që ka prodhuar

krimi i orga-nizuar "shqiptar" në shtetet perëndimore.

Tregtimin e prostitucionit dhe krimit që e shoqëron atë mund ta luftojmë fillimisht duke e legalizuar prostitucionin. Tregtimi me prostitucion përbëhet nga shitësit dhe blerësit dhe kryesisht vajzat si viktima. Disa "moralistë" perëndimorë na vardisen njëanshmërisht për këtë lloj kriminaliteti, por ata harrojnë se blerësit konsumues të vajzave viktima janë kryesisht në Perëndim, përndryshe, siç dihet, një mall që nuk ka blerës, nuk ofrohet në treg.

Për shumëkënd që ka qenë në Perëndim, është e ditur (dhe mund të kenë parë) se pothuajse në çdo metropol e qytet të madh ka shtëpi legale publike (prostitucioni), ku shiten legalisht femrat e regjistruara në organet përkatëse shtetërore si prostituta, ka bare striptize, ka shërbime seksuale me pagesë. Bile nga këto "biznese" shtetet e Evropës Perëndimore marrin tatime të majme. Shteti i Kosovës nuk ka përse të shtiret më i moralshëm se ato shtete, prandaj duhet të kopjojë modelin holandez, gjerman, francez, etj., dhe të legalizojë prostitucionin e kontrolluar dhe të tatimuar. Sa për ilustrim po sjell një informacion tepër shpjegues: Shoqata e prostitutave të Francës vite më parë i pat bërë peticion të hapur presidentit të vendit që të angazhohej për t'ua mbrojtur tregun që ua kishin rrezikuar prostitutat shqiptare. Nuk kanë qenë të rralla kur prostitutat në Perëndim kanë organizuar protesta e demonstrata për të mbrojtur të drejtat e profesionit të tyre.

Vërtet, a është kombëtare dhe njerëzore nëse shteti i Zvicrës, që ka punësuar e strehuar rreth 240 mijë shqiptarë të Kosovës, bile ka strehuar edhe një mori të përndjekurish politikë që tani janë me funksione të larta shtetërore; pra, nëse shteti i Zvicrës, e përsëris, ka ndihmuar aq shumë financiarisht e politikisht shtetin tonë, tani të ballafaqohet me mijëra "narkodilerë" tanët dhe për ata të shpenzojë aq shumë për t'i pasur nën kontroll dhe për t'i mbajtur në burgje? Dorën në zemër, vërtet duhet ta kenë të vështirë funksionarët shtetërorë zviceranë, kur marrin vendime të mëdha që ta ndihmojnë shtetin e popullin tonë, kur e dinë se fëmijët e tyre, rinia e tyre, është e rrezikuar nga mijëra kriminelë

“tanët”! Përafërsisht në relacione të ngjashme është Gjermania, që ka punësuar qindra mijëra veta dhe vetëm në vitet e ’90-ta ka strehuar rreth 320 mijë shqiptarë të përndjekur nga Kosova, që ka përkrahur Kosovën gjatë Luftës Çlirimtare, që ka stacionuar 3.000 ushtarë për ta mbrojtur Republikën e Kosovës, që po na jep qindra milionë euro ndihma financiare, etj. Edhe shtete të tjera kanë rënë në hall me bandat “tona” kriminale, madje edhe Norvegjia e largët, që para pak ditësh miratoi një ndihmë prej 17 milionë eurosh për arsimin tonë. Nuk janë këto hamendësime kuturu, di për çfarë po flas, pasi shpesh herë kam përkthyer gjatë procedurave hetimore e gjyqësore në Gjermani dhe di për pasojat e tyre edhe në kompromet imin e popullit tonë, si “prodhues” i atyre kriminelëve. Dhe të tillë kriminelë sikur po gëzojnë respekt në mjedise të emigracionit tonë, edhe më shumë, po respektohen në mese të ndryshme kur vijnë në Kosovë, pasi ata po vinë me xhepat plot, me makina të shtrenjta dhe po nxisin krimin dhe prostitucionit këtu, etj. Pak është të thërrasësh me gjithë fuqi: **Luftë frontale kundër krimit “tonë“ të organizuar!** Për këtë do të bindemi ende më shumë, po të dinim shqetësimet e vuajtjet e prindërve të fëmijëve të droguar, në Kosovë e në Perëndim, e sidomos për vuajtjet e tyre nga përbuzjet që përjetojnë ata në rrethin ku jetojnë. Për këtë do të bindemi ende më shumë, kur të kemi parasysh paragjykimet e botës perëndimore për popullit tonë mu për shkak të krimit të organizuar “shqiptar”!

Edhe më e dëmshme është dukuria “moralizuese”, kur në mese të ndryshme diskutohet se si përfitimet financiare nga krimi i organizuar janë një shans për zhvillim të përshpejtuar të Kosovës, duke arsyetuar se kështu dikur kanë ndikuar në zhvillim të Italisë bandat mafioze në Amerikë, kështu po ndikon sot krimi i organizuar në zhvillim të Rusisë, të Shqipërisë, etj.

1.d. Korrupsioni kundërshtar shumë serioz i shtet-bërjes dhe i zhvillimit ekonomik e demokratik

Aktualisht tema më e shumëpërfolur, më e kritikuar dhe më shqetësuese, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, është korrupsioni. Flitet e përflitet, kritikohet, se korrupsioni ka përfshirë e mbërthyer pothuajse gjithë administratën shtetërore, sistemin shëndetësor, sistemin arsimor, etj. Të flasësh e të shkruash tani për korrupsionin, është bërë si të flasësh e shkruash për motin. Të diskutosh kundër tij e të vendosësh për t'iu kundërvënë, është bërë sikur të diskutosh e t'i kundërvihesh motit të keq. Kjo epidemi ka marrë ato përmasa infektuese, sa të duket se edhe ai që kritikon, kritikon nga zilia se nuk i ka mundësitë të jetë në ato pozita, ku mund të përfitojë përmes korrupsionit. Tashmë të duket se kur flitet e shkruhet kundër tij, flitet e shkruhet sa për të bërë radhën.

Kur kritikohet korrupsioni i pushtetarëve dhe nëpunësve shtetërorë, deri tani mendohet vetëm për ata që marrin "indulgjenca" e ryshfete. Dhe përmasat duken se janë të atij niveli sa, kur thua se presidentin e kemi të korruptuar, se kryeparlamentarin e kemi të korruptuar, se kryeministrin e kemi të korruptuar, se ministrat i kemi të korruptuar, se sekretarët e shtetit, drejtorët, nëndrejtorët e deri te nëpunësi i fundit, i kemi të korruptuar; se kryetarët e nënkryetarët e partive, profesorët e universiteteve, arsimtarët, mësuesit, mjekët e spitaleve, deri edhe të pronarët e mediave, i kemi të korruptuar, nuk të bëhet se ke ekzagjeruar, se ke shpifur, ose se ke ofenduar të gjithë këta që u përmendën dhe të tjerë që nuk u përmendën. Shkruhet e thuhet, se shumë, shumë të korruptuar ishin edhe qeveritarët e deridjeshëm. Po u përpoqe të mbrosh ndonjërin, menjëherë dëgjon kundërshtimin: "Llogarit nëse ndonjëri nga këta që u përmenden e ka blerë ose e ka ndërtuar vilën me rrogën që ka marrë, llogarit nëse e ka blerë makinën luksoze me rrogën që ka marrë, llogarit nëse i ka blerë kostumet *firmato* me rrogën që ka marrë, llogaritë nëse dashnoret ("shvalerkat") i josh me rrogën që ka marrë,

llogarit nëse shkon përditë në restorante me rrogën që ka marrë...". Dhe menjëherë vihesh në siklet: Vërtet, po ua llogarite rrogat, nuk të dalin, sepse gjithandej rrogat janë të vogla.

E keqja dyfishohet, pasi nuk janë të korruptuar vetëm ata që marrin, por po kaq janë edhe ata që japin, sepse i japin për të vjedhur tenderin, për të vjedhur troje, leje ndërtimi, diploma, etj., nga të cilat pastaj do nxjerrin përfitime të pandershme.

Vërtet, kaq i shtrirë është korrupsioni, gjegjësisht hajnia, në shoqërinë tonë!? Ekzagjerime!? Po si u akuzuakan ta zëmë edhe pronarët e mediave? Thjesht: ndonjëri ka marrë donacione "në emër" të Kosovës së shkrumbuar nga lufta, vazhdon të marrë edhe tani "në emër të ndihmës" për të zhvilluar mediat private, gjegjësisht për të ndihmuar zhvillimin e Kosovës, dhe na del pronari e thotë se e ka median përkatëse pasuri thjesht private dhe prandaj ka pasuri dhjetëra milionëshe! Pastaj, kur disa pronarë të mediave do të emetojnë e afishojnë reklama e njoftime të institucioneve shtetërore, fillojnë pazaret, se sa duhet të vjedhë secili. Disa pronarë i vjedhin edhe gazetarët, sepse nuk ua paguajnë sigurimet për efekt pensioni, etj. Edhe disa gazetarë duket se janë të korruptuar, sepse pranojnë të gënjejnë, qoftë duke kritikuar pa fakte, për të rritur tirazhin e gazetës dhe autoritetin e tyre, qoftë duke fshehur faktet për të mos kritikuar, sepse paguhen nga të korruptuarit për të heshtur. Në veprim janë edhe kërcënimet ndaj gazetarëve të guximshëm nga ana e të korruptuarëve dhe nga disa pronarët të mediave.

Disa biznesmenë vjedhin kur japin ryshfete për të marrë tenderë, duke bërë garë të pandershme kundër konkurrentëve të tyre. Disa profesorë e mësues janë të korruptuar, kur shesin nota. Disa mjekë në spitale shtetërore janë të korruptuar kur vjedhin ilaçe, prishin instrumente të shtrenjta, marrin ilegalisht të holla për të mjekuar pacientë. Shumë universitete private dhe mësimdhënës të tyre (në të shumtën e rasteve pa qenë të kualifikuar në nivelin që kërkohet) janë të korruptuar, sepse regjistrojnë studentë me premtim se nuk do t'i ngelin, etj. I korruptuar na del edhe ofiqari në zyrë të vendit, sepse nuk të lëshon menjëherë

certifikatë lindjeje, martese ose vdekjeje, pa i dhënë "bakshish".

Flitet e shkruhet, se edhe më i madh është korrupsioni i prokurorëve dhe gjyqtarëve, sepse policia arreston të dyshuarit për korrupsion, vjedhje, kriminalitet të organizuar dhe vrasje, kurse disa proku-rorë e gjyqtarë i lirojnë ata. Shembulli vijues tregon nivelin e prokurorive tona. Një anëtar i kabinetit paraprak qeveritar foli në Kuvend, gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë televiziv: "Qeveria jonë ka vjedhur, por kjo qeveri po vjedh më shumë" (perifrazim i lirë). Atëherë ku janë prokurorët kompetent që nuk e marrin në pyetje këtë ish-qeveritar, për të dëshmuar hajninë që e pranoi dhe akuzën që e ngriti?! Një tjetër rast më tepër se skandaloz, të cilin e përflasin shumica e qytetarëve të Dukagjinit, është ai i kapjes se vrasësve mercenarë nga Tropoja! Mediat patën informuar me zhurmë kur ata u kapën në flagrancë. U publikuan edhe fragmente nga protokollet e hetuesisë, se kriminelet kishin pranuar të kenë vrarë shumë veta në Dukagjin, duke u paguar nga 5 mijë euro për çdo vrasje. Ndodhi procesi gjyqësor dhe për çudi ata u liruan "për mungesë të provave"! Ndërsa në popull përflitet, se Kryetari i trupit gjykues ka marrë 150 mijë euro për t'i liruar të dyshuarit për shumë vrasje, që ishin kapur në vepër dhe që kishin pranuar vetë krimet që kishin bërë...

Na vjedhin edhe ata që duhet të na japin dritën (rrymën). TEC-et tona kanë kapacitet për të prodhuar rrymë të bollshme për nevojat e Kosovës, bile edhe për eksport. Se mos po na prodhohen avari të qëllimshme në TEC-e nga individët që i paguan Serbia, për të na shitur pastaj rrymën e saj? Se mos po na prodhohen avari të qëllimshme në TEC-e nga individët që i paguajnë shitësit e gjeneratorëve dhe të naftës e benzinës? Se mos po na prodhohen avari të qëllimshme në TEC-e nga individët që i paguajnë ata që janë të ngarkuar për të blerë rrymë importi, sepse duke blerë rrymë, shitësit u japin fshehurazi përqindje të majme? Edhe kur ka rrymë, disa të punësuar në nyje shpërndarëse e ndalin atë për të shantazhuar bizneset që t'u japin bakshishe për t'ua lëshuar rrymën, ose e shpërndajnë rrymën me parapëlqime të tyre.

I vjedhur del vetëm populli, sepse të gjitha këto i faturohen atij në buxhet shtetëror, komunal etj., ose në rritje të përditshme të çmimeve.

Për këtë epidemi, kaq të përhapur, na kritikojnë edhe të huajt, ata që po na përkrahin, po na këshillojnë e po na japin ndihma për ta bërë e ndërtuar shtetin. Ndonjëri nga të korruptuarit mundohet të mbrohet kundër kritikave që vijnë nga Perëndimi, duke provuar ta zbusë korrupsionin me krahasime që bëjnë me shtete të tjera, etj. Dhe të huajt na hidhërohen, sikur bëhen pishman pse e kanë ndihmuar deri këtu Kosovën për t'u bërë shtet, vihen në dilemë nëse duhet ta ndihmojnë në të ardhmen.

Së fundi të korruptuar na dalin edhe ata që vetëm po kritikojnë, sepse, duke kritikuar e mos vepruar, po rrisin mjegullnajën që të mjegullohet akoma më shumë korrupsioni, nga se "ujqit mjegull duan".

Cilat janë mundësitë e luftimit sa më të suksesshëm të korrupsionit? Dihet, mjeti më i suksesshëm është zhvillimi ekonomik, social e demokratik i vendit dhe i shoqërisë. Por për këtë duhet kohë. Kundërvënia e menjëhershme mund të fillojë nga strukturat përkatëse shtetërore, të përkrahura dhe të ndihmuara fuqimisht nga qytetarët, kur këta të ndërgjegjësohen se gjithë kjo hajni rëndon, në fund të fundit, vetëm mbi kurriz të tyre. Qytetarët, më në fund, duhet të ndërgjegjësohen për të mbrojtur buxhetin e tyre shtetëror, buxhetin e komunave, të spitaleve, të shkollave, etj. Qytetarët, më në fund, duhet të ndërgjegjësohen, pasi me rritje të korrupsionit, gjegjësisht të hajnisë, proporcionalisht zvogëlohet edhe gatishmëria e shteteve mike që të ndihmojnë edhe më tej shtetbërjen e shtet-ndërtimin e shtetit tonë.

Pa paragjykuar, le t'u besojmë premtimeve se qeveria aktuale - sidomos premtimeve të kryeministrit Thaçi - për **"tolerancë zero"** kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Duhet të presim rezultate konkrete, nga se premtimet dhe zotimet qytetarëve nuk u kanë munguar dhe tashmë sikur nuk duan t'u besojnë më, meqë u kanë rezultuar të gënjeshtërta. Atëherë le të miratohet sa më parë projektligji për verifikimin e burimit (prejardhjes) së pasurisë dhe të dërgohet sa më

parë për miratim në Kuvend, që të zbatohet pastaj sa më efektivisht. Propozoj këtë ligj pasi më pat bindur diskutimi i ish Kryeprokurorit të Prishtinës në një paraqitje në televizion, me ç'rast argumentueshëm foli për nevojën e këtij ligji. Efekti i tij, - thoshte ai, - do të jetë i madh, sepse, po ua konfiskove pasuritë materiale dhe financiare atyre që kanë përfituar pandershëm, duke u marrë me korrupsion ose krim të organizuar, atëherë ata do të disiplinohen, sepse ata e kanë "ideal" pasurinë e tyre të pandershme. Të korruptuarve nuk u prish shumë punë nëse i largon nga vendi i punës, ose edhe nëse i dërgon në burg kur kapen në flagrancë, pasi ata bëjnë llogaritë se do u shpaguhet me pasurinë që kanë vënë pandershmërisht. Po ua konfiskove pasurinë, i ke dënuar ata meritueshëm dhe i ke disiplinuar të tjerët!

Masa tjetër e qeverisë është që t'i përforcojnë strukturat përkatëse shtetërore, duke i aftësuar ato për zbulim e ndjekje të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në krye të këtyre strukturave duhet të vihen njerëz të aftë, të guximshëm, gjithsesi të ndershëm, pasi po u korruptuan edhe këto struktura, atëherë korrupsioni dhe krimi i organizuar do të kapin shtetin dhe vaj halli pastaj për shtetin dhe shoqërinë tonë.

Kontribut të menjëhershëm dhe efektiv mund të japin qytetarët dhe ata biznesmenë që janë të predispozuar ta bëjnë e ta ndërtojnë shtetin tonë. Survejimet e denoncimet tek organet përkatëse nga ana e qytetarëve dhe kallëzimet penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i japin shtytje të madhe luftimit me sukses të këtij lloj kriminaliteti, kaq shumë të përhapur, kancerogjen e kompromettues. Nuk duhet të hezitohet në survejimin dhe denoncimin e këtij kriminaliteti për shkak të epitetit që kishin në të kaluarën spiunët politikë që spiunonin për llogari të atij pushteti pushtues. Të survejosh dhe të spiunosh këtë kriminalitet, do të thosha, është guxim e kulturë qytetare, është kontribut i madh patriotik në llogari të shtet-bërjes e shtet-ndërtimit, është mbrojtje e pasurisë së të gjithëve, është kontribut për zhvillim të përshpejtuar ekonomik e shoqëror. Tashmë nuk duhet të kursejmë as të afërmit familjar, të korruptuar e të kriminalizuar. Fillimisht, familjarët duhet të lusin të afërmit familjarë, të korruptuar e të kriminalizuar, që të heqin dorë

nga ky kriminalitet, pastaj, po nuk dha rezultat, duhet t'i survejojnë, t'i denoncojnë, që të përfundojnë në burgje. Edhe fqinjët dhe të afërmit mund të ndihmojnë shumë, pasi ata dinë kur ndonjëri ndërton vila, blen makina të shtrenjta, ushtron e nxit prostitucionin ilegal, etj., me pasuri të fituar përmes korrupsionit e krimit të organizuar. Informatorëve dhe denoncuesve, nëse nuk kanë guxim të dalin hapur, duhet t'u mbrohet anonimiteti. Kurse shpifësit për qëllime të dobëta duhet të ndëshkohen. Kështu duhet vepruar në Republikën e Kosovës dhe në emigracion. Përndryshe, edhe familjarët e të korruptuarve dhe të kriminalizuarve, do të konsiderohen se janë bashkëpjesëmarrës dhe përfitues, se nuk kanë vullnet për ta bërë e për ta ndërtuar shtetin tonë.

Konkretisht, sikur po më duket hallkë e tepruar Agjencia Kundër Korrupsionit, pasi rastet për të cilat ajo po informohet, po i përcjellë pastaj në prokurori. Kështu kemi shtuar një hallkë duke rritur mundësinë e të korruptuarve që të zvarriten përndjekjet nga policia e krimeve të rënda dhe nga prokuroria, ua kemi shtuar mundësinë edhe të punësuarve në këtë agjenci që të korruptohen për të sabotuar e vonuar zbulimin dhe përndjekjen e të korruptuarve. Më e logjikshme është që financat që harxhohen për këtë agjenci të investoheshin për të përforcuar sektorin policor për luftim të krimeve të rënda dhe prokurorinë dhe qytetarët të informojnë drejtpërsëdrejti këto struktura dhe jo këtë Agjenci, e cila po i vonon informatat që duhet t'ua përcjellë strukturave kompetente.

Ndoshta nuk e teproj nëse shpreh mendimin, se do ishte çlirim i dytë i Kosovës dhe i popullit tonë, po luftuam me sukses korrupsionin dhe krimin e organizuar, sepse ky do ishte vërtet faktor përshpejtues i shtet-bërjes dhe i shtet-ndërtimit, i zhvillimit të përshpejtuar ekonomik dhe shoqëror. Këtë ia kemi për borxh vetes sonë, këtë ua kemi për borxh edhe shteteve që na shpëtuan nga gjenocidi serb i përmasave katastrofave! Prandaj secili qytetar duhet të angazhohet për çlirimin e Kosovës nga korrupsioni dhe krimi i organizuar. Kurse institucionet e tanishme shtetërore, gjegjësisht individët që i drejtojnë ato, kanë shansin të dëshmojnë se janë pikërisht këta që po i kërkon koha dhe populli për të bërë vepra madhore në luftë kundër korrupsionit dhe

krimit të organizuar. Dëshmia e parë konkrete, gjegjësisht simbolika më kuptimplote për t'dhënë ca kurajë dhe shpresë popullit tonë të sfilitur, do të ishte që të gjithë ish-qeveritarët, por edhe të tanishmit, dhe personalitetet që kanë poste të larta shtetërore e partiake, të deklarojnë publikisht pasurinë e tyre, se nga i kanë marrë mjetet për vilat e makinat e tyre, bizneset e tyre. Ata që nuk janë në gjendje të dëshmojnë me prova, mirë do të bënin që pasuritë e tyre t'ua dhuronin shoqatave të invalidëve e jetimëve të Luftës, shoqatave që përkujdesën për gratë e përdhunuara nga kriminelët serbë gjatë Luftës, Kryqit të Kuq të Republikës së Kosovës.

Republikën e Kosovës kështu do ta ndihmonte shumë moralisht, politikisht, materialisht, një *katarsis* (pastrim i shpirtit) sa më gjithëpërfshirës, do ta ndihmonte shumë vendimmarrja për të frenuar vetën e tij të gjithë ata që janë në pozita për t'u korruptuar e për të bërë krime. Dhe po nuk patën ndërgjegje e forcë morale të korruptuarit dhe të kriminalizuarit për të hequr dorë nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, atëherë qytetarët duhet të ndërgjegjësohen për të gjetur forma më efektive për t'i luftuar këta individë të shpërfytyruar. Dënimi me mosdalje në votim, siç ndodhi herën e fundit, nuk është mjet efikas për të luftuar me sukses të korruptuarit, të cilët garojnë për të uzurpuar poste shtetërore dhe të pasurohen edhe më shumë përmes korrupsionit. Koalicioni qeverisës duhet të bëhet i vetëdijshëm se për qeverisje të tyre nuk kanë mundur të marrin as 25 për qind të votave të qytetarëve me të drejtë vote, prandaj kanë shansin e madh historik që të bëjnë kthesë të madhe në rrjedhat e shoqërisë sonë të sfilitur, duke dëshmuar se nuk erdhën në pushtet për t'u pasuruar duke u marrë me korrupsion, duke dëshmuar se janë të vendosur deri në vetëmohim e vetërrezikim për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në të gjitha nivelet. Kjo do t'u jepte kurajë votuesve për të dalë në zgjedhjet e radhës në përqindje më të lartë për t'i (zh)vlerësuar partitë e individët konkurrues e garues.

1.e. Vonesa e mosnjohjes së shtetit tonë nga shumica e shteteve të botës dhe vonesa e mos-anëtarësimit në OKB po vështirëson shtet-bërjen, por kjo nuk duhet të na dëshpërojë e alarmojë

Realizimit sa më të plotë të Republikës së Kosovës po i bën dëm sidomos mosnjohja shtetërore nga Rusia dhe Kina, por edhe mosnjohja nga shtetet e influencuara nga këto dy shtete të mëdha, si dhe nga shtetet që aktualisht ndikohen në politikën e tyre me qëndrime anti-ShBA.

Rusia po vazhdon të kundërshtojë hapur, kurse Kina përmbajt-shim. Por ne nuk duhet të dëshpërohemi, sepse edhe këto superfuqi shpejt do të korrigjojnë qëndrimin e tanishëm: të paktën do të tolerojnë heshturazi realitetin e ri, meqë nuk do jenë në gjendje të kundërshtojnë për shumë kohë Aleancën Veri-Atlantike. Qëndrimi i Rusisë dhe Kinës duhet të na brengosë, por jo në ato përmasa sa të na mbulojë pesimizmi e disfatizmi gjithëpërfshirës. Sigurisht, sa më gjatë që këto superfuqi do të kundërshtojnë shtetin tonë, po kaq gjatë mund të vonohet anëtarësimi i Republikës së Kosovës në OKB, pasi shumë shtete të botës janë të influencuara nga qëndrimi i Rusisë dhe i Kinës dhe nga anti-amerikanizmi politik. Dhe, vonesa e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në OKB, bart me vete edhe konsolidimin e vonuar të Republikës së Kosovës, pasi OKB-ja do të vonojë njohjen e Republikës së Kosovës dhe anëtarësimin e saj në këtë Organizatë tashmë dukshëm të diskreditiuar.

Mosnjohja nga shumë shtete, për shkak të përcaktimit të tyre politik anti-amerikan, të bënë të mendosh se këto shtete nuk e njohin problematikën komplekse të shtetësisë së Kosovës dhe relacionet politike të Uashingtonit me Kosovën. Ky numër shtetesh është i madh dhe ato kryesisht janë të Amerikës Latine, të Afrikës dhe të Azisë. Fatkeqësisht këto shtete i kemi nënçmuar dhe nuk jemi angazhuar të bëjmë punë sqaruese, duke logjikuar se nuk ka përse Kosova "të ngatërrohet" me anti-amerikanizmin politik të tyre. Ato vazhdojnë të

identifikohen “ngatërrueshëm” edhe me anti-amerikanizmin serb, i cili nuk është anti-amerikanizëm i ngjashëm me atë të tyre, por vetëm për shkak se ShBA-të, duke u mbështetur në të drejtat e njeriut, si prioritet para së drejtës shtetërore, kanë kontribuar shumë, fillimisht që populli shqiptar i Kosovës të shpëton nga gjenocidi serbomadh dhe nga dëbimi i përgjithshëm e i pëthershëm, pastaj që Kosova të çlirohet nga pushtimi i Serbisë.

Shumë shtete kanë nostalgji për ish- RSFJ-në, gjegjësisht për politikën e dikurshme “neutrale” dhe “të painkuadruar” të saj. Kështu, ato po e konsiderojnë shtetin e tanishëm të Serbisë si trashëguese të ish-RSFJ-së. Ato duket se nuk e kanë të qartë faktin se nacionalizmi unitarist serbomadh ishte faktori kryesor që çintegroi ish-Jugosllavinë dhe tani Serbia mund të jetë vetëm “pjella” më e shëmtuar e saj. Me këto shtete duhen gjetur lidhjet për të bërë sqarime të studiuara, në kuadër të kompleksitteve që përmenda, dhe për të bërë lobingje që ato ta njohin sa më parë pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Vonesa e njohjes nga shtetet islamike dhe nga Vatikani del e pakuptueshme, pasi këto do të duhej të kishin më shumë arsye për të përkrahur Republikën e Kosovës. Strukturat politike të Republikës së Kosovës nuk duhet të kompleksohen për shkak se shumica e popullsisë sonë është e besimit mysliman. Në kuadër të diplomacisë “operative”, strukturat qeveritare duhet të dinë të lobojnë tek shtetet islamike, pa u frikësuar se mund të etiketohen si islamistë nga shtetet e Perëndimit.

Edhe disa faktorë të tjerë janë relevantë për vonimin e njohjes së Republikës së Kosovës nga shumica e shteteve të botës. Ato kanë probleme ose frikësohen se mund t’u lindin probleme nga etnitë pakicë në shtetet e tyre, ato u frikësohen “ndërhyrjeve në punë të brendshme” për shkak se nuk respektojnë të drejtat e njeriut, ato duan të mbajnë qëndrim konservator ndaj Kartës së OKB-së dhe së drejtës ndërkombëtare, etj. Pikërisht për këtë shkak qeveria jonë duhet të dijë se Ministria e jashtme e Republikës së Kosovës duhet të formohet me njerëz që njohin kompleksitetin e interesave dhe relacioneve në mes të

shteteve, me kuadro që janë të aftë për të përgatitur e për të plasuar sa më shumë materiale informuese, sqaruese e bindëse.

As rezoluta që u miratua para disa ditëve nga Asambleja e OKB-së për t'i bërë gjykim (moral) pavarësimit të Kosovës, nëse bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare, nuk duhet të na demoralizoj e hutoj papërmbajtshëm, siç nuk është e arsyeshme që ta nënvlerësojnë atë sidomos qeveritarët dhe Kryetari i Kosovës.

Mirë do të ishte që të kishim sa më parë njohjen prej shumicës së shteteve të botës, që pastaj Republika e Kosovës të mund të anëtarësohej sa më parë në OKB, por anëtarësimi në OKB nuk është kushedi çfarë privilegji. Me formën e organizimit dhe të funksionimit aktual, OKB-ja e ka konsumuar veten dhe nuk është ndonjë nder e privilegj i madh të jesh anëtare e saj. Mendohet se anëtarësimi në OKB do t'i sjellë Kosovës më shumë siguri e përfitime financiare, por Republika e Kosovës e ka realisht kështu si është sigurinë më të madhe të mundshme në botë, meqë e mbron Aleanca më e fuqishme ushtarake - NATO-ja, kurse privilegjet, ndihmat e kreditë financiare pothuajse fare nuk varën nga OKB-ja, por kryesisht nga Brukseli dhe Uashingtoni. Gjithsesi, vlerë madhore do ishte që shteti ynë, sa më parë, të anëtarësohej në OKB, por nuk duhet të alarmohemi papërmbajtshëm nëse këto njohje do të na vonohen paksa. As Taivanit, siç e përmenda, nuk i kanë bërë kushedi çfarë dëmi pse nuk ka qenë i anëtarësuar në OKB.

1.f. Insistimi i tashëm që Republika e Kosovës të ketë ushtri (armatë), më shumë e dëmton sesa e ndihmon shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin e Republikës së Kosovës

Tani po insistohet në formimin e ushtrisë (armatës). Mbase do të kishte qenë më me interes për Republikën e Kosovës që të mos formonte e të mos mbante ushtri (armatë), nëse për mbrojtjen e saj të jashtme do të garantonin NATO, Brukseli, Uashingtoni, Tirana, mundësisht edhe

Këshilli i Sigurimit.

E kuptoj dëshirën e madhe, pothuajse të mitizuar, për formimin e një ushtrie të Republikës së Kosovës, por nëse na jepen garanci bindëse për mbrojtje nga jashtë, sidomos nga NATO-ja, atëherë gjykoj se formimi dhe mbajtja e ushtrisë do të ishin luks i tepruar që do pengonte zhvillimin e përshpejtuar ekonomik të Republikës së Kosovës. Dihet se është simbolikë më rëndësi për një shtet që të ketë ushtri, por në rrethanat e tanishme kohore e hapësinore, formimi dhe fuqizimi i ushtrisë së Kosovës nuk do të ishte garanci e mjaftueshme për mbrojtje të jashtme të Kosovës. Nëse kjo është e vërtetë, për çka të bindin analizat që mund të bëhen, atëherë përse do të na duhej "simbolika"?

Një argument tjetër me rëndësi është edhe "simbolika" dhe "sinjalizimi" që do t'u jepnim shteteve që po hezitojnë të njohin Republikën e Kosovës, sidomos organizimeve pacifiste që tani kanë ndikim të madh në botë dhe prandaj ato mund të krijojnë simpati e të lobojnë për njohje sa më të shpejt të Republikës së Kosovës, kur do të informohen se Republika e Kosovës nuk do të formoi ushtri.

Sa i përket "transformimit" të TMK-së, për të cilën spekulohej se e kishim ushtrinë (dhe tani ata që mashtronin se e kishim ushtri, as nuk skuqen dhe as nuk zverdhën), zgjidhja më e qëlluar do të ishte që një pjesë e pjesëtarëve të saj, shumica ish-kuadro e ushtarë të devotshëm të UÇK-së, "të transformoheshin" në Gardë të Republikës, me rreth 1.000 pjesëtarë, e cila do merrej me mbrojtje të objekteve shtetërore të rëndësisë së veçantë dhe të pushtetarëve, duke i dhënë fund praktikës së badigardëve e shoferëve "privatë" e "shoqërorë" (aktorë ndërlidhës të korrupsionit). Pjesëtarë të tjerë të TMK-së "do të transformoheshin" në pjesëtarë të Agjencisë Inteligjente të Kosovës, në pjesëtarë të policisë kriminalistike dhe të SHPK-së. Përforcimi i këtyre strukturave me kuadro të mrekullueshme të TMK-së do të ishte një përforcim i sigurisë së brendshme, për të cilën aktualisht ka më së shumti nevojë Republika e Kosovës. Këto struktura do të mund të luftonin pastaj më me sukses korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Mosformimi i ushtrisë do t'i siguronte Republikës së Kosovës favore politike, financiare e zhvillimore. Një pjesë e mjeteve që do t'i harxhonim për ushtri do investohej për sigurinë e brendshme, duke ua dyfishuar rrogat ta zëmë policëve (që do të ishin edhe rreth 20 milionë euro më shumë në vit), pjesa tjetër do të shpenzohej për zhvillim të përshpejtuar ekonomik.

As argumenti se do të na duhet ushtria për ta mbrojtur Republikën e Kosovës nga pushtimi serb nuk është gjithaq bindës. U dëshmua në praktikë se kur do populli të mbrohet e të çlirohet, organizohet shumë shpejt, siç ndodhi me UÇK-në tonë famëmadhe, që organizoi e udhëhoqi me sukses Luftën tonë Çlirimtare.

2. ZHVILLIMI DEMOKRATIK

2.a. Rrugëtimi i demokracisë ("sundimit të popullit")

Për demokracinë ("sundimin e popullit") dihet se e ka zanafillën në shtetin antik të Athinës. Qytetërimi antik i Athinës, që prodhoi demokracinë nismëtare në Evropë, nuk duhet të ketë qenë i rastësishëm, por i ndikuar nga zhvillimet e mëhershme pellazge, egjiptase, perse, ilire, etj. Atij zhvillimi qytetërues dhe asaj demokracie, goditjen e parë dhe tepër të rëndë ia dhanë luftërat pushtuese maqedonase, të komanduara nga mbreti Filip dhe pasardhësi i tij Aleksandri i Madh (356-223 p.e.s.). Maqedonia antike, pasi pushtoi fillimisht Ilirinë dhe qytet-shtetet e Greqisë, invadoi drejt Persisë dhe së fundi edhe drejt Indisë. Atë e pasoi invadimi romak, i cili, pos pushtimit të Evropës Juglindore, u zgjerua drejt Azisë, Afrikës dhe Evropës Qendrore. Pushtimet e gjata romake bënë që edhe grekët antikë të tjetërsoheshin në helenë, ndërsa ilirët të asimiloheshin gati në përmasa të zhdukjes, duke lënë si dëshmi të gjeneve të tyre shqiptarët e sotëm. Por pushtimi ushtarak romak u shoqërua me "pushtimin" qytetërues grek e ilir të perandorisë romake, prandaj Perandoria e Romës përvetësoi segmente të demokracisë antike.

Sundimi i rëndë politik dhe ushtarak romak duhet të ketë "kushtëzuar" lindjen e krishterimit si fe, doktrina e së cilës është përmbledhur në librin e shenjtë Bibla. Pjesën më të madhe të saj (Torah, Ligjin e Vjetër), e përpiluan idealistët hebrenj. Mbështetur në besimin e vjetër hebre dhe duke vënë për bazë të një doktrine të re idetë ungjillore, që të krishterët ia atribuojnë Jezuit/Isait, të cilin e profetizuan dhe e mitizuan që ta bënin sa më tërheqës këtë besim, lindi besimi i ri

monoteist: Kristianizmi. Bibla përmban segmente me theks të qartë social, humanitar e paqësor dhe për kohën dhe shekujt pasues ishte "frymë" motivuese për besimtarët që i përvetësonte.

Sundimin e gjatë të perandorisë romake (nga shekulli i 5-të p.E.s deri në shekullin e 6-të të E.s.) e mundi mbipesha e vet në përfundim të antikitetit dhe në fillim të mesjetës (që kap hapësirën kohore nga shekulli i 5-të deri në shekullin e 15-të E.s), prandaj u copëtua në dy perandori: atë të Perëndimit, me qendër në Romë dhe atë të Lindjes (bizantine) me qendër në Konstantinopol (Istanbul). Me legalizimin e krishterimit në perandorinë romake nga perandori Konstandini i Madh në vitin 321, dhe me tjetërsimin e mëvonshëm të krishterimit nga doktrinë fetare pothuajse në platformë politike "shtetërore" (katolicizëm), sikur u kushtëzua "lindja" e feve të tjera, siç ishin myslimanizmi në shekullin e 6-të. Doktrina e kësaj feje u kodifikua në Kuran nga pasuesit e Muhamedit, në bazë të porosive të Zotit të përcjella përmes profetit Muhamed (i lindur rreth vitit 570 në Mekë dhe vdekur në Medinë, me **8. qershor 632**), siç besojnë besimtarët myslimanë. Më pastaj, nga katolicizmi "u nda" ortodoksia bizantine në shekullin e 11-të (viti 1054), me kryeqendër Konstantinopolin. Por edhe këto besime fetare i tjetërsuan fuqitë pushtuese të kohës, duke i shpërdoruar si "doktrina politike shtetërore". Kjo bëri që "demokracia popullore" e antikitetit grek të mbytej fare, bashkë me rënien e perandorisë romake, duke mbisunduar tashmë një errësirë e gjatë, e cila qe shoqëruar me lëvizje e luftëra të mëdha fetare.

Synimi evropian për t'u çliruar nga sundimi i Romës dhe i Konstantinopojës në aspektin politik dhe ushtarak dhe nga sundimi i Vatikanit dhe Konstantinopojës, në aspektin fetar, lindi "fraksionin" e ri kristian: evangjelizmin, i ideuar dhe i udhëhequr nga pastori Martin Luther (1483-1546), i cili frymëzoi popullsinë e Evropës Qendrore në përmasa shumë të shtrira që të përvetësonte këtë

variant të kristianizmit të modifikuar.

Edhe shpërdorimi i fesë islame si politikë perandorake otomane kushtëzojë lindjen e disa sekteve.

Zhvillimi shkencor, industrial e shoqëror dhe synimi për t'u çliruar nga errësira mesjetare, lindën fazën e parë të Renesancës Evropiane. Kjo u shoqërua me lindjen e demokracisë parlamentare, tashmë nacionale, që kishte zanafillën në formimin e parlamentit të parë anglez në shekullin e 13-të. Ai u plotësua me "luftën qytetare angleze", rezultat kulmor i së cilës ishte **Bill of Rights** (**Deklarata e të drejtave**) në vitin 1689. Mëpastaj, kjo demokraci, do merrte identitet më të konkretizuar e më të avancuar përmes ideve të **Jean-Jacques Rousseau**-it, përkatësisht me publikimin e ideve të tij, në vitin 1762, të përmbledhura si Kontratë shoqërore; principet e të drejtave politike *("***Du contract social; ou principes du droit politique***"),* duke barazuar sundimtarët dhe të sunduarit. Kurse **John Locke** dhe **Charles Montesquieu** ideuan ndarjen e pushteteve: në pushtet ligjvënës, gjyqësor dhe zbatues, duke vënë bazat për shtetin modern të së drejtës.

Paralelisht, edhe në Amerikën Veriore fillon të gjallërojë demokracia, që kishte si pararëndëse marrëveshjen e pesë fiseve indiane, e quajtur si Konfederata e Irokezve (*The Iroquois Confederacy*). **Benjamin Franklin** dhe të tjerë themelues të Shtetit amerikanë u influencuan shumë nga ajo Konfederatë kur hartuan Kushtetutën e parë të Amerikës (1787), e cila u shoqërua me themelimin e shtetit të parë demokratik. Ajo Kushtetutë u demokratizua më shumë me 10 amendamentet e vitit 1791.

Polonia ishte shteti i dytë në botë dhe i pari në Evropë, i cili mori formë të shtetit me rregullim shtetëror demokratik, duke miratuar rregullimin e tij me kushtetutën e vitit 1791. Ky proces "prodhoi" **Revolucionin francez** (1789-1799) dhe procese zinxhir në Evropë, që u shoqëruan me luftëra të gjata e të ashpra qytetare dhe ndërnacionale.

Në kohën e tanishme teoricienët tipizojnë katër lloje kryesore të demokracisë që karakterizojnë format e sistemit sundues: demokracinë e drejtpërdrejtë / direkte, demokracinë përfaqësuese, demokracinë radikale dhe demokracinë bazike. Ndërsa, po të përimtoheshin më shumë specifikat e demokracisë aktuale, mund të thuhet se sot kemi po aq shumë "lloje" të demokracive, gati sa kemi shtete në botë.

Nuk është ligësi - përkundrazi është përparësi e virtyt - që të pranojmë se shoqëria jonë shqiptare aktualisht gjendet në një fazë të zhvillimit parademokratik, ku pjesa më e angazhuar e shoqërisë sonë ka ca njohuri sipërfaqësore teorike për sistemin, shtetin e shoqërinë demokratike, por nuk është në gjendje t'i praktikojë këto njohuri, e sidomos nuk ka ende afinitet për të zbatuar përpikmërisht Kushtetutën e sapomiratuar dhe ligjet përcjellëse të Republikës se Kosovës. (Për këtë dëshmojnë edhe dilemat e vet Presidentit, i cili po ngurron t'i pëmbahet taksativisht Kushtetutës.) Për këtë ngecje shumëplanëshe të shoqërisë sonë, më së shumti kanë ndikuar rrethanat e derikëtushme zhvillimore, përkatësisht pushtimi mijëravjeçar.

Gjatë zhvillimit historik populli ynë ka zhvilluar e praktikuar njëfarë demokracie autentike, mund të thuhej "njëdimensionale", për aq sa ia kanë lejuar pushtuesit hapësirat e "gjallërimit". Ato duhet të kenë qenë mbetje të kulturës pellazgo-ilire, që kanë mundur t'i mbijetojnë asimilimit. Kështu, qysh në mesjetë, edhe pse kryesisht të pushtuar, janë miratuar kode zakonore, të cilat, po të krahasohen me kodet zakonore të asaj kohe të popujve tashmë të zhvilluar, duhet të ndjehemi krenarë se ishim ndër më përparimtarët. Këtë konstatim nuk e kam nga njohja ime profesionale e kodeve zakonore mesjetare të popujve, por të dëgjuar në ligjërata në Universitetin e Bochum-it nga një profesoreshë gjermane, e afirmuar në botë për njohjet e kodeve zakonore të shumë popujve. Kodet zakonore shqiptare ishin kode të principatave shqiptare dhe populli ka vazhduar t'i praktikojë më pastaj në jetë të përditshme, për

aq sa ka mundur t'i krijojë vetes hapësirë veprimi nën pushtimet e rënda bizantine, bullgare, serbe, otomane e përsëri serbe. Dhe, çuditërisht, edhe pse nuk kishte mundësi t'i kishte të shkruara ato kode zakonore, populli ynë i ruante ato duke u bazuar në dhuntinë e mbamendjes.

Pushtimi shumëshekullor otoman popullin tonë e solli buzë asimilimit të përmasave të mëdha, kryesisht përmes të shpërdorimit të fesë myslimane. Myslimanizmi po pasonte kristianizmin katolik dhe ortodoks, që ishte i përfshirë në luftëra e tjetërsime të deriatëhershme fetare në Perandorinë e Bizantit, të Bullgarisë e të Serbisë. Fatkeqësisht askush nuk është përpjekur për të bërë studime se sa shqiptarë përdhunshëm janë bullgarizuar, serbizuar e turqizuar gjatë atyre pushtimeve shumëshekullore, duke shpërdoruar edhe fetë përkatëse. Megjithatë, populli ynë ia doli të mbijetojë dhe prandaj e "lindi" Rilindjen e vet kombëtare në shekullin e 19-të. Ajo pasonte përpjekjet e mëdha çlirimtare qysh nga shekulli i 15-të dhe më vonë, në shekullit të 18-të e 19-të (nën udhëheqjen e prijësve si Gjergj Kastrioti, Ali pashë Tepelena, Dervish Cara, etj.). Dy kryengritjet e fundit antiosmane u paraprinë kryengritjeve çlirimtare greke (të udhëhequra nga arvanitasit) dhe serbe, në dekadat e para të shekullit të 19-të. Rilindja jonë kombëtare mundi të prodhojë vetëm një shtet të brishtë shqiptar (1913), i cili përfshinte vetëm rreth një të tretën e hapësirave që i banonin shqiptarët. Sundimin turk në Kosovë e zëvendësoi sundimi serb (1878-1914 dhe 1919-1941). Edhe pas çlirimit nga pushtuesit nazi-fashistë, në vitin 1945, Kosovën e ripushtoi Serbia. Qëkur ndodhi ky pushtim serb e deri në vitin 1974 Kosovës nuk i është lejuar të vetorganizohet me ndonjë element të shtetësisë. Pas Luftës së Dytë Botërore Serbia ushtroi në Kosovë një diktaturë ushtarake, pastaj ajo diktaturë u zëvendësua me disa të drejta krahinore ("obllast"), meqë kaq deshi t'i jepte udhëheqja federative jugosllave Kosovës së ripushtuar.

Të gjitha zhvillimet shoqërore në Kosovën e pas Luftës së Dytë

Botërore (1945) ndodhën nën diktaturën totalitare komuniste. Edhe në ato rrethana, popullit tonë iu desh "të mbijetonte", kryesisht duke zbatuar kodet zakonore, meqë ligjet shtetërore i refuzonte si ligje të pushtuesit. Me reformat kushtetuese të vitit 1974 populli i Kosovës mundi të frymonte me pak elementë të shtetësisë dhe ligjet që miratonte Kuvendi i KSA të Kosovës po zëvendësonin çdo ditë e më shumë kodet zakonore, meqë edhe sistemi monist qe liberalizuar paksa dhe qe shndërruar në një sistem hibrid, të quajtur "vetëqeverisje socialiste". Edhe në rrethana të reja, pas reformës kushtuese, pushtetin totalitar vazhdonte ta ushtronte Lidhja Komuniste përmes "levës" së saj, Lidhjes Socialiste të Popullit Punues (LSPP).

Zhvillimi i hovshëm i arsimit, i ekonomisë dhe i shoqërisë, sidomos në vitet 1970 të shekullit të kaluar vetëdijesoi e ndërgjegjësoi shqiptarët e Kosovës që të angazhoheshin për të kërkuar të drejta të barabarta për KSA të Kosovës, të njësojshme me republikat e tjera në ish-RSFJ. Siç ishte atëherë praktikë në shumë vende të botës, rol paraprijës mori lëvizja studentore. Por ajo lëvizje u shtyp me terror shtetëror. Klasën e pakonsoliduar politike të Kosovës e përçau Beogradi, duke përjashtuar politikanë me ndërgjegje më të madhe kombëtare e sociale dhe duke imponuar disa të tjerë që kishin ego njëdimensionale e primitive, të cilët populli i quante *lakej*, *tradhtarë*, *serbofilë*.

Ndërkohë, në mesin e viteve 1990, intelektualët e guximshëm shqiptarë, të organizuar në Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës, morën guximin që ta kritikonin unitarizmin nacionalist serb, por udhëheqja komuniste e Kosovës (Komiteti Krahinor), e zhbëri këtë Lidhje duke i imponuar "udhëheqje" të përdhunshme. Ky ishte një reagim institucional, por goditje frikësuese, izoluese e përçarëse që iu imponua, për intelektualët patriotë shqiptarë ishte goditje e rënd frikësues, njëherit ishte një goditje dekurajuese për popullin shqiptar në KSA të Kosovës.

Nacionalizmi serb në fund të viteve 1990 po nxirrte krye dhe po

insistonte ta shndërronte RSFJ-në në një Jugosllavi unitariste, të komanduar nga unitaritët serboëdhenjë. Ky zhvillim detyroi klasën politike sllovene dhe kroate që të mbrojnë interesat e republikave të tyre dhe, prandaj, mund të konstatohet se ishte fillimi i zhbërjes se ish RSFJ-së. Për këto rrethana e mundësi të reja populli i Kosovës u ndërgjegjësua dhe bëri protesta paqësore gjithëpërfshirëse, kundër nacionalizmit unitarist serb, në krye me *Führer-in* Milosheviq. Serbia u kundërpërgjigj me suspendim të përdhunshëm të Kushtetutës (1989), gjegjësisht të autonomisë së KSA të Kosovës. Si kundërreagim shqiptarët shpërbënë formacionet e deriatëhershme komuniste, siç ishin Lidhja Komuniste dhe *levat* e saj, Lidhja Socialiste e Popullit Punues, Lidhja e Rinisë Socialiste, Lidhja e Grave Socialiste, etj. Por Beogradi nacionalist serb kishte sajuar skenarin e vet të riorganizimit të kontrolluar të popullit shqiptar, prandaj toleroi të ashtuquajturin "shtet alternativ", "organizim pluralist", "parti legale" në Kosovë. Kryetarët e partive politike shqiptare, partitë e sapoformuara, "i legalizuan" në Beograd (edhe pse sipas të drejtës juridike të kohës duheshin të legalizoheshin në Prishtinë). Këta kryetarë të partive, të rreshtuar pas *Njëshit*, "shtypën" protestat gjithëpërfshirëse shqiptare, duke konsoliduar komandimin individual. Analistët e vëmendshëm dhe të sinqertë, si dhe dëshmitarët e të dy formave të organizimit, para dhe pas vitit 1990, po deshën mund të ndriçojnë të vërtetën, se më shumë demokraci të brendshme partiake ka pasur në Lidhjen Komuniste të Kosovës gjatë viteve të '70-ta, sesa në partitë, tashmë "pluraliste" e "demokratike" të krijuara gjatë viteve 1989-1991, të cilat mjeshtërisht qetësuan dhe kontrolluan me sukses popullin deri në vitin 1998, duke ia lehtësuar kështu sundimin Beogradit nacionalist dhe duke i dhënë atij "argumente" se nuk po pëndorte dhunë, se Kosovën e kishte zonën më të qetë, se shqiptarët po i toleronte të organizoheshin e të vepronin politikikisht, siç ua dëshironte qejfi...

Vetëm një subjekt politik, Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), e

organizuar "ilegalisht" në Kosovë (si "ilegale" e trajtonte Beogradi dhe partitë "legale" në Kosovë, por ajo nuk ishte ilegale, gjegjësisht e kundërligjshme) dhe "legalisht" në Perëndim, që përndiqej me brutalitetin më të madh nga organet policore të Beogradit, kishte demokraci të brendshme, sepse debatet për platformën themeluese e avancuese politike pluraliste ishin vërtet në frymë pluraliste e demokratike dhe zgjedhjet, kriter ky kryesor i demokracisë se brendshme, në të gjitha nivelet bëheshin me votim të fshehtë. Dhe ishte kjo Organizatë që themeloi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (në vitin 1993), e udhëhoqi atë politikisht, u angazhua për ndihmim financiar e për pajisje të saj ushtarake, por habitshëm meritat e saj përvetësohen, tjetërsohen, përfolën, duke shkuar drejt dënimit të saj me heshtje e injorim!...

Shqiptarët e Kosovës, duke mos pasur udhëheqje të denjë politike e kombëtare në vitet e '90-ta, u detyruan të vetorganizohen për të mbijetuar. Këtë organizim ata e bënin pa qenë të udhëhequr nga kryetarët partiakë, edhe pse vetë qytetarët këtë lloj organizimi e angazhimi e quanin partiak. Në këtë vetorganizim kishte elemente të theksuara të demokracisë njëdimensionale, kishte shpirt sakrifice e solidariteti, kishte edhe guxim të lartë për t'i dalë në mbrojtje dinjitetit kombëtar të nëpërkëmbur nga Beogradi fashist. Të gjitha këto angazhime kombëtare *Njëshi* nuk i lejonte të përshkallëzoheshin në rebelim aktiv, kombëtar e qytetar. Ato po i ndrydhte "platforma" e ashtuquajtur gandiste dhe e "durimit mjeran", e komanduar nga *Njëshi*, që vetëm në performancë dukej i butë, shoqëruar me paraqitje prej profeti (kurse në "kuvende" të LDK-së dhe në mbledhjet ndërpartiake, komandonte si gjeneral). Beogradi nacionalist me perfiditet toleronte dhe i mbronte kryetarët e partive "legale" në Kosovë, ndërsa i përndiqte e i terrorizonte aktivistët partiakë dhe të rinjtë shqiptarë për t'i detyruar që të arratiseshin në Perëndim e gjetiu. Dihet se rreth 400 mijë të rinj kanë emigruar vetëm gjatë viteve 1990-1997 në Perëndim.

Që të hutonte dhe topiste edhe më shumë popullin shqiptar në Kosovë, Beogradi toleroi mbajtjen e Kuvendit në Kaçanik, shpalljen e pavarësisë, formimin e "qeverisë së Republikës së Kosovës", zgjedhjen e "presidentit", "zgjedhjet e lira", etj. Vetëm mjeranët vazhdojnë të besojnë se këto nuk mund t'i dinte e nuk mund t'i ndalonte Beogradi i gjithëpranishëm dhe i gjithëpushtetshëm.

Duhet pranuar se të gjitha këto taktika të kamufluara të Beogradit për t'i nënshtruar "paqësisht" shqiptarët e revoltuar, dështuan me formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1993) dhe me rebelimin e hapur të studentëve në vitet 1996-1998. Nuk druaj aspak që të shpreh edhe supozimin se, pothuajse aksidentalisht, funksionoi kombinimi i angazhimit "paqësor" dhe atij të armatosur, kombinim ky spontan, që përshpejtoi ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës.

Ndodhi, pra, mrekullia: Çlirimi i Kosovës nga pushtimi serb (1999)! Erdhi koha që njerëzit përparimtarë të shpresonin se populli i çliruar, i cili tashmë po festonte mbijetesën më shumë sesa çlirimin, do të vetorganizohej lirshëm në partitë që do përzgjidhnin qytetarët dhe nuk do të pranonin më që t'i komandonin kryetarët e vjetër dhe të ri. Por kryetarët u treguan të aftë për të uzurpuar "demokracinë" për vete dhe lanë popullin dhe anëtarët e partive të tyre me gisht në gojë.

Ndodhi edhe një e keqe e madhe: Pas çlirimit nuk u kompletua, prandaj as nuk funksionoi, qeveria e përkohshme. LDK-ja as nuk i dërgonte përfaqësuesit e vet në atë qeveri, as nuk jepte shpjegime përse nuk i dërgonte. Nuk kishte kush të vendoste, pasi paarsyeshëm mungonte *Njëshi*, prandaj në atë Lidhje nuk kishte *dysh, tresh*, që të merrnin vendime. Ky defekt, pak është të thuash skandaloz, me gjasë nxiti ndërkombëtarët që Kosovën ta shndërronin në protektorat, meqë gjykuan se klasa politike nuk është në gjendje të qeverisë Kosovën.

Kultura dhe përvoja e demokracisë se deriatëhershme njëdimensionale ndihmoi shqiptarët pas Luftës që të vetorganizoheshin, pa pasur qeveri

e klasë funksionale politike. Me ka rastisur të dëgjoj një funksionar gjerman, me pozicion të lartë në UNMIK, për mrekullimin e tij nga mirësjellja e qytetarëve shqiptarë, nga bujaria, nga njerëzillëku. Ishte i njëjti, më të cilin para e gjatë Lufte kisha debatuar për paragjykimet e tij antishqiptare.

Riorganizimi e organizimi partiak zuri të ndrydhte demokracinë popullore. Sërish u imponuan *njëshat*, ngase qytetarët nuk qenë në gjendje t'i kundërshtojnë ata dhe ngase intelektualet e Kosovës shumë shpejt u zhgënjyen, u tkurrën, nga sjelljet prej *harambashësh* të disa prej ish-drejtuesve të UÇK-së, të cilët, duke mos qenë në gjendje të përballonin dëlirin e famës dhe duke mos ditur të menaxhonin njerëzishëm autoritetin e tyre shpërthyes, njëherit duke mos qenë në gjendje të përballojnë tundimin e parasë, gjegjësisht pasurimit të pandershëm, u bënë "kapedanë" partiakë.

Sa shkonte koha, aq më shumë po "lulëzonte" lustra e demokracisë. Për këtë shkak populli i zhgënjyer, i manipuluar dhe ende i paçliruar nga diktatura shpirtërore e *Njëshit*, ndëshkoi me votën e tij në zgjedhjet e para, të lira, "çlirimtaret" e "fitimtarët" dhe shpërbleu pameritueshëm *Njëshin!* Të gjithë analistët politikë, shqiptarë e ndërkombëtarë, i habiti ky fakt, pasi ishte rast unik në botë që pas lufte të humbin në zgjedhje ata që e kishin udhëhequr Luftën Çlirimtare!

Shumicën shqiptare i zhgënjeu edhe blerja dhe ndërtimi i vilave nga pretendentët për pushtet. Asnjë kundërshtar i tyre nuk do të kishte më shumë sukses në fushatën denigruese kundër atyre pretendentëve për pushtet, sesa blerja e ndërtimi i vilave, për realitetin e Kosovës, tepër fodulle. Drejtuesit e luftës, edhe luftëtarë të shquar, me këso veprime, harxhuan shpejt famën e tyre të madhe, sepse populli e dinte se ata nuk kishin dëshmi se po i blinin me kursime ose me përfitime nga puna dhe biznesi i tyre i ndershëm. Edhe sikur t'i kishin pasur para Lufte paratë, ata nuk kishin të drejtë njerëzore t'i kishin pas Lufte, sepse ata u bënin

thirrje të gjithë shqiptarëve që të jepnin gjithçka, edhe jetën, për Luftën, kurse këta nuk do guxonin t'i rezervonin paratë e tyre për të blerë e për të bërë vila pas Lufte. Bile edhe bashkëluftëtarët e tyre po fillonin t'i urrenin të tillë keqsjellës e keqbërës, sidomos për pasurimin e tyre të shpejt e të pandershëm, derisa fëmijët e të rënëve në luftë përballeshin me vështirësitë e furnizimit me ushqim e veshmbathje. Pastaj filluan abuzimet nga disa drejtues të Luftës, të cilët po "privatizonin" e transferonin varrezat e dëshmorëve ku atyre u tekej, të cilët po përvetësonin e komercializonin luftëtarët e rënë për afirmim e pasurim të tyre, etj. Kurse, sa i përket *Njëshit,* secili koment do të ishte i tepërt. Shqiptarët grumbulluan ndihma për të blerë "rezidencën presidenciale". Ai e tjetërsoi atë "rezidencë", gjegjësisht e përvetësoi dhe e privatizoi në mënyrën më vulgare. Pas Lufte, duke u bërë shembull pothuajse i parë për të keq, e ngriti pa leje ndërtimi atë "rezidencë" në "kala". Tani mund të shtrohet pyetja: Di ndokush se ku i mori të hollat *Njëshi*, pasi nuk i kishte fituar me punë? Apo ndoshta angazhimi i tij çmohet punë e madh meritore dhe prandaj meritonte të shpërblehej me një "kala"!?. Dhe po të qëndron versioni i dytë, nuk ka përse të shpaguhet angazhimi i tij dyfish, me para dhe njëkohësisht me respekt prej idhulli. Kështu ai ua hapi rrugën masakruesve urbanistikë të Prishtinës, sepse, kur *Njëshi* ndërtonte ilegalisht, përse do të vetëpërmbaheshin "ushtarët" e tij dhe të tjerët!? Kjo "shpifje" imja ka histori vazhduese, sa qesharake, aq edhe kompromettuese: Nga buxheti i Kosovës, familjes së *Njëshit* i paguheshin (ndoshta edhe tani), rrumbullak 20 mijë euro (po, po, njëzetë mijë euro) qira mujore për "rezidencën presidenciale". Edhe nëse ishin për "profetin" *Njësh* - të tepërta ishin...

Të gjitha këto keqbërje ndikuan që udhëheqësit politikë të ndëshkoheshin nga votuesit edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare, me ç'rast shumica e votuesve shqiptarë (afër 70 për qind) vendosi t'i injorojë me mos dalje në zgjedhje. Dhe ky argument është dëshmia më kokëforte

se nuk garuan liderë, por miniatura të tyre (që unë shpesh i quaj *liderucë*), gjë e cila është dëshmia më skandaloze e mospranisë se demokracisë në Kosovë. Natyrisht, këtë mos dalje në masë në zgjedhjet parlamentare, në kohën kur po pritej të vendosej për pavarësinë e Kosovës, demagogët u munduan ta arsyetojnë me shpifjen se në disa shtete të zhvilluara demokratike mosinteresimi i qytetarëve për pjesëmarrje në votim është po kaq i madh (përkundrazi, në Gjermani në zgjedhjet e fundit morën pjesë 77.5 për qind të qytetarëve me të drejtë vote).

Po shpresoj se ky synopsis i rrugëtimit historik të demokracisë perëndimore dhe të demokracisë tonë njëdimensionale, gjegjësisht parademokracisë, përmban argumentime të bollshme, për të kuptuar procesin zhvillimor të shoqërisë perëndimore dhe të shoqërisë sonë, gjegjësisht të demokracive përkatëse. Dhe domosdo që do të duhej t'i vëmë gishtin kokës: duam të gëlojmë në këtë kënetë "demokratike" apo duam ta zhvillojmë parademokracinë tonë drejt demokracisë së zhvilluar perëndimore.

"E shkuar - e harruar" - thotë populli. Gjërat rikujtohen e analizohen për të parë rrugën nga kemi ardhur, kur e si kemi gabuar, mundësisht që të përmirësojmë gabimet dhe, që është më me rëndësi, të gjejmë zgjidhje më të mira për rrugëtim të mëtejmë. E kaluara nuk duhet të rikujtohet e analizohet me inat, e që është edhe më keq, me qëllim që të pengohet rrugëtimi sa më i mbarë drejt së ardhmes.

Rëndom e quaj kulturë demokratike që të mos hezitohet me kritika konstruktive dhe të paanshme. Por ndodh që kritikat të sforcohen me dozë mërie e inati, kur kritikuesi nuk është i vetëpërmbajtur, kur ai është tendencioz, kur sajon "fakte" dhe shtrembëron e shpërdoron gjysmëfaktet. Në rast të tillë kritikuesit nuk do të duhej t'ia merrte seriozisht njeri fjalët, duhet të diskualifikohet si kritizer!

Ata që kritikohen gjithsesi janë personalitete publike, të mirë, gjysmë të mirë ose të këqij, dhe prandaj lavdërohen ose kritikohen, nëse punojnë

ose nuk punojnë mirë. Unë po u qepem me kritika, ndoshta të tepruara, liderëve partiakë, pasi dëshiroj të avancojnë në liderë të mirëfilltë politikë e kombëtarë, meqë është në interes të tyre, timin, të qytetarëve, të përparimit tonë të gjithëmbarshëm. Edhe si liderë të tillë partiakë i respektoj, sepse dua të respektoj votuesit e tyre. Bëj kështu sepse dua të respektoj edhe këtë parademokraci, pasi dua të respektoj edhe këtë nivel të funksionimit të strukturave partiake dhe të institucioneve shtetërore, me shpresë se do të ndodhin përmirësime të përshpejtuara.

Si përmbyllje të paraqitjes se prejardhjes dhe zhvillimit të demokracisë dhe të gjendjes tonë aktuale shoqërore, do të sugjeroj që qytetarët të ndërgjegjësohen për përgjegjësitë e tyre politike dhe shoqërore, pasi po u përcaktuan vetëm për pritje të përmirësimit e të demokratizimit të vetvetishëm të liderëve "tanë" aktual politik, do rrezikojmë ardhmërinë e tonë demokratike, do rrezikojmë shtet-bërjen e shtet-ndërtimin e Republikës sonë.

2.b. Profilizimi, demokratizimi e rritja e partive politike përshpejtojnë shtet-bërjen

Pa u thelluar në analizimin e zhvillimit të partive politike, shpreh mendimin tim se partitë tona pothuajse nuk kanë demokraci të brendshme. Ndonjëra ngjan me ndonjë firmë private, ndonjë tjetër komandohet nga lideri përkatës partiak. Kemi edhe nga ato parti, të cilat përfliten për organizime të fshehta brenda radhëve të saj, prestarët e të cilave organizimeve paguhen fshehurazi nga burime financiare dubioze e diverze. Këto organizime të fshehta i quanin shërbime inteligjente. Si të tilla, sigurisht që ushtronin veprimtari gjysmë legale. Ato nuk financoheshin nga buxheti i shtetit dhe nuk raportonin për veprimtari të tyre para institucioneve kompetente shtetërore, meqë Kosovën nuk e

kishim shtet, por një UNMIK-istan. Çuditërisht edhe UNMIK i toleroi ato! Dhe të tilla organizime gjysmë ilegale angazhoheshin kryesisht për të kontrolluar anëtarësinë, ta zëmë që mos bëjnë oponencë ndaj bosëve të partive ose të ndikonin në politikën kadrovike. PDK këtë lloj organizimi e pat emërtuar SHIK dhe thoshte se është shtetëror. LDK e quante Sigurimi i Atdheut. Deri sa i pari shërbim, sapo u miratua Kushtetuta e Republikës se Kosovës, e cila sanksionon shërbimin inteligjent legal (ligjor) shtetëror, shpërbëri vetveten, për të dytin nuk kemi dëgjuar të jetë shpërbërë. Këto lloj organizimesh të fshehta do vazhdojnë të mbartin me vete edhe për një kohë veprimet dhe shprehitë, tashmë të shndërruara në vese dhe prandaj do frenojnë edhe për një kohë demokratizimin e përshpejtuar të partive, pasi pjesëtarët e tyre ndoshta vazhdojnë të marrin paga për angazhime pasuese (deri sa të ndodh sistemimi i tyre në shërbimin inteligjent shtetëror, siç do pritet të manovrojnë partitë e koalicionit qeverisës). Veprimtaria e tyre e organizuar, gjithsesi gjysmë ilegale por e dukshme, të shpresojmë e fundit, duhet të ketë qenë angazhimi i tyre për të manovruar me votat brenda numërimeve partiake, siç përflisnin kandidatët humbës të listave zgjedhore për Parlament, që të nxjerrin të fituar kandidatë të dëgjueshëm ndaj shefave të tyre. Prandaj pasuan dhe priten edhe të tjera përplasje brenda-partiake. Dhe ndoshta janë pikërisht ndikimet e këtyre organizimeve të fshehta që po pengojnë **pakuptueshëm** gjetjen nga koalicioni qeverisës të një drejtuesi të shërbimit të ri edhe pas kaq shumë muajve!

Edhe një numër i madh i anëtarëve të partive politike nuk janë për t'u lavdëruar. "Si hoxha - si xhemati", shprehet populli. Po të kishin të gjithë anëtarët kulturë demokratike, atëherë do kishin ndikuar në përmirësimin e udhëheqësve të tyre partiakë, duke imponuar konkurrencën e vlerave dhe përzgjedhje demokratike të kuadrit drejtues. Realitet i hidhur është se shumica e anëtarëve po shndërrohen në "argatë" të kryetarëve dhe klaneve të tyre të ngushta, me shpresë se po fitoi kryetari "i tyre", do t'i shpërblejë pastaj me shpërdorim të pushtetit.

Demokracia e brendshme e partive në Perëndim është shumë aktive

dhe me përmbajtje thelbësore. Nga përvoja personale kam vërejtur se atje, anëtarësia, takohet pothuajse një herë në muaj. Në ato takime diskutohen problemet në lagje e rrethe, diskutohet për vendimet dhe politikat e kryesisë se partisë, jepen vërejtjet dhe sugjerimet për to, përkrahen ose kundërshtohen kuadrot, etj. Strukturat drejtuese i shqyrtojnë me seriozitet mendimet e bazës. Pastaj, të gjithë anëtarët, informohen personalisht me shkrim për aktivitetet e vendimet e partisë, më herët me dërgesa postale, tani kryesisht përmes adresave elektronike.

Edhe pse janë demokraci të zhvilluara, partitë në Perëndim kanë fondacionet e tyre partiake që merren me organizim të seminareve të shumta për anëtarësinë, për të trajtuar tematika të demokracisë e të zhvillimeve shoqërore, sociale e ekonomike. (Shumëkush në Kosovë ka dëgjuar për Fondacionin Friedrich-Ebert, që është i Partisë Social-Demokarte Gjermane / SPD, Fondacionin Konrad Adenauer / CDU, Fondacionin Heinrich Böll / Grüne Partei, etj.) Ato seminare, që mbahen kryesisht në fundjavë, i vizitojnë anëtarët që kanë kohë dhe që janë të interesuar. Temat në seminare i ligjërojnë aktivistë e funksionarë të partisë, por edhe profesorë mysafirë. Për këtë mund të bindet secili që dëshiron të informohet, nëse viziton faqet në internet të partive në Perëndim dhe fondacioneve të përafërta me to. Në Kosovë nuk kam dëgjuar ndonjëherë që partitë të organizojnë seminare edukuese për anëtarësinë. Mbase nuk i kanë kushtet, apo ndoshta mendohet se anëtarësia është e edukuar dhe e motivuar në nivelin e duhur. Nuk po ngurroj të shpreh dyshimin se komandantëve të partive po u intereson që anëtarët e partive "të tyre" të jenë sa më injorantë. Ata po vetëkënaqen me "vizita" të rralla që i bëjnë anëtarësisë në bazë dhe t'u mbajnë fjalime "të flakta" politike e patriotike, sa për të rritur akoma më shumë autoritetin e tyre komandues.

Në partitë politike në Perëndim, në anëtarësinë bazë janë aktivë shumë intelektualë me kualifikime të larta, profesorë, avokatë, gjyqtarë, mësues, biznesmenë, studentë, por edhe punëtorë e fshatarë. Një "përzierje" e tillë e socializon dhe e qytetëron më shumë anëtarësinë,

meqë në parti, ndodhin bashkangazhime shumë gjithëpërfshirëse. Në partitë "tona" fatkeqësisht nuk po hetoj asgjë të përafërt.

Problem tjetër serioz me të cilin ballafaqohen partitë tona janë financimi i tyre. Partitë, ta zëmë në Gjermani, mund t'ia lejojnë luksin vetes për të gjitha angazhimet e sipërpërmendura, sepse kanë mjete solide financiare, të cilat e kanë burimin nga anëtarësia, nga buxheti i shtetit, nga donacionet e deklaruara. Kurse partitë tona ndoshta marrin fond simbolik nga buxheti i shtetit. Pastaj partitë tona nuk kanë të ardhura financiare nga anëtarësia, sepse shumica e anëtarëve janë skajshmërisht të varfër dhe të papunë, kurse ata pak që kanë të ardhura, nuk i ndihmojnë partitë ku peshojnë. Ndërsa në Gjermani parlamentarët evropianë, federativë, republikanë, komunalë, që marrin rroga të mëdha, pothuajse e kanë të përcaktuar përqindjen e pagës për buxhet të partisë. Nuk besoj se parlamentarët, ministrat, funksionarët, që i dërgon partia në Kuvend e në Qeveri të Kosovës, japin diçka nga paga e tyre për partitë përkatëse.

Kur të gjitha këto mungojnë, atëherë udhëheqja e partisë "dety-rohet" të financohet nga burime të inkriminuara, nga ndihmat e kushtëzuara të biznesit dhe nga shpërdorime të tjera. Prandaj, që të zbutet kjo gjendje, gjegjësisht që të ndihmohen partitë për t'u demokratizuar sa më shumë, Kuvendi duhet të marrë vendim që t'u ndajë partive nga buxheti shtetëror mjete financiare, një sasi të mjaftueshme, për funksionim normal të tyre. Ndoshta do të mjaftonin rreth 20 euro në vit për çdo votë të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Kjo kuotë do i kushtonin buxhetit të shtetit rreth 16 milionë euro në vit, nëse do të dilnin në votim gjysma e qytetarëve me të drejtë vote.

Një defekt tjetër i madh është hezitimi i intelektualëve me kualifikime të larta që të anëtarësohen dhe të zhvillojnë aktivitete në kuadër të partive, në kohën kur nuk kanë angazhime profesionale. Shpesh herë mund t'i dëgjosh intelektualët duke u ankuar kundër partive dhe duke dhënë leksione moraliste në tryezat e kafeneve. Por, kur i kundërshton me faktin se edhe ata janë fajtorë për mos anëtarësimin dhe me

mosangazhimin e tyre, mbrohen me argumentime se nuk mund të durojnë praktikën e komandimit nga lart dhe injorancën e anëtarësisë nga poshtë. Pastaj intelektualët me kualifikime të larta ankohen se si kryetarët po rekrutojnë e po kooptojnë vetëm intelektualë të dëgjueshëm. Nuk ke si i kundërshton, nëse mban parasysh vetëm mënyrën e qasjes së tyre. Por ka hapësirë për t'i qortuar për shpjegimet arsyetuese të tyre, sidomos për mosangazhimin e tyre. Për gjithë shoqërinë tonë, edhe për intelektualët, është me rëndësi që partitë të zhvillohen e të demokratizohen sa më shumë e sa më shpejt. Duke u anëtarësuar në parti intelektualë me kualifikime të larta profesionale dhe kulturë sociale dhe duke e nxitur bazën për të bërë aktivitete edhe edukuese, do t'i jepet një ndihmë e madhe gjithë shoqërisë, sepse anëtarësia në bazë do të ndikohej e ndihmohej nga intelektualët që të emancipoheshin më shpejt me kulturë sociale e demokratike. Kjo formë e angazhimit të intelektualëve do t'u mundësonte ngritjen në karrierën politike në parti dhe drejt pushtetit dhe kështu do të rritej niveli cilësor në parti e në pushtet. Angazhimi i intelektualëve nuk është denigrues, siç po pozojnë me fodullëk të shpifur disa intelektualë profesionistë. Përkundrazi, mosangazhimi i tyre është pasojë e mungesës së kulturës së zhvilluar shoqërore e sociale të tyre. Sidomos intelektualët duhet të jenë të informuar se mënyrë e funksionimit të demokracisë janë edhe partitë, prandaj kot mundohen të arsyetojnë mosangazhimin e tyre politik e qytetar, me gjoja, nivelin e lartë të tyre intelektual, që nuk i lejon "të bien" në nivel "kompromettues" të partive. Dhe meqë intelektualët nuk pranojnë të angazhohen në parti, në organizata joqeveritare e në shoqëri qytetare, atëherë u zvogëlohet e drejta morale dhe qytetare që të merren vetëm me kritikë e kriticizëm të gjendjes.

Dëshmi tjetër tepër kokëfortë se partitë tona nuk i kemi demokratike është fakti se këto nuk njihen nga partitë "simotra" evropiane. Ndodh kjo për shkak të mosprofilizimit të tyre ideor, filozofik, politik, social, demokratik. Kryetarët e partive tona ende nuk dinë cilit krah ideopolitik dhe cilës shtresë sociale i takojnë, pasi nuk u dalin përllogaritjet parashikuese të votave që dëshirojnë të marrin në zgjedhje. Ndodh

kështu pasi ata nuk kanë përgatitjen e mjaftueshme politike e demokratike, rrjedhimisht nuk kanë koncepte ideore e profilizuese. E kur kryetarët dhe kuadri drejtues nuk kanë profilizim, sigurisht se nuk ka as anëtarësia. Këtë e dëshmon më së miri lëvizja e "kuadrove" partiake nga një parti në tjetrën, vetëm për shkak se nuk janë zgjedhur në postin partiak që do të mund t'u siguronte përfitime financiare, ose vetëm pse kryetari nuk e ka qasur në rrethin e tij të ngushtë klanor. Kjo ngjan me transfertat e futbollistëve nga ekipi në ekip, për përfitime më të mëdha financiare. Ndryshe qëndron situata me partitë në Perëndim. Kuadrot e partive kanë koncepte, kanë bindje, gjegjësisht kanë profilizime, politike, ideore, sociale dhe prandaj nuk ndodhin transfere nga partia në parti as kur ndonjëri humb zgjedhjet parlamentare, as kur nuk votohen në postin e synuar partiak. Mosprofilizimi i partive tona, gjegjësisht mos anëtarësimi i tyre në të ashtuquajturat federata partiake evropiane, siç janë Internacionalja Socialiste, Federatat e partive popullore, të partive liberale, të partive ekologjike etj., bart në vete një dëshmi serioze të prapambetjes së tyre. Thënë të vërtetën, di se vetëm Partia Liberale e Kosovës është pranuar në Federatën e Partive Liberale të Evropës, dhe nga kjo ka pasur përfitime Kosova, pavarësisht faktit se kjo parti është tepër minore.

Mosanëtarësimi i partive tona në federatat përkatëse evropiane dhe botërore po i kushton njohjes së përshpejtuar të Republikës së Kosovës nga shumica e shteteve të botës, sepse këto federata janë të shtrira pothuajse në të gjitha shtetet, përkatësisht janë në pushtet në shtetet përkatëse. Po të kishin qenë të anëtarësuara partitë "tona", atëherë vetë ato federata do kishin bindur partitë përkatëse që janë në pushtet, që të njihnin Republikën e Kosovës edhe shumë shtete të Amerikës Latine, të Afrikës, të Azisë. Duke i vlerësuar partitë tona si jodemokratike dhe të paprofilizuara, atëherë na del se edhe shoqëria na vlerësohet si jodemokratike.

Te ne ende nuk kemi as profilizim social të popullatës, pasi tek tani jemi në fazën e parë të kapitalizmit vulgar. Për rrjedhojë, të gjithë "kuadrot" e partive tona në fushata zgjedhore ose në raste të tjera

kryesisht thonë se i përkasin qendrës. Ndonjëherë thonë se janë të djathtë, edhe pse bindjet dhe kulturën sociale, për aq sa kanë, i kanë të majta, për shkak të prejardhjes së tyre ose "të traditës" ideologjike. Programet dhe platformat e tyre partiake e elektorale ngjajnë në mes tyre si pikat e ujit, dhe po t'ua heqësh emrin e partive, nuk do të dinin as specialistët t'i dallonin programet e platformat se cilës parti i përkasin.

Drejtuesit e partive tona sikur nuk po dinë, prandaj po hezitojnë të përcaktohen se cilës federatë të partive evropiane duhet t'i drejtohen me kërkesa për këshillime, përkrahje e anëtarësim. Ato po presin njëra-tjetrën që "të identifikohen" të parat dhe pastaj partia tjetër, pas të parës, t'i drejtohet federatës tjetër. Dhe kjo pritje është e dëmshme. Me këtë pritje partitë tona i kanë humbur që 18 vjet, gjegjësisht që 9 vjet, pa u profilizuar dhe pa u anëtarësuar në federatat përkatëse të partive evropiane. Po të kishin qenë anëtare, federatat e partive evropiane do t'i kishin ndihmuar partitë tona financiarisht e politikisht, do t'i kishin përkrahur në fushatat zgjedhore, do t'i kishin ndihmuar në profilizim e demokratizim të brendshëm partiak etj.

Partitë tona tashmë duhet të kenë kurajë kombëtare, qytetare e politike për të anëtarësuar në radhë të tyre pjesëtarë të etnive të tjera nacionale, për të kontribuar kështu që të tejkalohet "pastërtia" dhe segregacioni nacional. Ky dhe drejtimi i kundërt, anëtarësimi i shqiptarëve në partitë e etnive minoritare, do ishte në interes madhor të Republikës së Kosovës, në interes të bashkëjetesës dhe të zhvillimit të përshpejtuar demokratik të shoqërisë sonë. Segregacioni nacional i partive frenon zhvillimin demokratik e multietnik të shoqërisë. Shikuar nga ky aspekt, të gjitha partitë në Kosovë tani mund të karakterizohen si nacionaliste, përderisa ruajnë përcaktimin e "pastërtisë" së tyre nacionale. Ende nuk po ndodh anëtarësimi multietnik, sepse kuadrot drejtuese të partive frikësohen se mos po humbin reputacionin e patriotizmit nacionalist, rrjedhimisht po frikësohen se do të humbin votat e votuesve që nuk janë të përgatitur për shoqëri multietnike e demokratike. Përgjegjësia më e madhe për këtë është e partive shqiptare, si parti të popullit shumicë. Ato duhet të hapen karshi pjesëtarëve të etnive të tjera. Partitë tashmë duhet të zhvillohen

drejt partive të qytetarëve, dhe jo të vazhdojnë të mbetën thjesht parti një-nacionale. Por, për të bërë këtë kapërcim cilësor, "kuadrot" drejtuese të partive tona duhet të kenë vizion dhe kurajë qytetare, duhet të vënë në plan të parë interesin shtetëror të Republikës së Kosovës, përkatësisht interesin për zhvillim të përshpejtuar multietnik e demokratik të shoqërisë sonë dhe pastaj interesin e tyre egoist për të qeverisur me çdo kusht, gjegjësisht për t'u pasuruar pandershmërisht përmes pushtetit që e marrin nga votues një-nacionalë.

Meqë partitë nuk i kemi demokratike, atëherë del se edhe shoqërinë nuk e kemi demokratike. Mund që është e kundërta, po të kemi parasysh pjesëmarrjen e ulët në zgjedhje. Shumicën e qytetarëve i kemi të vetëdijesuar demokratikisht, por meqë nuk garon asnjë parti vërtet demokratike, sipas kritereve të tyre, atëherë qytetarët, më të avancuar se demokracia e partive "tona" garuese për pushtet, nuk dalin në zgjedhje, pasi gjykojnë se nuk e meritojnë votën e tyre asnjë parti.

2. c. Mënyrat dhe kriteret e qasjes ndaj të kaluarës

Shumë energji dhe kohë po shpenzohet në "përpunimin" e të kaluarës sonë, sidomos historisë sonë të re, nga Lidhja e Prizrenit (1878) e deri në çlirimin e Kosovës nga pushtuesit serb (1999). Gjithsekujt që i teket të kërkojë rivlerësimin dhe rishkrimin e historisë, e bën menjëherë. Dhe kjo ndodh varësisht nga forcat që vijnë në pushtet. Në Republikën e Shqipërisë kjo dukuri është më e theksuar, por viteve të fundit edhe në Republikën e Kosovës po angazhohen individë e struktura që kjo të vihet në plan të parë. Dhe kjo nuk u kërkohet vetëm profesionistëve. Tashmë edhe politikanë nuk po përmbahen për të imponuar vlerësimet e tyre historike si vlerësime shkencore. Nuk po mund të përmbahen as diletantët e zhurmaxhinjtë kujdestarë. Këta po shkojnë aq larg, sa të shpallin edhe Gjergj Kastriotin, Abdyl Frashërin, Ismail Qemalin, Isa

Boletinin, Hasan Prishtinën, e të tjerë, deri edhe si tradhtarë, duke u përpjekur të imponojnë figura të tjera si më të merituara. Kjo praktikë po shtrihet deri në kohët më të reja, duke u përpjekur të ngatërrojnë e zhvleftësojnë sa më shumë sistemin e vlerave për figurat dhe për ngjarjet historike. Shkohet aq larg, sa t'u mvishen qortime gjithfarëshe shumë personaliteteve, që i paskëshin tradhtuar e shitur Kosovën dhe viset shqiptare te mbretëria serbe (1978-1913 dhe 1919) dhe te Jugosllavia (1945), pa qenë në gjendje të marrin në konsideratë konstalacionet e brendshme dhe të jashtme në kohë dhe hapësirë.

Qytetarët po "bombardohen" me qëndrime politike, gjithnjë duke i paraqitur si vlerësime shkencore, edhe për Lëvizjen Antifashiste dhe lëvizjen "nacionaliste" gjatë Luftës së Dytë Botërore. Po madhërohen kolaboracionistët e nazi-fashizmit, duke devalvuar aleatet e Aleancës së Madhe Antifashiste (ShBA, Angli, Bashkimi Sovjetik), etj. Rëndom bëhen zhvlerësime sipas skemës vetëm bardhë-e-zi, kush e tradhtoi dhe kush e shiti Kosovën, kush ishin "nacionalistët" e vërtetë "çlirimtarë" dhe kush tradhtarë, etj. Këto zhvlerësime po ndodhin në mënyrë tepër shabllone, duke anashkaluar konstalacionet përkatëse kohore e hapësinore. Për shembull, zhvleftësohen organizuesit dhe pjesëmarrësit e Konferencës së Bujanit, ku u morën vendime për çlirimin e Kosovës, dhe madhërohen kolaboracionistë të nazi-fashizmit, të udhëhequr nga Xhafer Deva, i cili, pos që ishte kolaboracionist i nazi-fashizmit, ishte edhe aleat i lëvizjes çetnike në krye me Drazha Mihajloviqin. Duket sikur qëllimisht duan të imponojnë falsifikime, se shqiptarët mundnin, por nuk deshën ta çlirojnë Kosovën, duke harruar qëllimisht se prapa Jugosllavisë pushtuese ishte Aleanca e Madhe Antifashiste dhe prandaj shqiptarët nuk kishin fuqi për t'iu kundërvënë vendimeve të Çërçilit, Rusveltit e Stalinit.

Për çdo lëvdatë janë forcat patriotike çlirimtare të Kosovës (që drejtoheshin nga Shaban Polluzha, Rifat Berisha e të tjerë), por edhe sikur i gjithë populli shqiptar të ishte i organizuar vetëm në një strukturë çlirimtare, vërtet nuk do ishte arritur çlirimi i Kosovës, sepse nëse nuk do të mund ta pushtonte Kosovën Beogradi, do e pushtonte dhe do ia

dorëzonte Beogradit Aleanca e Madhe Antifashiste. Por ka edhe nga ata që duan ta madhërojnë rolin e Lëvizjes Antifashiste të Kosovës (në krye të së cilës formalisht ishte Fadil Hoxha dhe bashkëveprimtarët e tij komunistë, realisht komandohej nga komunistët serbomëdhenjë).

Po sjell një shembull konkret, deri ku mund të shkoi marrëzia, tashmë e shndërruar në modë: Nacionalistët e tanishëm primitivë njëanshmërisht e diskualifikojnë edhe Heroin e Kosovës, malaziasin Milladin Popoviq, e degradojnë atë si armik të shqiptarëve, edhe pse dikur Nëna e tij dhe tani historiografia serioze malazeze, deri diku edhe ajo shqiptare, mbrojnë qëndrimin se Milladinin e vrau Beogradi serbomadh për arsye se u përpoq të nxirrte maksimumin për Kosovën në ato konstelacione të pas Luftës. Dhe nëse kjo është e vërtetë, ai e meriton të vlerësohet si më i merituar ta zëmë se sa Fadil Hoxha, siç e vlerësuan dhe po e vlerësojnë tani disa grupime individësh. Nuk duhet të anashkalohet Milladini vetëm pse ishte malazias. Tani është në modë të na imponohen si meritorë disa shqiptarë, që gjoja paskëshin organizuar e bërë atentat politik ndaj Milladinit. Por unë po vazhdoj të besoj, bazuar në njohuritë modeste historike që kam, se Milladini u sakrifikua për të drejtat e shqiptarëve, prandaj duhet ta nderojmë meritueshëm. Sigurisht, nëse në të ardhmen (kur do të hapën arkivat përkatëse) shkenca e paanshme do të vërtetonte përfundimisht, se vërtetë Milladinin e kanë vrarë patriotë shqiptarë, për qëndrime të tij armiqësore antishqiptare, atëherë unë përulësisht do të kërkoja falje publike.

Tashmë po bëhet zhurmë edhe për Diktatorin Enver Hoxha, nëse ishte ose jo diktator, edhe pse ai vetë e pranonte të ishte udhëheqës i "diktaturës se proletariatit" dhe i sistemit monist komunist (të sanksi-onuar edhe në Kushtetutë). Shumë veta po zhurmojnë nëse ai e kishte shitur ose jo Kosovën (edhe pse nuk e kishte pronë personale dhe nuk ishte pjesë e Shqipërisë londineze), nëse e kishte përkrahur ose jo Kosovën drejtë emancipimit dhe çlirimit, etj. Të neveritin sidomos shkrimet insistuese të disa argatëve të Stanishiqit, të Millosheviqit, dhe "pjellës" se tyre, por edhe të disa demokratëve adoleshentë e të llamarintë, të cilët po kërkojnë e po nxisin diferencime politike "demokratike". Tashmë sikur

po u lexohet taktika për nxitje të urrejtjeve e përçarjeve krahinore e "demokratike", duke marrë shkak nga një akademi politike, e mbajtur në Prishtinë me rastin e 100-vjetorit të lindjes se diktatorit Enver Hoxha, në të cilën morën pjesë rreth 300 "enveristë" nga të gjitha anët e Kosovës dhe nga emigracioni. Këta zhurmaxhinjë "demokratë" nuk po duan t'ua lejojnë lirinë kaq pak "enveristëve" të Kosovës të adhurojnë Enverin e tyre të dikurshëm virtual. Këta zhurmaxhinjë "demokratë", duke shpërdoruar modën e anti-komunizmit (Vaslav Havel: "Më të këqij se komunistët janë antikomunistët."), duan të zezojnë angazhimin e Shqipërisë në përkrahje të Kosovës. Këta zhurmaxhinjë "demokratë" duan njëanshmërisht ta fajësojnë vetëm diktatorin e Enver Hoxha, edhe pse bashkëfajtor për krimet e ndodhura në Shqipëri janë edhe të tjerë, ta zëmë si sekretari partiak Sali Berisha që kapërcente udhëzimet partiake për të terrorizuar studentët dhe profesorët kolegë, duke u imponuar kështu më enverist se sa vet Enveri. Këta zhurmaxhinjë "demokratë", duke banalizuar fushatën e tyre kundër Enverit, duan të zvogëlojnë krimet e hoxhëve, maliqëve, vllasësve, hasanëve, etj., në Kosovë. Këta zhurmaxhinjë "demokratë" duan të provokojnë rebelimin e "enveristëve" në Kosovë për llogari të atyre që po i paguajnë. Këta zhurmaxhinjë "demokratë" duan të falsifikojnë dënimet e shqiptarëve të Kosovës për Republikë të Kosovës, me falsifikime sikur ata na qenkëshin dënuar për enverizëm nga baballarët e tyre titistë. Këta zhurmaxhinjë "demokratë" duan të dënojnë Enver Hoxhën me vlerësime që ia ka bërë atij UDB-ashi Arshi Pipa. Këta zhurmaxhinjë "demokratë" dëshirojnë të përçajnë PDK-në, si dikur LDK-në, për t'i krijuar hapësirë atëherë një milioneri, tani ndonjë argati të Stanishiqit, për t'u fut në skenë politike me parti të tyre private. Gjithëçka duan këta demokratë, por jo koekzistencën paqësore të shqiptarëve në Kosovë. Nga të njëjtin nuk më ka rastisur të lexoj ndonjëherë shkrime kaq të zjarrta dhe kaq të angazhuara për diktaturën moniste komuniste jugo-sllave, të komanduar nga diktatori Tito, dhe as për kolonializmin e Beogradit serbomadh dhe as për viktimat e tyre shqiptare. Unë do sugjeroja që edhe këtë të kaluar historike ta përpunojmë sipas modelit gjerman: Të dënohet

nga shqiptarët politikisht (në fakt e kanë bërë parlamentet) ai sistem "enverist" e "titist", të dënohen individualisht secili për krimet që kanë bërë, qoftë duke zbatuar urdhrat që vinin nga partia moniste në pushtet, qoftë duke shpërdoruar atë sistem (gjithnjë në bazë të ligjeve kur janë kryer krimet – siç vendosi Gjyqi Kushtetues i Gjermanisë kur u vendos t'u bëhet gjyq fukcionerve, oficerëve, spiunëve komunist të Gjermanisë Lindore për shpërdorim e shkelje të ligjeve të kohës të atij Shteti.). Dhe ky përcaktim mbase mund të mbështetet edhe në qëndrimet politike e juridike të Bashkësisë Ndërkombëtar për të dënuar krimet e Serbisë si krime individuale dhe jo si krime kolektive e sistemore.

Tashmë po bombardohemi edhe me lista të UDB-ashëve dhe spiunëve, duke harruar qëllimisht se në Kosovën e ripushtuar edhe ata ishin hallka të të njëjtit sistem pushtues, siç ishin, ta zëmë, mësuesit dhe nëpunësit shqiptarë të atij sistemi.

Më shumë si rezultat i kundërvënies së klanit politik slloveno-kroato-boshnjak (Tito-Kardel-Bakariq), për të përballuar serbizimin total të Jugosllavisë nga klani serbomadh me në krye Aleksandër Rankoviqin, se sa si meritë e angazhimit të "titistëve" shqiptarë me në krye Fadil Hoxhën, ndodhi faktorizimi i Kosovës dhe i shqiptarëve në Jugosllavi pas vitit 1966.

Në kuadër të reformimit të sistemit kushtetues të vitit 1974, Kosova avancoi në njësi hibride federale. Edhe pas këtij viti UDB-ashët shqiptarë të KSA të Kosovës shpesh anatemohen pa të drejtë, më shumë se sa, ta zëmë, mësuesit, nëpunësit dhe kuadrot komunistë shqiptarë, edhe pse edhe të parët edhe të dytët u shërbenin ligjeve që miratonte i njëjti Kuvend (parlament) i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i Republikës Socialiste të Serbisë dhe i Federatës Socialiste Jugosllave. Pra, anatemohet ta zëmë *x* UDB-ashi dhe admirohen deri ne idhuj kuadrot e Lidhjes Komuniste të Kosovës (si ta zëmë sekretari komunist Ibrahim Rugova, shefi komunist Mahmut Bakalli), edhe pse këta kuadro komunistë ishin udhëheqës ideor, politikë e sistemorë të UDB-ashëve ngurrohet të bëhen mbivlerësime, devalvime, falsifikime.

E kur nuk biem dakord për kriteret e vlerësimit të kësaj Kryengritjeje të përjetuar, si do të jemi në gjendje për të vlerësuar rrjedhat e mëhershme historike. Prandaj doemos na plas skandali (më 18.09.2008), kur kryetari i Republikës së Kosovës të dekorojë me titull "heroi" Ahmet Krasniqin, të cilin shteti i Kroacisë e ka shpallur kriminel lufte dhe, sikurse dihet, ai me tërë qenien e tij është përpjekur t'i kundërvihet Kryengritjes çlirimtare të Kosovës, gjegjësisht udhëheqjes se saj – Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Çuditërisht, edhe ndaj këtij skandali që na e "polli" Presidenti po vazhdon të heshtet (me ndonjë përjashtim), e po heshtin edhe konformistët (kryeministri, kryetari i Kuvendit, etj.), të cilët kanë ardhur në pushtet kryesisht në saje të meritave që kanë pasur gjatë kësaj Kryengritjeje.

Sugjerimi im konkret do të ishte që të mos prodhojmë më shumë histori sesa është në gjendje të mbajë Kosova dhe populli ynë, t'u përmbahemi vetëm të vërtetave e fakteve dhe t'i vlerësojmë ato realisht, në kohë e hapësirë; pasi edhe pas kaq shumë dekadave dhe fakteve kokëforta historike po shohim se sa vështirë është të jetësohet pavarësia, gjegjësisht shtetësia; që fajësojmë kuturu pse nuk është realizuar në vitin 1913, në vitin 1919, në vitin 1945 ose në vitet 1974 e 1981.

2.d. Gjallërimi i shoqërisë civile (qytetare) është faktor tjetër me rëndësi për zhvillim të përshpejtuar

Pothuajse në të njëjtin skematizëm të partive mund të fusim edhe shoqërinë civile, gjegjësisht shoqatat e organizatat joqeveritare. Mund që në Republikën e Kosovës kemi të regjistruar qindra organizata joqeveritare (OJQ), por kjo nuk dëshmon se kemi të zhvilluar shoqërinë civile. Ekzistojnë dyshime se shumica e tyre janë formuar prej individësh për të përvetësuar individualisht e pameritueshëm donacione. Nuk më ka rastisur të dëgjoj për veprimtari të ndonjë shoqate, e cila nuk varet nga donacionet, por zhvillon aktivitete vullnetare (voluntariste, pa pagesë).

Kjo e zbulon hilen e tyre, kjo dëshmon se ato nuk janë themeluar për shkak të kulturës qytetare të anëtarëve të saj. Në Perëndim janë me dhjetëra mijëra shoqata, gjegjësisht OJQ, që angazhohen pa kërkuar fare donacione, sepse qytetarët atje duan të angazhohen në kohë të lirë, ta zëmë, për të diskutuar për mbarëvajtjet e mangësitë në lagjet dhe në rrethet ku banojnë, për ndotje të ambientit, për varfërinë dhe ndihmat humanitare, etj.

Edhe qytetarëve po u mungon dukshëm edukata e kultura sociale, pjesë qenësore e shoqërisë demokratike. Për sqarim, po sjell shembuj.

Lexuesit mbase nuk do më besojnë se në Gjermani jam angazhuar bashkë me prindër të fëmijëve tanë që të pastrojmë e të lyejmë klasën e fëmijëve tanë në një gjimnaz të atjeshëm, meqë atë vit gjimnazi nuk kishte buxhet të mjaftueshëm (shtetëror). Shumica e prindërve ishin profesorë, avokatë, biznesmenë, nëpunës të lartë shtetërorë, meqë kryesisht fëmijët e nomenklaturës ia dalin të kualifikohen për gjimnaz. Njëri nga prindërit ishte milioner. Kur po mblidhnim të hollat për të blerë bojën, me të qeshur iu drejtova milionerit: "Përse nuk ke angazhuar një firmë që të ngjyrosë klasën, por na le që të përlyhemi me bojë...!?" Ai më shpjegoi se donte që djali i tij të krenohej me babanë, që ishte angazhuar si gjithë prindërit e tjerë për të pastruar e ngjyrosur klasën.

U turpërova dhe u shqetësova kur parvjet dëgjova rrëfimin e një plake norvegjeze, që ishte për vizitë tek një familje në Kosovë. Një ditë ajo kishte vizituar shkollën në fshat. Sapo kishte hyrë në oborr të shkollës, ishte lemerisur nga papastërtia e oborrit, që ishte i mbuluar me shishe e qese plastike e me mbeturina të tjera. Vetë i kishte mbledhur të gjitha, nën vështrimet tallëse dhe cinike të vendësve. Pastaj kishte lëshuar kujën kur ka vërejtur papastërtinë e nevojtoreve të shkollës. Edhe ato i kishte pastruar vetë. I kishte qortuar nikoqirët, pse në një kohë që i rregullojnë e pastrojnë aq mirë shtëpitë e tyre, nuk angazhohen për të pastruar shkollën e fëmijëve të tyre, të cilët po rrezikoheshin të infektoheshin nga ndonjë epidemi. Me para të veta ka ndërruar dyert e dritaret e thyera të shkollës, ka ndërtuar nevojtore të reja, meqë i ishin dhimbsur rreth

600 fëmijë nxënës të asaj shkolle. Edhe më shumë e kishte revoltuar arsyetimi i nikoqirëve, se shteti duhet të rregullojë e mbajë të pastra shkollat. Kjo u ishte kundërvënë: "Pse duhet t'i rrezikoni fëmijët tuaj duke pritur shtetin e varfër që të plotësojë obligimet e tij?".

Këta shembuj janë shpjegues për nivelin e edukatës e të kulturës së ulët sociale, për të mos thënë edhe prindërore. Shumë veta mund të ndjehen të ofenduar për këtë vlerësim, pikërisht se u mungon kultura demokratike dhe jo pse shqetësohen për nënvlerësim të pamerituar.

Njëherë luta disa banuesve të pallatit ku po jetoja, që të angazhoheshim bashkërisht për të pastruar oborrin e shkallët e pallatit. Më kundërshtuan duke më thënë se, meqë vikam nga Perëndimi, dëshiruakam t'u shes mend. Këso përjetimesh mund të sillja edhe më, por mjafton të shqetësohemi me kaq për kulturën tonë të ulët sociale, qytetare e demokratike. Papastërtitë e oborreve dhe të shkallëve të pallateve po na i shohin përditë të huajt që shkruajnë raporte për Kosovën. Dhe mund të marrim me mend se sa do të ndikohen nga kjo papastërti jona, si njerëz që janë, kur përpilojnë raporte. Këtë gjendje nuk mund ta arsyetojmë me varfërinë materiale, pasi këto janë varfëri të kulturës sociale,.

Nuk kemi kohë e "leverdi" të presim që të na sëmurë papastërtia ose që të na tallë bota. Qeveria duhet të marrë masa kundër shisheve e qeseve të plastikës, ta zëmë duke ua caktuar shitoreve që të kërkojnë nga blerësit 5 cent për çdo qese plastike, ose të detyrohen që të mbajnë vetëm qese letre, nëse duan t'i japin falas. Për çdo shishe plastike e qelqi, për kanaçe të pijeve, të kërkohen nga blerësi 10 cent kaucion (parapagim), të cilat blerësi do t'i marrë përsëri kur do t'i kthejë ato të zbrazëta në shitore. Shumica e shteteve perëndimore kanë miratuar ligje për këtë çështje, prandaj, detyrimisht, për çdo lloj shishe e kanaçe mbahet kaucion, kurse qeset e plastikës pothuajse nuk jepen më pa pagesë. Pastaj banorëve të pallateve duhet t'u vihen gjoba nga drejtoria sanitare komunale, nëse nuk i pastrojnë oborret e shkallët e pallateve, sepse banesat e tyre janë privatizuar dhe nuk u takon komunave që t'ua mirëmbajnë infrastrukturën e tyre përreth, etj. Pra, duhet të merren

vendime të detyrueshme nga institucionet përkatëse komunale, që pronarët e banesave në pallate të krijojnë fonde për mirëmbajtje të infrastrukturës se pallateve të tyre, siç ndodh përgjithësisht në Perëndim. Po kështu edhe ata që marrin ndihma sociale për shkak të papunësisë dhe varfërisë, do të duhej të detyrohen të angazhohen në pastrim të qyteteve, me stimulim simbolik, pos ndihmës sociale, siç janë duke vepruar shumë shtete në Perëndim.

Janë shumë angazhime që u takojnë qytetarëve dhe jo shtetit e institucioneve publike, prandaj qytetarët duhet të ndërgjegjësohen për t'u dalë zot përgjegjësive të tyre për të kontribuar në zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë demokratike. Nëse qytetarët nuk ndërgjegjësohen për përgjegjësitë e tyre qytetare, atëherë shteti demokratik duhet të gjejë mënyrat e përshtatshme për t'i detyruar me angazhime që u përkasin.

Do të ishte interesante dhe me dobi po të bëheshin analiza sa më të gjithanshme e sa më gjithëpërfshirëse, se si ky popull dhe mërgimtarët e tij u angazhuan me përkushtim e sakrifica, vullnetarisht, patriotikisht e qytetarisht, gjatë viteve të '90-ta, për të mbajtur të gjallë gjithë sistemin e arsimit (i cili gabimisht quhej "sistem paralel"), për të organizuar gjithë atë solidaritet humanitar e kombëtar, për të ndihmuar minatorët dhe punëtorët që shteti serb i nxori nga puna, për të mbajtur skamnorët. Do të ishte interesante dhe me dobi po të bëheshin analiza sa më të gjithanshme e sa më gjithëpërfshirëse, se si një e ashtuquajtur OJQ, gjegjësisht shoqatë humanitare, e quajtur me emrin sublim "NËNA TEREZË", kishte gjithë atë vullnet humanitar për të mbledhur e shpërndarë gjithë ato ndihma, edhe pse përndiqej nga regjimi pushtues serb. Do të ishte interesante dhe me dobi po të bëheshin analiza sa më të gjithanshme e sa më gjithëpërfshirëse, për vullnetin e madh të mërgimtarëve që t'i jepnin gjithë ato ndihma financiare në Fondin e Republikës së Kosovës, bile edhe si "tatim" prej 3 për qind nga të ardhurat, e që për pjesën më të madhe të këtyre mjeteve, fatkeqësisht, nuk dihet se si e ku janë shpenzuar ose se si janë tjetërsuar nga individë të papërgjegjshëm të njëfarë "qeverie në ekzil". Do të ishte interesante dhe me dobi po të bëheshin analiza sa më të gjithanshme e sa më

gjithëpërfshirëse, për vullnetin e madh të mërgimtarëve për të dhënë gjithë ato ndihma financiare për Fondin "Vendlindja thërret", fond ky i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mbase do të duhej kritikuar hezitimi i strukturave kompetente për të paraqitur një raport publik se sa mjete u grumbulluan, ku e si janë shpenzuar ato (edhe pse ai fond kishte karakter ushtarak). Ndoshta këtu do mjaftonte një shpjegim i përmbledhur, se atëherë shqiptarët kishin një vullnet e synim madhor kolektiv: Çlirimin e Kosovës nga pushtimi i egër serb. Por, gjithashtu, duhet të bëheshin analiza sa më të gjithanshme e sa më gjithëpërfshirëse, se përse i njëjti popull pas Luftës, ra përtokë, nuk po angazhohej vullnetarisht as për të ndihmuar njëri-tjetrin në pastrim të gërmadhave të qindra mijë shtëpive të djegura nga barbarët pushtues serbë, bile po angazhoheshin shumë pak për të ndihmuar me arkivole e tabute familjet që po rivarrosnin mijëra familjarë të tyre të viktimizuar. Mbase periudha e Luftës ia shterroi të gjitha energjitë kolektive popullit tonë për t'u angazhuar në ndërtimin e shtetit dhe, prandaj, këtë duhet ta kenë ndëshkuar miqtë ndërkombëtarë me vonimin e dhënies se pëlqimit për të shpallur Republikën e Kosovës si shtet të pavarur e sovran. Filozofia popullore na mëson se më vështirë është ta mbash se ta fitosh lirinë. Se mos ndodhi që populli nuk pati më motiv e synim pasues, pasi u dalldis nga ajo fitore e madhe - Çlirimi i Kosovës nga pushtimi i egër serb. Gjithsesi, tani duhet t'i mishërohet popullit motivi e synimi kurcial për shtet-bërje, shtet-ndërtim e zhvillim ekonomik e demokratik të Republikës së Kosovës. Dhe këtë motiv e synim sigurisht që nuk do të mund t'ia mishërojnë ata që uzurpojnë pushtetin për ta shpërdoruar atë për të blerë e ndërtuar vila gjigante, për të blerë edhe makina të blinduara, meqë kështu duan të imponohen si më të rrezikuar nga të tjerët, për të blerë *jeep*-a e automobila luksoz, për të shpenzuar për të dashura e për ushqime në restorantet më luksoze, për të vënë shpërdorueshëm kapital për "shtatë brezat" pasardhës.

Nuk duhet të ketë gjendje pa zgjidhje, prandaj është e domosdoshme këndellja morale e sociale e popullit për t'i dalë zot vetes dhe shtetit të tij.

3. ZHVILLIMI EKONOMIK

Faktor me rëndësi për shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin, për zhvillimin shoqëror e demokratik, është zhvillimi i përshpejtuar ekonomik i Republikës së Kosovës dhe shoqërisë sonë.

Niveli i zhvillimit ekonomik i shtetit tonë tani lë shumë për të dëshiruar.

Zhvillimi ekonomik i një vendi varet nga shumë faktorë, të brendshëm dhe të jashtëm, por gjithsesi faktor me më rëndësi është vetë njeriu si qenie shoqërore, vullneti, shkathtësia dhe angazhimi i tij.

Në kohë e rrethana të ndryshme Kosova ka përjetuar zhvillim ekonomik, të themi zvarranik, për shkak se është kushtëzuar nga rrethanat pushtuese. Hovin e përshpejtuar dhe autentik të zhvillimit ekonomik e shoqëror Kosova e ka përjetuar në vitet ’70-ta të shekullit të kaluar, pas reformave të mëdha kushtetuese të ish-Jugosllavisë në vitin 1974. Në atë kohë ndodhi një hovëzim i zhvillimit ekonomik, pasi klasa e atëhershme politike, në kuadër të kompetencave që përmbante Kushtetuta e KSA të Kosovës, orientoi zhvillimin ekonomik edhe në përpunim të pjesshëm të resurseve nëntokësore (xeheve) dhe jo vetëm në nxjerrjen dhe eksportimin e tyre. Kështu, gjigantët “Trepça”, termo-elektro-centralet, ferronikeli, çimentorja në Han të Elezit, firma të mëdha, me dhjetëra mijë të punësuar, jepnin përfitime të mëdha, nga të cilat një pjesë i mbetej Kosovës për të zhvilluar infrastrukturën e saj. Këtë e shoqëroi edhe zhvillimi i përshpejtuar i arsimit, për të arritur nivelin kulmor që KSA e Kosovës të kishte rreth 32 mijë studentë në vitin 1981. Krahas këtyre zhvillimeve u formuan e ngritën edhe një mori fabrikash përpunuese, që punësuan dhjetëra mijëra punëtorë, siç ishin fabrika e amortizerëve në Prishtinë, fabrika e autopjesëve në Pejë, fabrika “Ballkan” në Therandë (Suharekë), ajo e gypave në Ferizaj, e elektromotorëve në Gjakovë, e akumulatorëve në Pejë, e “Progresit”

në Prizren, e llamarinës në Vushtrri etj. Falë këtyre kapaciteteve KSA e Kosovës arriti edhe të eksportojë prodhime industriale dhe energji elektrike.

Krahas zhvillimit industrial edhe bujqësia, më pak blegtoria, përjetuan zhvillim të hovëzuar. KSA të Kosovës jo vetëm që i mjaftonin prodhimet bujqësore, por ajo eksportonte në njësitë e tjera të ish-Jugosllavisë. Në të gjitha tregjet e republikave të ish-RSFJ-së, prodhimet bujqësore të Kosovës kishin hapësirë e treg të qëndrueshëm, sepse gëzonin namin e prodhimeve cilësore, edhe pse Kosova ishte krahina më e varfër dhe më e pazhvilluar në ish Jugosllavinë, kishte një diskrepancë të theksuar midis të ardhurave në Kosovë dhe në Slloveni dhe në republika të tjera.

Gjithë atë zhvillim ekonomik, goxha solid për kohën dhe rrethanat, e shkatërroi invadimi i Serbisë në Kosovë, në vitin 1989, duke ia grabitur fillimisht të drejtat kushtetuese, pastaj duke shfuqizuar politikisht e juridikisht edhe klasën vasale politike të KSA të Kosovës (1981-1989) dhe duke përzënë nga puna qindra mijë shqiptarë të punësuar. Gjatë viteve 1990-1998 Serbia pushtuese ushtroi një shfrytëzim e zhvillim kolonial klasik në Kosovë.

Çlirimi nga pushtimi serb Kosovën e gjeti të shkatërruar në shumë plane, sidomos në atë ekonomik e social. Populli, në fazën fillestare, ishte i preokupuar me kthimin sa më të shpejtë në trojet e veta, për rivarrosjen e viktimave dhe ndërtimin e shtëpive të djegura. Në këto rrethana nuk kishte si përqendrohej vëmendja kolektive në zhvillimin ekonomik. Kolektivat e fabrikave të viteve të ’90-ta ishin shkapërderdhur gjatë gati dhjetë vjetëve dhe ato pothuajse kishin harruar se si i kishin menaxhuar fabrikat e tyre. Mjetet financiare dhe energjitë që i kishte populli para Luftës i investoi kryesisht në ndërtimin e shtëpive. Vullneti i madh i kthimit të refugjatëve të Luftës dhe vullnet i madh i popullit për të rifilluar jetën, duke rindërtuar shtëpitë, po habisnin botën. Por popullit po i mungonin mjetet e punës, sidomos ato bujqësore, sepse ato i kishte shkatërruar “e tretur” Lufta, që t’i ktheheshin me po me atë vullnet punës në bujqësi, siç u angazhuan për rindërtim të shtëpive.

Edhe një pjesë e mjeteve financiare, të kursyera nga emigrantët, po shpenzoheshin në rindërtim të shtëpive dhe në ndërtim të shtëpive të reja, por, pakuptimshëm, po shpenzoheshin edhe për blerje të automobilave. Paralelisht mjetet financiare të emigrantëve po shpenzoheshin për të blerë kamionë, vinça, gurthyes, etj., por edhe ky lloj investimi ishte si një stihi dhe ngjante me një garë anarkike. Asgjëkund nuk po dukeshin vetorganizime kolektive për të përllogaritur nevojat e Kosovës për të tilla mjete, askund nuk dukeshin organizime që do jepnin këshilla se në ç'fusha do të duhej të bëheshin investimet e para.

Në rrethanat e para të pas Luftës zuri të zhvillohej sidomos tregtia e mallrave ndërtimorë e ushqimorë, të importuara kryesisht nga Serbia dhe Maqedonia. Paralelisht zuri fill kontrabandimi me mallra që sjellin përfitime të mëdha, siç ishin nafta, duhani, sheqeri, mielli, kafeja, ilaçet, etj. Por përfitimet nga të gjitha importet shkonin kryesisht jashtë Kosovës. Kështu, po harxhoheshin kryesisht financat e emigracionit, që ua dërgonin familjeve për të rifilluar jetën në Kosovë.

Bashkësia ndërkombëtare, që tashmë menaxhimin e Kosovës po ia kalonte OKB-së, po vonohej të konsolidohej dhe mbase po vonohej, duke vështruar e vëzhguar nëse populli i Kosovës po bëhej në gjendje për të menaxhuar veten, gjegjësisht Kosovën. Meqë klasa politike e Kosovës nuk po bëhej në gjendje për të menaxhuar Kosovën, atëherë bashkësia ndërkombëtare formoi e konsolidoi UNMIK-un si strukturë menaxhuese të Kosovës. Ajo i ndaloi veprimtarinë qeverisë së përkohshme dhe zuri të improvizojë struktura të reja, që do të çonin drejt formimit të qeverisë së re, e cila do të dilte nga zgjedhjet e përgjithshme që do të organizonte UNMIK-u. Por qysh në fillim po hetohej se as UNMIK-u nuk donte, ose nuk mund të ishte në gjendje të menaxhonte me sukses tashmë proktetoratin e tij - Kosovën. Së pari nuk deshi, apo nuk mundi, të përcaktojë statusin e pronësisë të të ashtuquajturës pronë shtetërore dhe pronë shoqërore, që ndërkohë quhej pronë publike. Ndodhte kështu sepse në Këshillin e Sigurimit Serbia kishte ndikim të madh, kryesisht përmes Rusisë, e cila pretendonte se e gjithë prona shtetërore e shoqërore në Kosovë ishte pronësi e Serbisë. Megjithatë UNMIK-u

vendosi të nisë privatizimin në Kosovë, me orientim që mjetet që do të dilnin nga privatizimi "do të ngriheshin", për t'i definuar me vonë nëse do t'i jepeshin Serbisë apo Kosovës. Kurse vetëm 20 për qind e atyre mjeteve do t'u jepeshin të punësuarve në fabrika, kooperativa, etj.

Parashikohej që privatizimi t'i jepte impuls të ri zhvillimit ekonomik, por ai, i bërë në mënyrë tepër vulgare, korruptuese e manipuluese, nuk i realizoi parashikimet, pasi pjesa më e madhe e fabrikave dhe e kooperativave të privatizuara nuk ia dolën të riaktivizonin veprimtarinë e tyre ekonomike. Kjo ndodhte për shkak të garave të pandershme e korruptive, pasi qëllimi kryesor ishte çmimi sa më i lartë i shitjes dhe jo konceptet për menaxhim e për riaktivizim të tyre që të fillojnë me veprimtari ekonomike. Blerësit e tyre, që në të shumtën e rasteve nuk kishin koncepte zhvillimore ekonomike dhe prejardhjen e mjeteve blerëse i kishin të dyshimta, dukej se i blinin ato kryesisht për qëllime spekulative. Edhe ata që kishin qëllim të mirë, i harxhonin mjetet në blerje, dhe, edhe po të donin, nuk u tepronin mjete për t'i futur ato në prodhimtari. Kjo mund të provohet në terren. Edhe më i vrazhdë ishte privatizimi i tokave të kooperativave, të cilat pastaj mbesnin djerrë dhe copëtoheshin për t'iu shitur spekulantëve e bujqve të interesuar.

Me kalimin e kohës, vetë UNMIK-u në njërën anë, dhe qeveritë e Kosovës, qeveritë komunale si dhe strukturat e tjera shtetërore e publike, në anën tjetër, që kishin kompetenca të kufizuara dhe që i mbikëqyrte UNMIK-u, nuk hartuan projekte e ligje për të nxitur investimin në prodhimtari dhe në bujqësi e blegtori. Mungesa e ligjeve shkaktoi anarki në segmentet që po i shohin dhe që po i irritojnë qytetarët, siç janë pompat e benzinës, ambulancat, barnatoret private, në urbanistikë, në energjetikë, në gastronomi, etj. Ta zëmë, ekonomia e lirë e tregut u keqkuptua dhe u shpërdorua në dhënie të licencave korruptive, duke prodhuar kështu konkurrencë të pandershme e anarkike dhe duke ua rrezikuar mjetet e investuara investitorëve paraprakë dhe investitorëve të rinj. Në asnjë rast nuk kishte plan se sa pompa benzine do i mjaftonin Kosovës në mënyrë që të mos jepeshin licenca vetëm për hir të plaçkës që do merrte "shefi" përkatës për dhënie të licencës. Në asnjë rast nuk

kishte plan se sa ambulanca e barnatore do u duheshin qytetarëve, por jepeshin licenca vend e pa vend, siç praktikohet të thuhet, vetëm për të marrë haraç "shefat" që i lëshonin licencat për to. Në asnjë rast nuk u hartuan e miratuan plane urbanistike të qyteteve, që të dihet se ku mund dhe ku jo, të bëhen ndërtime të reja, pasi anarkia në këtë fushë u interesonte "shefave" në komuna që të merrnin haraç për dhënien e lejeve ose për tolerim të ndërtimit ilegal, që pastaj të "legalizoheshin". Kështu po harxhoheshin dhe po rrezikoheshin mjetet financiare, të cilat, po të investoheshin më arsyeshëm në prodhimtari, do rigjeneronin zgjerim të prodhimtarisë. Struktura "shtetërore" po shtireshin si të paafta për të ndaluar importimin dhe kontrabandimin ilegal të naftës, cigareve, barnave (ilaçeve) dhe mallrave të tjera që sillnin përfitime të mëdha. Madje ato struktura prodhonin çakërdisje edhe në sektorin e sigurimit pensional "shtetëror" dhe në sektor të sigurimeve private. Në asnjë shtet të zhvilluar e demokratik të botës nuk ndodh që shteti t'ua marrë përdhunshëm sigurimin pensional të punësuarve dhe ato mjete të (keq)menaxhohen pastaj privatisht, nga një grupim individësh, siç ndodhi me Trustin e Kursimeve Pensionale.

3.a. Energjia elektrike duhet të jetë orientim parësor për zhvillim të përshpejtuar ekonomik

Po nisem nga premisa se kemi shtet dhe se këtë shtet e drejton qeveria që doli nga zgjedhjet e fundit; po nisem nga premisa se kësaj qeverie UNMIK-u do ia kalojë shpejt pjesën më të madhe të kompetencave që i takojnë; po nisem nga premisa se kjo qeveri është e predispozuar për të menaxhuar Republikën e Kosovës drejt një zhvillimi të përshpejtuar ekonomik. Pra, nuk dua ta paragjykoj, siç janë të prirur rëndom shumë të pakënaqur; po dua të nisem nga premisa e dëshiruar, se edhe populli ynë është i predispozuar që t'i qaset me të gjitha energjitë zhvillimit të përshpejtuar ekonomik e shoqëror, si faktor kryesor për shtet-bërje,

shtet-ndërtim e zhvillim demokratik të shoqërisë, për të paraqitur disa propozime konkrete për zhvillim të përshpejtuar ekonomik.

Urgjenca e të gjitha urgjencave është energjia elektrike, meqë pa rrymë elektrike nuk mund të pish as edhe një kafe *expresso*; pa shkuar më tej, që, bie fjala, nuk ke se si të shkruash e publikosh qoftë edhe një tekst të vogël.

Fatmirësisht, ose fatkeqësisht, varësisht nga këndvështrimi, Kosovës i ka takuar të ketë rezerva të mëdha të thëngjillit. E thashë fatkeqësisht, sepse këto rezerva të mëdha të qymyrit janë një nga faktorët kryesorë përse Serbia e do Kosovën që ta ketë pjesë të saj, para Patriarkanës së Pejës, kishës së Deçanit ose manastirit të Graçanicës. Bile këtë pasuri të madhe pothuajse e kemi shndërruar në mit.

Vërtet, është e pakuptimtë që kemi gjithë këtë pasuri thëngjilli dhe mbetemi në terr.

Tani nuk kemi nevojë të filozofojmë për këtë pasuri e as të vazhdojmë me mitizim të saj, por ta shfrytëzojmë që të dalim nga kolapsi i tanishëm energjetik dhe t'i japin një shtytje zhvillimit të përshpejtuar ekonomik e shoqëror. Përcaktimi fillestar më i keqi, për momentin, do të ishte nëse ne orientohemi që privatët të ndërtojnë TEC-e (termoelekrana) gjigante, siç është planifikuar TEC-i "C" (i riemërtuar se fundi "Kosova e re", vetëm për inat të pararëndësve). Në këtë rast Kosova do të ketë përfitime të vogla nga këto TEC-e, sepse, privatët, do të investojnë kapitale të mëdha vetëm nëse ne u krijojmë, pos sigurisë, edhe privilegje të mëdha, që të shfrytëzojnë në maksimum këtë pasuri dhe ambientin tonë ekologjik. Zallamahia e krijuar, se vetëm investimi privat mund t'i bëjë hajër këtij vendi dhe mund të na nxjerrë nga kriza e tanishme, duhet të marrë fund, pasi ka prova të bollshme se edhe investimi shtetëror mund t'i sjellë shtetit fitime të mëdha, që do jenë në të mirë të gjithë popullit. Kurse investitori privat, sigurisht i jashtëm, pasi të brendshëm sikur nuk kemi, përfitimin e madh që do të nxjerrë nga investimi në energjetikë, do e nxjerrë jashtë Kosove, nuk do e riinvestojë në Kosovë. Shembullin më të keq për këtë e kemi "Ferronikelin", ku shfrytëzohet si mall pa zot

xehja jonë, ku njerëzit tanë shfrytëzohen tamam si skllevër dhe përfitimet kolosale pronari i nxjerr jashtë Kosove. Shumë do më interesonte të dija se çfarë përfitimesh të tjera ka Kosova nga "Ferronikeli", pos atyre rrogave skllavëruese që marrin të punësuarit fatkëqinj aty, por për këtë ndoshta do na informojnë objektivisht kompetentët.

Mundësia e parë konkrete dhe më fatlume e fitimprurëse për të ndërtuar TEC me kapacitet prej rreth 600-700 MW është investimi që do bënte Trustit i Pensioneve. Ky fond duhet t'u kthehet atyre që paguajnë në të dhe menaxhimin e tij duhet ta bëjnë këshillat që do zgjedhin kontribuuesit ose, deri kur të mund të ndodhë kjo, menaxhimin e tij duhet ta bëjnë këshillat, që do i zgjedhë komisioni parlamentar për pensione dhe qeveria.

Në Gjermani, ku u detyrova të specializohem për sigurime pensionale private, as kontributet që paguhen në sigurime pensionale private nuk mund të dilnin jashtë shtetit, pasi shteti i garanton kontribuuesit. Për ata që nuk e dinë, mjetet e fondit të Trustit të Pensioneve, u janë dhënë hua firmave të jashtme me kamatë qesharake (rreth 1,8 për qind), që nuk mbulojnë as inflacionin e tyre, ose janë investuar në aksione të shpifura në bursa Perëndimore. Ka ndodhur kështu në kohën kur bankat e huaja në Kosovë kërkojnë kamatë rreth 15 për qind për kreditë që japin në Kosovë dhe Kosovës i duhen shumë mjete investive në prodhimtari e shërbime. Në Gjermani shteti menaxhon fondin e pensionit shtetëror dhe huazon pothuajse të gjitha mjetet nga sigurimet pensionale private (që janë nga kontributet private për pensione private). Sikur Trusti i Pensioneve t'i investonte mjetet në TEC, rritja e këtij fondi do të ishte rreth 30 për qind në vit. Nga kjo do të përfitonin të gjithë kontribuesit, pasi pensionet do t'i merrnin shumë më të larta se sa me (keq)menaxhimin që po i bëhet tani këtij fondi. Qysh kur ishte z. Bajram Kosumi kryeministër, i pata shkruar një letër nga Gjermania lidhur me mjetet e Trustit të Pensioneve. Shansin e fitimit të madh personal e kisha sikur ato mjete t'i jepeshin hua korporatës më të madhe botërore të sigurimeve, ku isha i angazhuar, me kamatë shumë më të lartë se sa ishin depozituar gjetiu, por unë i propozova Kryeministrit Kosumi që Trusti të formojë bankë të vetën

dhe të jepte kredi zhvillimi në Kosovë, me kamatë ta zëmë vetëm 5 për qind, duke dalë kështu më i fituar se sa me depozitim jashtë Kosove, me kamatë prej rreth 1,8 për qind. Një bankë që mund ta formonte Trusti do u bënte konkurrencë bankave të huaja në Kosovë dhe do i detyronte ato që të ulnin kamatën për kreditë që po jepnin. Unë parapëlqeva interesin e Trustit, gjegjësisht të Kosovës, para interesit personal, sepse po të vendoste Trusti t'ia huazonte firmës ku punoja unë me kamatë shumë më të lartë se deri atëherë, unë kisha fitim një honorar prej 0,5 për qind. Por kryeministri Kosumi nuk denjoi të më kthente as një përgjigje të thjeshtë me shkrim dhe as të më thërriste në bisedime, pasi në Kosovë mbretëronte një praktikë idiotësie, që kryeministri dhe ministrat të mos u kthejnë përgjigje qytetarëve kur u shkruajnë. E sa për provë, çdo qytetar i Kosovës, jo emigrant, por edhe me banim në Kosovë, mund t'i shkruajë letër (elektronike) kanzelar-es (kryeministres) ose presidentit të Gjermanisë dhe e siguroj se do marrë përgjigje të menjëhershme (elektronike) dhe të mëpastajme me postë, posa të jetë hartuar përgjigjja konkrete.

Varianti i dytë do të ishte që shteti t'i huazojë këto mjete të fondit (Trustit) "shtetëror" të pensioneve me kamatë vjetore prej rreth 5 për qind , që do të ishte dyfishi i kamatës që përfiton tani ky fond, dhe të ndërtonte shpejt e shpejt një TEC me kapacitet 600-700 MW.

Për të ndërtuar një TEC të këtij kapaciteti do të duheshin rreth 800 mijë euro për MW, gjegjësisht rreth 500 milionë euro. Një kësi TEC-i mund të ndërtohet brenda dy vitesh. Kjo do të zgjidhte kolapsin e tanishëm energjetik. Kusht paraprak është që të sigurohet lidhja me rrjetin ndërkombëtar, ta zëmë përmes Maqedonisë, Shqipërisë, etj., duke mënjanuar lidhjen e tanishme vetëm përmes Serbisë, përderisa nuk arrihet marrëveshja ndërshtetërore se kjo lidhje nuk do të shpërdorohet, siç po ndodh tani, sa herë që t'i teket Serbisë që të pengojë prodhimin e rrymës nga TEC-et aktuale të KEK-ut.

Ja, pra, një zgjidhje e shpejtë, praktike dhe me përfitime për Trustin, për buxhetin e shtetit dhe për qytetarët. Vetëm qorrat e horrat nuk do

e pëlqenin këtë zgjidhje të shpejt e me përfitime. Vetëm shpërdoruesit e Trustit e qeveritarë mjeranë do të pengonin një kësi menaxhimi me interes të shumanshëm, duke u arsyetuar me mungesë të kompetencave, ligjeve ose me "këshillat" e "ndërkombëtarëve".

Në planifikimin afatmesëm shteti do të duhej të ndërtonte TEC-e me kapacitet prej 10.000 MWh ose 10 TWh (teravat). Për këtë orientim e vendim madhor do duhej ndoshta të mbahej referendum. Po të vendoset e të realizohet ndërtimi i TEC-eve me kapacitet prej 10 TWh, atëherë secilit qytetar do të mund t'i falej 1 MW në vit, që do të ishin rreth 2 milionë MW në vit, që do të thotë rreth 200 orë ose 8,3 ditë të prodhimit në vit. Po kështu për të nxitur zhvillimin e përshpejtuar ekonomik do të mund t'u faleshin firmave nga dy MW në vit për çdo të punësuar, që do të thotë për rreth 500 mijë të punësuar do të dhuroheshin 1 milion MW, ose rreth 50 orë të prodhimit të TEC-eve me kapacitet prej 10 TWh. Edhe po t'u dhuroheshin qytetarëve dhe firmave rreth 500 MWh, Kosova do të shiste energji në Kosovë e do të eksportonte 9.500 mijë MW në orë, që do të thotë afër 500 mijë euro në orë (nëse çmimi i shitjes do të ishte vetëm 50 euro për MW, edhe pse tani Kosova po blen rrymë me çmim prej rreth 100 euro për MW). Në ditë Kosova do shiste rreth 230 mijë MW dhe do fitonte rreth 11,5 milionë euro ose rreth 4 miliardë euro në vit. Kjo do t'i mundësonte Kosovës të bëhej shteti më i zhvilluar në rajon.

Për ata që kanë shqetësime për ekologjinë dhe për brezat e ardhshëm, të cilëve ne do ua harxhuakemi kështu rezervat e qymyrit, do të thosha se shqetësohen për mungesë të informimit. Aktualisht Gjermania ka TEC-e të qymyrit me kapacitet prej mbi 55.000 MWh (në vitin 2005 kishte 46.642 MWh). Ndërsa sa i përket shpenzimit të qymyrit, për 30 vite, TEC-et me kapacitet prej 10.000 MWh do të mund të harxhonim vetëm 3 për qind të rezervave tona. Dhe pas 30 viteve, Kosova e zhvilluar, mbase nuk do prodhonte më rrymë nga qymyri, sepse niveli i zhvillimit ekonomik e shoqëror do të rritej deri në atë nivel sa të gjendeshin fusha të tjera për sigurimin e të ardhurave.

Në vazhdim po sjell një tabelë të vitit 2005 lidhur me prodhimin e energjisë elektrike në Gjermani dhe llojet e elektranave (sipas Entit Federativ të Statistikave të Gjermanisë):

Kapaciteti i elektranave në Gjermani në vitin 2005:

Lloji i elektranës	Kapaciteti në MWh	Përqindja
TEC-e me qymyr guri	**26.661**	**21,875 %**
TEC-e me qymyr të murrmë	**19.981**	**16,394 %**
TEC-e me gaz	20.235	16,602 %
Elektranat bërthamore	21.346	17,514 %
Elektranat me erë	18.428	15,120 %
Hidrocentrale	8.763	7,189 %
Elektranat me lëndë të tjera	6.464	5,303 %
Gjithsej:	**121.878**	**100 %**

Po rikthehem edhe një herë te leverdia. Kostoja e ndërtimit të TEC-it modern në Gjermani është rreth 800 mijë euro për MW, por për shkak se do të ndërtohet në Kosovë dhe për lehtësi llogaritjeje po e rrumbullakoj në 1 milion euro për MW (edhe pse do kushtonte vërtet më lirë, pasi pjesët e ndërtimit joteknik do t'i bënin firmat e vendit). Duke u bazuar në këtë kosto të investimit, rezulton se kostoja për 1 MW është vetëm rreth 4 euro. Pra, duhet të kemi parasysh investimin në TEC prej rreth 1 milion euro për 1 MW dhe kohën e amortizimit përfundimtar 30 vjet (24 MW në ditë *x* 365 ditë *x* 30 vjet, baras me 262.800 MW). Sigurisht që kësaj kostoje duhet t'i shtohet pastaj kostoja e qymyrit dhe kostoja e punës dhe e mirëmbajtjes. Mbase kostoja e përgjithshme do të jetë diku rreth 11 euro për MW. Në një debat televiziv në Gjermani, nga një profesor vendës dëgjova para ca ditëve se kostoja e prodhimit të 1 MW rrymë në Gjermani ishte rreth 12 euro.

Nëse këto të dhëna janë të përafërta, atëherë duhet të ishim fare të pamend nëse do prireshim që të investonin vetëm të huajt e jo vetë shteti ynë. Për ndërtimin e TEC-eve me kapacitet edhe deri në 10.000 MW

shtetit tonë do të jenë të gatshëm t'i japin kredi institucione të mëdha financiare dhe unë e kam testuar këtë gatishmëri, bile kredi afatgjatë deri në 30 vjet dhe me kamatë rreth 4 për qind në vit. Tek e fundit, nëse Norvegjia nuk po i privatizon burimet e naftës, rafineritë përpunuese dhe rrjetin tregtues, por i ka në pronësi dhe po i menaxhon shteti, përse Kosova duhet të privatizojë ose të japë me koncesion qymyrin, që është pronë e të gjithë qytetarëve, gjegjësisht e shtetit të qytetarëve!

Për ata që nuk kanë ide dhe guxim dhe arsyetohen se nuk kemi kuadro profesionalisht të formuar për të udhëhequr punën teknike e menaxhuese, ekzistojnë përgjigje. Firmat që do ofrohen për të ndërtuar TEC-et ofrojnë edhe staf inxhinierie deri sa të aftësohet stafi ynë. Dhe stafin tonë të inxhinierisë mund ta përgatisim gjatë ndërtimit të TEC-eve, kështu që kur ato të lëshohen në prodhim, stafi ynë teknik do të jetë i përgatitur. Këtë mund ta bëjmë duke hapur fakultet përkatës dhe duke sjellë nga jashtë rreth 20 profesorë të afirmuar përkatës për të ligjëruar pesë vite, me rrogën që do na kërkonin ata. Paralelisht do të hapnim edhe shkolla të mesme për kualifikimin e një pjese të kuadrit të mesëm teknik që do të punësohen në këto TEC-e.

Në këto TEC-e me kapacitet prej 10 TWh do të punësoheshin të paktën rreth 30 mijë veta. Po ta llogarisnim rrogën mesatare të një punonjësi rreth 1.000 euro në muaj, na del se do shpenzoheshin rreth 360 milionë euro paga në vit. Prej këtyre, një pjesë do hynin në fondin e pensioneve, në fondin e sigurimeve shëndetësore, në buxhet të shtetit si tatim në paga. E shpresoj se sigurimi pensional, shëndetësor, i papunësisë dhe tatimi në paga bruto, së bashku, nuk do të duhej të kalonin 20 për qind të bruto-pagës (në Gjermani është shumë më i lartë). Pasi të paguheshin të gjitha sigurimet dhe tatimi, do mbetej që rroga mesatare e të punësuarve të ishte rreth 850 euro neto në muaj.

Gjatë ndërtimit të TEC-eve do angazhoheshin qindra firma vendëse, me mijëra punëtorë, që do kryenin punë ndërtimore, para se të vinin instalimet teknike (turbinat, gjeneratorët, etj.) dhe kështu do fillonte menjëherë gjallërimi voluminoz i punësimit, gjegjësisht i ekonomisë.

Për ata që e kanë të vështirë të kuptojnë e besojnë se kjo është e mundshme, po parashikoj se për të ndërtuar TEC-e prej 10.000 MWh do të duhej një kredi prej rreth 12 miliardë eurosh (edhe për infrastrukturë, për nxjerrje e transport të qymyrit, për kualifikim të stafit profesional dhe të tjera). Kur të paguajmë kredinë dhe kamatën, kur të paguajmë të gjitha shpenzimet e tjera në paga etj., do na dalin të paktën 3-4 miliardë euro **fitim neto** në vit. Argumentit se do të na ndotet ambienti po bëhem paksa arrogant për t'iu kundërvënë: Po besoj se nuk i kemi hundët më të holla se gjermanët dhe as mushkëritë më delikate, pasi mbi 20.000 MWh prodhohen nga TEC-et e qymyrit vetëm në krahinën industriale të Rajnës dhe Rurit, madhësi kjo e përafërt me Kosovën. Kurse për ata që kanë merakun e brezave të ardhshëm, besoj pas 30 vjetëve do të shohim se si do t'ia bëjmë, meqë ky brez do konsumonte vetëm rreth 3 % të rezerva që ka aktualisht Kosova.

Në përmbyllje të këtyre propozimeve konkrete e të këtij rasti të madh, shtrohet pyetja hamletiane: do të vendosim që të kemi nga 1.500 euro të ardhura për çdo banor në vit vetëm nga rryma, apo duam të presim pa dinjitet që të na mbajë bota (e cila edhe mund të lodhet dikur) me donacione e ndihma humanitare, për shkak se dëshirojmë ajër të pastër dhe të ruajmë qymyrin për rreth 30 brezat që do vijnë pas nesh? Them se është e moralshme që brezi i tanishëm të mund të harxhojë hisen e vet prej 3 për qind. Siguroj se të gjitha TEC-et me kapacitet prej 10.000 MWh, me nivel të tanishëm teknik të modernizimit, do të prodhojnë më pak pluhur e CO^2, se sa janë duke prodhuar TEC-et e tanishme të konsumuara teknikisht (të cilët atëherë do t'i nxjerrim nga prodhimi).

Pos rrymës këto TEC-e do lironin energji aq të madhe termike, sa do të mjaftonin të ngrohnim pjesën më të madhe të qyteteve të Kosovës dhe do të tepronte bollshëm edhe për sera. Kjo do të bënte që të kursehej mazuti, gazi dhe druri djegës. Edhe ky burim do të sillte përfitime. Edhe hiri tashmë është mall dhe para disa kohe jam pyetur nga një firmë e huaj nëse shteti do të pranonte të shiste hirin e tanishëm të TEC-eve, meqë qenka me vlerë për ndërtim rrugësh dhe si lëndë e parë për material ndërtimor.

Sa i përket hidro-energjisë, Kosova ka pak ujë rrjedhës dhe nuk besoj se do të mund të arrihej kapaciteti maksimal prej rreth 150 MWh edhe sikur t'i shfrytëzonim maksimalisht kapacitetet ujore të lumenjve tanë. Por rezervuarët e hidrocentraleve (liqenet) do ishin me shumë vlerë për të akumuluar ujin për ujitje, për TEC-e dhe për pije, pos që do të shfrytëzoheshin për përfitim rryme. Për Dukagjinin pjellor një hidrocentral / rezervuar në Grykën e Rugovës do kishte vlerë të shumanshme: për rrymë, për ujitje, për TEC-e, që do të ndërtoheshin pranë basenit të qymyrit në mes të Klinës e Gurakocit. Pastaj ai liqen do ia shtonte bukuritë natyrore Rugovës dhe kështu do nxitej turizmi malor. Një digë e betonit në ngushticën e Grykës në kilometrin e 7-të do të sillte përfitime të shumëfishta po të kishim parasysh se sa do të kushtonte diga dhe hidrocentrali prej rreth 50 MWh.

Sa i përket përfitimit të energjisë nga era dhe nga dielli, Kosova tani për tani nuk është në gjendje të investojë, sepse kostoja për një kilovat është shumë herë më e lartë se sa në TEC-et me qymyr. Nëse 1 KW nga TEC-i e ka koston e prodhimit rreth 1,5 cent, 1 KW nga era ose nga energjia solare e ka rreth 20 gjegjësisht 25 cent (që do të thotë gati 20 fish më shtrenjtë). Në Bashkësinë Evropiane ndodhin shumë investime në këtë energji alternative e ekologjike, por me subvencionime nga Brukseli dhe nga shtetet përkatëse. Por edhe Brukseli tani po i orienton politikat energjetike kryesisht drejt TEC-eve me qymyr. Nëse në vitin 2000 në BE prodhoheshin 2.898 TWh (2.898.000 MWh), deri në vitin 2020 planifikohet që prodhimi të rriten në 3.988 TW.

Them se këto propozime të konkretizuara nuk kanë përse të skualifikohen si iluzione fantastike e utopiste, sepse vërtet janë të realizueshme dhe tepër të dobishme. Ne nuk kemi pse të shtiremi më të zgjuar e më ekologjisë se sa BE-ja, e cila tani politikat energjetike po i orienton drejt prodhimit të rrymës kryesisht me qymyr. Pastaj duhet t'i bëjmë llogaritë dhe nëse na dalin, se sa më të fituar do të dalim, po qe se shteti do investonte (me kredi të huazuara) e do i menaxhonte këto TEC-e me fitime të llogaritura si më lart, nga investimet që do t'i bënin e shfrytëzonin të huajt, atëherë duhet të vendosim për investime e fitime

të shtetit tonë. Paragjykimet se nuk jemi të zotet, se do vidhen kreditë, janë një marrëzi, pasi bankat që do jepnin kreditë dhe do përkujdeseshin që ato të investoheshin vetëm në TEC-e.

Ndoshta nuk do bëhesha teprueshëm i bezditshëm po të shtoja edhe një vlerë të madhe të koordinimit kombëtar: Që të mos ndotet e rrezikohet Bregdeti shqiptar me ndërtim të TEC-eve, pasi aty do t'i kalojmë pushimet ne dhe turistët e huaj, më e qëlluar do të ishte që edhe Republika e Shqipërisë t'i jepte kredi shtetit tonë, që TEC-et të ndërtohen kryesisht në Kosovë dhe kështu edhe Shqipëria do zgjidhte krizën e tanishme energjetike dhe do ruante Bregdetin nga ndotjet e TEC-eve me mazut.

3.b. Nxerrja dhe industria përpunuese e xeheve duhet të jetë orientim shoqërues për zhvillim të përshpejtuar

Pos shansit të madh që kemi me energji elektrike, një rast tjetër të madh e ka Republika e Kosovës me nxjerrjen dhe përpunimin e xeheve të shumëllojshme që ka. Meqë specialistët kanë të dhëna më të kompletuara, për shumëllojshmërinë, për sasinë, për cilësinë dhe për leverdinë e pasurive tona minerare, nuk do të ndalesha në këtë lëmi. Mjafton të kem shprehur mendimin e hidhëruar, se nuk duhet të bëjmë gabimin si me "Ferronikelin", sepse nga ato që po dëgjoj, vetëm me fitimet neto që po realizon pronari brenda një viti, ka kaluar sasinë e investimit (blerje dhe rinovim). Ky është shembulli më flagrant, se si nuk duhet t' ua dhurojmë privatëve të huaj pasuritë tona minerare për çmime qesharake. Po ta kishim të paprivatizuar, edhe për "Ferronikel", do kishim mundur të merrnim kredi, meqë stafin profesional e kishim, por po që se do mungonin kuadrot profesionale, firma që do e riparonte, do vinte në dispozicion stafin e saj, derisa të ishte aftësuar stafi vendor. Po të dija ku mund të merren të dhënat për fitimet që ka shteti nga kjo firmë, do isha kurioz t'i dija. Kurse sa për rrogat e të punësuarve, jam

informuar se janë të nivelit të një skllavi (rreth 250 euro në muaj merr furrtari!). Mbase mund të dalë e vërtetë se shteti ynë ia shet kësaj firme një ton xehe për 20 cent! Njësoj është edhe keqtrajtimi i të punësuarve aty, ngjashëm me firmat që ushtrojnë shfrytëzim barbar në ndonjë shtet të Afrikës. Ndërsa skandali me çmimin e rrymës, 35 euro për MWh, kur KEK-u e importon atë me çmim rreth 80-100 euro për MWh, është vërtet skandal që nuk meriton koment. Kontrata përkatëse duhet të jetë lidhur në rrethana korruptive, prandaj do i kishte bërë nder Kosovës ai që e ka firmosur, të denoncojë vetën e tij duke pranuar e dëshmuar shumën korruptive që ka marrë për të hedhur firmën e tij. Prokuroria do të ishte dashur të hetonte atë kontratë dhe po që se e pranon këtë formë të denoncimit publik, le të më trajtojë mua si denoncues konkret. Ky rast diskriminues duhet të nxit bizneset private në Kosovë që t'i bëjnë padi gjyqësore Shtetit, pse ia jep rrymën "Feronikelit" për 3 cent KW kurse bizneset tona private e paguajnë 12 cent (katër herë më shtrejtë)!

Për gjigantin "Trepça" po shpresoj se dikush nga kuadrot e mëhershëm duhet të ketë bërë projekte dhe parashikime për mjetet që nevojitën për ta riaktivizuar dhe për leverdinë ekonomike të tij. Se mos janë duke shfytëzuar nacionalistët serbë shkritoren në Zveçan, prandaj na bëjnë zhurmë politike për të krijuar tymnajë kamufluese për një shpërdorim të tillë ilegal. Shteti i Kosovës tani ka të drejtë të huazojë kredi, prandaj nëse është me leverdi, duhet ta aktivizojë këtë gjigant, edhe për hir të mitit që kishim në të kaluarën për të. Njësoj do duhej vepruar edhe me xehe e xeherore të tjera, pasi metaleve tashmë u ka hipur shumë çmimi.

Qeveria e Kosovës duhet të çlirohet nga mania e privatizimit. Rëndom shtetet e zhvilluara evropiane privatizojnë vetëm ato firma që nuk japin fitime, kurse ato që japin, i mbajnë për vete, për të pasuruar buxhetin e shtetit, i cili rrit mirëqenien sociale të qytetarëve, zhvillon infrastrukturën, etj.

3.c. Firmat e vogla dhe të mesme prodhuese janë shpirti i zhvillimit të përshpejtuar ekonomik

Zakonisht palca e kapitalizmit të zhvilluar janë firmat e vogla dhe të mesme private. Kjo ndodh sepse energjia investuese dhe rrezikuese të menaxhimit të përkushtuar të individëve është e madhe. Individi me këto karakteristika e potenciale investuese e menaxhuese, interesohet të shfrytëzojë në mënyrë sa më ekonomike e sociale fuqinë punëtore, duke e llogaritur atë si pjesën më të vlefshme të firmës së tij. Ai përkujdeset që punëmarrësit të kenë trajtim të merituar; të kënaqen sa më shumë me pagën, të jenë sa më të shëndetshëm dhe sa më të kualifikuar për punë. Kjo ishte përparësi kryesore e sistemit kapitalist ndaj sistemit socialist, ku në rastin e parë dihet se e kujt është prona dhe prandaj edhe meraku për ta rritur atë, kurse në rastin e dytë, prona ishte e secilit dhe e askujt. Për këto arsye nuk ekzistonte meraku i përkushtuar për ta rritur pronën socialiste. Ndryshe nga kapitalizmi i zhvilluar, kapitalizmi (ynë) vulgar aktual është jonjerëzor dhe nuk mund të shtyjë përpara zhvillimin ekonomik, shoqëror e social. Në kapitalizmin e zhvilluar gjithë të punësuarit informohen për sukseset dhe fitimet e firmës private, aksionare e shtetërore, punëmarrësve u mundësohet të kenë hise në fitime, pos pagës që e kanë të kontraktuar individualisht në fillim të punësimit, prandaj janë të motivuar të angazhohen me përkushtim, kurse në kapitalizmin vulgar pronarët punëdhënës provojnë të luajnë rolin "e zotit", që shpesh degjeneron në banditizëm. Në kapitalizmin e zhvilluar vetë punëmarrësit interesohen për të rritur e mbrojtur pasuritë e punëdhënësit, kurse në kapitalizmin vulgar punëmarrësit janë të pavullnetshëm, mundohet të vjedhin firmën, t'i bishtnojnë përkushtimit në punë, sepse punëdhënësi nuk ngopet vetëm me djersën e punëmarrësve, por ndonjëherë ai do edhe gjakun dhe trupin e tyre. Në kapitalizëm të zhvilluar formohen sindikata të fuqishme të punëmarrësve dhe shoqata të punëdhënësve, të cilat koordinojnë kryesisht rritjen e

pagave, sipas parametrave e konjunkturave të zhvillimit ekonomik, duke evituar kështu sa më shumë protestat e grevat e punëmarrësve, kurse në kapitalizmin vulgar punëmarrësit e kanë të vështirë të formojnë sindikata dhe prandaj të drejtat e tyre janë të ndrydhura. Për pasojë, kapitali i punëdhënësve në kapitalizëm të zhvilluar (social), që tashmë po quhet me termin "ekonomia sociale e tregut" (gjetje gjermane), trajtohet e ruhet me përkushtim edhe nga punëmarrësit, kurse në kapitalizmin vulgar, kapitali i punëdhënësit rrezikohet nga rebelimi i punëmarrësve, i cili mund të përshkallëzohet në trazira të zgjeruara sociale. Këto relacione tashmë po përjetojnë transformime edhe në Perëndim, pasi gjithnjë e më shumë po vjen në shprehje ekonomia e globalizmit (me imponimin amerikan) dhe pasojat e para të këtij rëndi të ri botëror po duken në sfond përmes krizës së rëndë financiare në Amerikë, rrjedhimisht edhe në Evropën Perëndimore.

Për momentin, në Republikën e Kosovës, jemi në fazën e parë të kapitalizmit vulgar, sepse nuk kemi shumë punëdhënës që kanë virtytet dhe aftësitë e një punëdhënësi të mirëfilltë, sepse punëdhënësve tanë u mungon profesionalizmi dhe ndërgjegjja sociale.

Aktualisht në Kosovë nuk kemi kushte dhe kemi pak biznesmenë të mirëfilltë për themelimin e ngritjen e firmave të mesme prodhuese. Kapitalizmi ynë vulgar dominohet nga tregtarët matrapazë. Aktualisht në Kosovë mungojnë njerëzit e projekteve dhe kreditorët e tyre për të formuar firma të mesme private të prodhimit. Aktualisht në Kosovë mungon energjia elektrike, si faktor i parë kushtëzues për të startuar e gjallëruar firmat e mesme private. Aktualisht në Kosovë mungon shteti, i cili do të nxiste e koordinonte formimin dhe suksesin e firmave të mesme prodhuese. Aktualisht në Kosovë nuk mund të motivohen firmat e huaja për të investuar në Kosovë, sepse, që në fillim, pronarët e tyre ballafaqohen me terrin elektrik dhe me burokracinë e korruptuar dhe të paaftë, si dhe me sistem të ngatërruar fiskal e me gjyqësi të mjerë e të korruptuar. Pushtetarët mund të mashtrojnë qytetarët e Kosovës se së shpejti do të vijnë investitorë të huaj, pasi i kanë kushtet e favorshme për investim. Por nuk po ndodh ardhja e tyre, sepse që të vijnë ata, duhet

të krijohen kushte. E, kushti më i parë është rryma elektrike, të cilën nuk e kemi dhe siç po duket nuk do ta kemi edhe për disa vite me mendësitë e qasjet e tanishme (fabrikat nuk mbahen me gjeneratorë). Kusht i dytë janë ligjet dhe administrata funksionale dhe nuk duket që i kemi. Kusht i tretë janë punëtorët e kualifikuar dhe me kulturë e përkushtim për punë, që nuk duket t'i kemi etj. Investitorët e huaj janë të informuar për këto e kushtet të tjera të disfavorshme që kemi aktualisht në Kosovë, prandaj ata nuk vijnë që ta rrezikojnë kapitalin e tyre.

Nuk mund të quhen biznesmenë e tregtarë ata që sapo të kenë ngritur firmë me mjete që nuk u dihet prejardhja ose me huazime mashtruese dhe me kamatat e fajde të larta, që fitimin e parë e harxhojnë për t'u blerë vetura e banesa të dashurave të tyre, që fitimet e para i harxhojnë për të plotësuar qejfet e tekat e prostitutave të tyre.

Vështirë se mund të kenë suksese firmat që investojnë e menaxhojnë ata që nuk kanë njohuri elementare se si menaxhohet firma dhe as atëherë kur kemi menaxherë të aftësuar profesionalisht, por të pandershëm e të pabesë, të cilëve, po iu besua menaxhimi i firmës nga pronari, vetëm shikojnë se si ta vjedhin e shpërdorojnë, sepse ende nuk kanë kulturë e përvojë menaxhimi.

Vështirë se mund të kenë sukses firmat që nuk kënaqen edhe me suksesin që është diç më i lartë se kamata e kredive bankare, por synojnë me çdo kusht e mjet rritjen e qind për qindtë të investimit brenda një viti, mendësi kjo që vjen ose është kopjuar nga mendësitë kriminale të kontrabandës dhe krimit të organizuar.

Fatmirësisht kemi disa individë me talent, shpirt e kulturë prej biznesmeni, me shpirt patriotik dhe ndërgjegje sociale. Këta po ngrenë firma dhe po investojnë në prodhim e punësim, por po ballafaqohen me vështirësi të shumta, siç janë pamundësia për marrje të kredive me kamata ekonomike, që po ballafaqohen me mungesën e rrymës, që po ballafaqohen me korrupsion dhe burokracia shtetërore, që po ballafaqohen me biznesmenë konkurrues të pandershëm që i marrin tenderët me lidhje e ryshfete, etj. Druaj se këto vështirësi do i lodhin

këta individë të mrekullueshëm dhe do t'i detyrojnë të dorëzohen (bankrotojnë).

Shteti duhet të krijojë kushte dhe atmosferë për ngritjen e firmave të vogla e të mesme prodhuese, siç po ndodh kjo në Evropën Perëndimore, duke shkuar aq larg, sa edhe t'i subvencionojnë me mjete të shtetit, për të ulur papunësinë. Kushti i parë është që t'u sigurojë rrymë (për mundësitë shkrova më lart) dhe kushte të tjera që duhet t'i përpilojnë vetë shoqatat e këtyre firmave. Kjo do rriste përgjegjësinë dhe ndershmërinë e pronarëve të këtyre firmave që të paguajnë tatimet. Shteti duhet t'ua njohë firmave gjithë investimin për zgjerimin e tyre, që shoqërohet me rritje të punësuarve dhe pastaj të marrë tatim vetëm në fitimin neto, që nuk prish punë po qe edhe 20 për qind. Firma "Mercedes" ose "Siemens" në Gjermani, për shembull, paguan zero euro tatim-fitim, pasi shteti ua njeh investimet në rritjen e tyre, që shoqërohen me punësime të reja. Pra, këto firma kanë fitime neto prej dhjetëra miliardë eurosh në vit, por atyre u mundësohet të investojnë gjithë fitimin, duke u liruar në fund nga pagesa e tatim-fitimit. Në këtë rast fitimin shteti e ka nga zvogëlimi i papunësisë dhe i ndihmave sociale që u jep të papunëve e pastaj edhe nga tatimi në pagat dhe nga *tvsh*-ja e mallrave që prodhohen e që dalin në shitje nga këto firma. Nga kjo rrjedh se firmat gjermane nuk i demotivon tatimi në fitim prej 39 për qind (pothuajse dyfishi i nivelit të tatimit në Kosovë) dhe as *tvsh*-ja prej 19 për qind, pasi nga i pari lirohen për shkak se u njihet i gjithë investimi, kurse të dytin e paguajnë konsumuesit e prodhimeve të tyre.

3.d. Zhvillimi i hovshëm i bujqësisë dhe i blegtorisë është tepër i domosdoshëm për të dalë sa më shpejt nga kjo krizë e madhe e papunësisë dhe e varfërisë në fshat

Edhe më i painformuari gjatë rrugëtimeve, ta zëmë nga Prishtina në Ferizaj, mund të shohë se bujqësia dhe blegtoria janë fare të pazhvilluara,

bile në atë nivel sa domosdo ndjen keqardhje. Dikur fushat buzë rruge ishin me ara pa fund me luledielli, panxharsheqeri, grurë, që sot janë pothuajse tërësisht të djerra, ose akoma më keq, të shpërfytyruara me ndërtime vulgare e të pasistemuara dhe copëzuar në parcela të vockla. Për fshatarësinë tonë dikur këto fusha veprimtarie ishin mundësia e vetme për mbijetesë. Atëherë shumica e popullsisë jetonte në fshat.

Ishte një kohë jo fort e largët kur tokat e punës në Kosovë punoheshin cep me cep, kullosat gjithashtu shfrytëzoheshin cep me cep. Bile hapeshin toka të reja duke shkulur shkurre e duke i kthyer ato në vreshta, grunishte e pemishte. Ato prodhime mbulonin kërkesat e tregut vendës dhe një pjesë plasohej në tregjet e ish-Jugosllavisë, qoftë nga vetë prodhuesit, qoftë nga tregtarët. Fillesa e rënies së përkushtimit për bujqësinë e blegtorinë duhet të ketë ndodhur që kur fshatarët kanë filluar të emigrojnë në Perëndim. Që atëherë e ka fillesën edhe një si parazitizëm, kur familjet nisën të prisnin ndihmat e emigrantit dhe nuk punonin vetë në bujqësi si përpara. Pastaj ky mosinteresim u rrit gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, pasi prodhimet bujqësore nuk kishin mundësi të plasoheshin në ato tregje dhe tregu i Kosovës nuk ishte në gjendje "t'i absorbonte" prodhimet bujqësore vetëm brenda sezonit. Sot një pjesë e madhe e fshatarëve nuk duan të merren me bujqësi e me blegtori dhe arsyetimet më të shpeshta të tyre janë se nuk kanë leverdi. Po të ishte e vërtetë kjo edhe mund të arsyetoheshin. Por kur sheh se fshatari ynë nuk kultivon as edhe një leh me perime, qoftë vetëm për *hobby*, që t'i ketë të freskëta dhe ekologjike, atëherë mund të thuhet se ata i ka përfshirë dembelizmi e parazitizmi. Kurse mua më ka rastisur të informohem nga ata që merren me kultivimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, se ka fitime. Një mik imi në Maqedoni kishte mbi njëmijë dele. Fitimi neto vjetor e ka rreth 70 mijë euro. Ka të punësuar 8 veta, barinj e baxhoxhinj, me pagë mujore. Një përllogaritje e thjeshtë: njëmijë dele mund të blihen për 70-80 mijë euro. Rezulton se investimi për të blerë njëmijë dele shpaguan veten pothuajse brenda vitit. Kush mund t'i thotë këtij biznesi se nuk është me leverdi!? Por habia ime ishte shpjegimi i mikut, se nuk mund të gjesh barinj e baxhoxhinj shqiptarë, pasi e përçmojnë këtë

profesion. Të gjithë barinjtë e baxhoxhinjtë i kishte "torbeshë". Një tjetër i njohur imi në Rugovë mezi bëri 80 dhi. Më shpjegoi se fitimin mesatar mujor e kishte rreth 700 euro neto. Por u detyrua t'i shiste pas katër vjetëve, meqë nuk gjente bari për të punësuar dhe së fundi filluan ta përçmojnë gruaja e vajza, të cilat rronin në qytet, duke i thënë se kundërmonte erë dhish. Një tjetër i njohur në Dukagjin më shpjegoi se kishte një fermë me 21 lopë. Tani ky fermer dorëzon prodhimet ditore në fabrikën e qumështit, për të cilat merr rreth 5.200 euro në muaj. E pyeta për fitimin neto. Me tha me tallje: 2.200 euro më dalin që t'i trajtoj lopët si në hotel, pastaj ato më japin mesatarisht një viç në vit. Një bujk që kultivon speca e takova kur po bënte pazar me një emigrant që po i blinte ato për t'i plasur në tregun gjerman. Më shpjegoi se nga një hektar speca fiton rreth 6 mijë euro. Një profesor me shpjegoi për leverdinë e investimit në plantacione mollësh, dardhësh, etj. I solla këta shembuj për t'ua kundërvënë atyre që thonë se nuk ka leverdi të merresh me bujqësi e me blegtori. Ka nga ata që do të donin të merreshin, e dinë që kanë leverdi, por ankohen se nuk kanë ku të huazojnë mjetet për të blerë vegla bujqësore dhe kafshë, për të ndërtuar stalla, depo frigoriferi, etj. Bankat nuk të japin kredi për këto fushëveprimtari dhe, edhe nëse t'i japin, i kanë kamatat tepër të larta (rreth 15 për qind në vit) dhe i kanë afatshkurtra, që mund t'i përballojë ndoshta vetëm ndonjë tregtar ose ndërtues.

Kur t'ua shtosh këtyre se edhe një pjesë e tokave të kooperativave i kanë blerë ca matrapazë dhe i kanë lënë të djerra, që të presin kur të rritet çmimi dhe t'i shesin duke i copëtuar ato, atëherë po shihet së në ç'gjendje të mjerueshme është bujqësia dhe blegtoria.

E kuptoj, nuk mund të rrojë fshatari me një ose dy lopë, pasi ato kërkojnë përkushtim gati sa një fermë dhe po kaq e mundimshme është shitja e qumështit të tyre, pasi qumështoreve nuk u leverdis të shkojnë për t'ia marrë atë sasi të vogël qumështi. E kuptoj, nuk mund të rrojë fshatari me 40 ari (4 dynym) tokë. Por shtrohet pyetja: kanë të drejtë njerëzore pronarët t'i lënë djerrë tokat dhe kullotat e tyre!?

Edhe pse mund të bezdis të bezdisurit me këto shpjegime, pasi pandehin se dinë gjithçka, po u shtoj shpjegimeve të mësipërme se aktualisht shumicën e fshatarëve i kemi të dëshpëruar, të zhgënjyer e të stresuar. Si shumë të varfër që janë, ata medoemos duan të mbajnë makinë që të shkojnë në qytet për të pirë kafe, ose të shkojnë në shitore për të blerë bukë, meqë më nuk e gatuajnë bukën në shtëpi, ose për të blerë perime, meqë vetë nuk i kultivojnë më në fushat e tyre. Kurse fshataret duan të kenë fustane mode për dasmat, synetllëqet e ahengje të tjera të shumta, që ngjasojnë me ato të aktoreve kur shkojnë në ndonjë festival filmi, dhe mundësisht për çdo aheng, të kenë fustan të ri, nga ato më të modës, pasi të mëparmin ua kanë parë gratë dhe do të ndjeheshin të humbura në garën që do të ndodhë. Fshataret duan të kenë fustane të veçanta në mbrëmje semimature, mature, brucoshiade e absolventiade, njësoj si vajzat e çakërdisura të qytetit, të cilat i detyrojnë prindërit edhe të huazojnë për t'ua kënaq këtë vesë e trend të shpërfytyruar (që nuk të rastis ta shohësh në Perëndim). Kështu, duke jetuar mbi mundësitë reale, fshatarët nga dita në ditë po "bankrotohen" shpirtërisht e psikikisht, ashtu si edhe banuesit në qytet. Për këtë gjendje, shpresë të fundit kanë dërgimin e djemve në Perëndim, ose vajzat t'i martojnë në Perëndim...

Cilat janë rrugëzgjidhjet, pasi për të përshkruar, nxirosur e kritikuar gjendjen, po e bëjnë të gjithë, kryesisht në kafene, ku po kalojnë pjesën më të madhe të kohës aktive?

Meqë pushtetarët nuk kanë kohë të merren me hallet e fshatarësisë, mbi 60 për qind të popullsisë, nga se pushtetarët merren vetëm me "punë të mëdha", do të duhej që vetë fshatarët të mendojnë për rrugëzgjidhjet, në bashkëpunim me ekspertët dhe biznesmenët. Dhe cilat do ishin format e bashkëpunimit? Ta zëmë, fshatarët kanë shqetësim se po të mbjellin perime, vështirë se do të mund t'i plasojnë në treg, pasi shohin shumë bujq që digjen në diell sipër traktorit me speca e domate duke pritur blerës, dhe mendojnë se ashtu u kalon gjithë jeta. E vërtetë është se tregu i Kosovës është i vogël për t'i konsumuar brenda sezonit ato pak perime që po prodhojnë bujqit. Por pas sezonit dyqanet tona po furnizohen me perime nga importi. Sikur investitorët e vegjël e të mëdhenj të dinin se

më me leverdi kanë të investojnë në depo frigoriferi, se sa në pompa benzine ose kafe e restorante, atëherë do të orientoheshin në këtë fushë të invenstimit. Për një kafene ordinere duhen investuar të paktën 30 mijë euro, plus qirasë mujore. Një depo frigoriferi prej 300 metra kub kushton rreth 30 mijë euro. Në të mund të deponohen rreth 50 ton speca, ose 150 ton domate. Specat mund t'i blihen bujkut në arë me 20-30 cent kilogrami, kurse domatet me 10 cent, të ruhen 2-3 muaj në depo dhe pasi të ikë sezoni, të nxirren në treg me çmim të dyfishtë. Pastaj në depo mund të futet një zarzavate tjetër dhe një tjetër, duke e shfrytëzuar rreth katër herësh në vit. Besoj se përllogaritja e fitimit do dalë e lakmueshme, pasi sikur edhe vetëm 10 cent për kile të fitohen, depoja do paguante vetën brenda vitit. Ky përfitim do nxiste zhvillimin e bujqësisë, pasi kur fshatari di se e ka të shitur prodhimin një vit përpara, ai motivohet për ta kultivuar. Pastaj biznesmenët investues do mund të konsultoheshin me profesionalistë për të investuar në punishte për përpunim të perimeve, etj. A nuk është idioteske të blejnë piceritë tona hudhra nga Kina apo salcë domatesh që importohet nga Italia, edhe pse lënda e parë (hudhra dhe domatja) këtu është me bollëk dhe do të rritej kultivimi i tyre sikur të kishin blerës që do i përpunonin? Ky lloj bashkëpunimi do nxiste bujqësinë, sepse kultivuesit e perimeve nuk do të kishin më problem shitjen. E njëjta vlen për pemët. Profesori i pemëtarisë më pat shpjeguar se një hektar pemishte me mollë ose dardhë jep në vit rreth 40 ton. Investimi fillestar është rreth 10-12 mijë euro për hektar, mirëmbajtja vjetore rreth 800 euro. Prodhimtaria e frytshme e një pemishte zgjat rreth 20 vjet. Le të llogarisin ata që dinë, nëse ka ose nuk ka leverdi. Mua më rezulton se ka, prandaj është gjynah që ne të konsumojmë kryesisht pemë importi. Sigurisht, biznesmenët investues nuk do të duhej të harronin se në tregjet e Perëndimit do të mund të depërtonin edhe përmes emigracionit tonë. Vitin e kaluar takova një emigrant që eksportoi speca. Në secilën maune kishte fitim rreth 7 mijë euro, meqë prodhimet bujqësore të Kosovës janë të liruara nga dogana në BE. Kurse para vitesh, gjatë një takimi me pronarin e rrjetit më të madh tregtues në BE, "ALDI", ky më shfaqi gatishmërinë për të blerë gjithë prodhimin e

perimeve dhe pemëve të Kosovës, por për këtë, tha ai, janë të nevojshme sidomos depot me frigoriferë dhe infrastruktura përcjellëse, pasi gjithë bota i staxhionon perimet nga ara në depo e pastaj gjen tregjet për to.

Një problem serioz për zhvillim të bujqësisë paraqet copëzimi i tokave për shkak të ndarjes së familjeve. Lidhjet emocionale, deri në kult, të fshatarit me tokën, bëjnë që ai të mos e shesë tokën edhe kur nuk e shfrytëzon, dhe nga ky shkak shumë tokë punuese del jashtë prodhimit. Për parcela të vogla nuk leverdis të blihen makineri bujqësore dhe prandaj pronarët i lënë djerrë. Zgjidhja e kësaj pengese do të ishte ose sistemimi i tokave, ose shitja atyre që ia dinë vlerën bujqësisë, por jo me çmimet emocionale, por reale. Marrja me qira e tokave që tani nuk punohen dhe punimi i tyre nga ndonjë firmë bujqësore, është një zgjidhje tjetër e leverdishme. Konsideroj se ministria e bujqësisë do të duhej marrë me seriozitet këtë çështje. Në fund të fundit, kjo është edhe përgjegjësi e saj. Përndryshe, a ka më turp që ne, në Kosovë, që ishte hambari i Shqipërisë, siç vlerësohej dikur, të lëmë dhjetëra mijë hektarë tokë të pëlleshme të shndërrohen në djerrina e të varemi nga importi i drithërave nga Serbia? Si të arsyetohet kjo?

Sa për blegtori dihet mirëfilli se Kosova ka deficit të madh. Tregtarët e Kosovës importojnë qumësht nga Sllovenia, djathë nga Danimarka, mish deri edhe nga Brazili. Në mungesë të qumështit, që do dorëzonin fermerët tanë, disa qumështore të këtushme importojnë qumësht pluhur dhe na e përziejnë me ujë (pa informuar konsumatorët për këtë veprim).

Për të dy këto fushëveprimtari do të duhej bashkëpunim i bujqve, blegtorëve, ekspertëve dhe i investitorëve, që të mund "të thithnin" sa më shumë donacione, të cilat parashihen të vijnë shpejt nga BE dhe shtete të tjera. Nuk duhet të përsëritet gabimi i viteve 1999-2003, kur donatorët ankoheshin se nuk iu paraqiteshin projekte e kërkesa për bujqësi e blegtori.

Brukseli subvencionon shumë bujqësinë e blegtorinë në BE. Edhe shteti i Kosovës, posa pushtetarët të lirohen nga "punët e mëdha",

duhet të merret më me përkushtim me këtë sektor. Fshatarët mund të kuptojnë arsyen pse shteti ynë i varfër nuk mund t' i ndihmojë, por nuk do të mirëkuptojnë pushtetarët për mosinteresimin e për mospërkrahjen, qoftë edhe vetëm morale. Përndryshe, qeveritarët dhe parlamentarët do të duhej të merrnin sa më shpejt vendim për të themeluar një bankë (bujqësore) zhvillimore me mjetet e fondit të privatizimit (për të cilat ndoshta qeveria jonë nuk di se ku po "dergjen").

Tashmë duhet të kuptohet se "nuk bëhet rrushi me urata, por me shatë e lopata", thotë një proverb popullor, prandaj fshatarët, blegtorët, specialistët, investitorët dhe pushteti, duhet të bashkëpunojnë e t'i qasen më seriozisht zhvillimit të bujqësisë e të blegtorisë, pasi nuk është në interes të askujt, sidomos aktualisht nuk është në interes të shtet-bërjes e të shtet-ndërtimit, nëse fshatarësia "bankroton".

Për të provokuar shqetësimin e arsyeshëm, se vërtetë nuk ka kuptim të importojmë qumësht e bulmetra, po sjell të dhëna për fondin e tokës, se sa e mjaftueshme do të ishte për nevojat ushqimore të popullatës se Kosovës dhe numrin e bagëtisë që dispononte Kosova në vitin 2003, për të parë se sa mbrapa jemi në këtë lëmi:

Pyje:	464.800	hektarë
Tokë pyjore:	28.200	hektarë
Tokë bujqësore:	342.400	hektarë
Kullosa dhe livadhe:	153.200	hektarë
Tokë e djerrë:	23.400	hektarë
E pa klasifikuar:	41.600	hektarë

Fondi blegtoral në Kosovë në vitin 2003:

Gjedhë:	238.857	krerë
Dhenë:	93.313	krerë
Derra:	53.222	krerë
Dhi:	13.344	krerë

Këto shifra duhet të na bindin se sa hapësirë të madhe kemi për angazhim në bujqësi e blegtori dhe ku do jenë përfitimet e mëdha nëse në këta sektorë do angazhoheshin bujqit, blegtorët, investitorët, tregtarët, strukturat përkatëse shtetërore, etj.

3.e. Bankat dhe firmat e sigurimeve duhet të disiplinohen e të kontrollohen, pasi bankrotimi i tyre shoqërohet me pasoja edhe sociale

Në gjithë shtetet e zhvilluara dihet se bankat dhe firmat e sigurimeve luajnë rol shumë të madh në zhvillimin ekonomik të vendit. Në Kosovë, siç po shihet, bankat dhe sigurimet përgjithësisht po luajnë rol të kundërt, pse të mos themi se janë të angazhuara që të plaçkitin Kosovën sa më shumë e sa më shpejt. Dëshmi e parë për këtë është dhënia kredive sipas një procedure fyese, me kamatë të lartë dhe me afatizim të shkurtër. Të tilla kredi nuk do t'u leverdisnin as kredimarrësve në vendet shumë të zhvilluara, prandaj, atje kamatat janë shumë më të ulëta, me afate më të gjata, për aq sa u leverdisë kredimarrësve. Kjo mund të dëshmojë se këto banka janë të orientuara të mbledhin sa më shumë para nga depozituesit, që ato t'ua mbajnë pa kamatë, ose me një kamatë fare simbolike dhe pastaj ato t'i japin hua me kamata të larta.

Bankat në Kosovë ende nuk janë banka të mirëfillta, sepse nuk kanë CIP-cod-e të tyre, siç i kanë bankat në shtetet e mirëfillta.

Tregun bankar në Kosovë e zotërojnë bankat e huaja dhe tashmë mund të thuhet me shqetësim, se banka vendore Republika e Kosovës pothuajse nuk ka. Në fillim u themeluan ca banka vendore, por doli se ato ishin themeluar për qëllime hileqare dhe falimentuan duke u shkaktuar dëme klientëve.

Një bankë qendrore shtetërore ekziston pothuajse vetëm sa për simbolikë, pasi Republika e Kosovës nuk ka valutë të vetën dhe nuk ka asnjë marrëveshje me BE-në, gjegjësisht me Bankën Evropiane në

Frankfurt, "për të menaxhuar" sasinë e valutës së BE-së, që është në qarkullim si valutë e vetme "komunikuese" në Kosovë. Rrjedhimisht, Republika e Kosovës nuk ka si të bëjë politikë monetare përderisa nuk ka bankë shtetërore dhe përderisa nuk ka qasje në "bashkëmenaxhim" të euros.

Në mungesë të një banke shtetërore, e cila do koordinonte kursin dhe kamatën e valutës në qarkullim, Republika e Kosovës do të duhej të themelonte, të paktën, një bankë zhvillimore, me kapitalin themelues të mjeteve që janë grumbulluar nga privatizimi. Përmes kësaj banke do të mund të koordinohej tregu i kamatave dhe qytetarët e Kosovës do të kishin një bankë që nuk do u bënte trajtim diskriminues, sepse, vështruar në aspektin bankar, qytetarët sikur janë shndërruar në "mall të pazot".

Mundësi tjetër tepër e favorshme është që Trusti i Pensioneve të themelonte bankë të vetën dhe përmes asaj banke do menaxhonte mjetet e depozituara në fondin pensional, duke ua rritur atyre mjeteve vlerën, shumë më shumë se sa po ndodh tani me (keq)menaxhimin privat të tij. Prandaj, qeveria duhet të vendos sa më parë që Trusti të menaxhohet nga shteti i Kosovës edhe për interesa të atyre që paguajnë në të kontribute për pension të pleqërisë e të invaliditetit.

Edhe firmat e sigurimeve janë institucione të dyta që grumbullojnë e menaxhojnë të holla të shumta, por ato tani nuk po janë transparente për të publikuar pronarët e vërtetë dhe bilancet e tyre dhe për të informuar opinionin se si i menaxhojnë financat e tyre, që i kanë grumbulluar nga qytetarët "debitorë" të Kosovës. Si shumë përflitet se disa firma të sigurimeve, në dukje vendore, kanë pronarë formal të Kosovës, por janë të themeluar me kapital të dyshimtë. Prandaj është me rëndësi që qytetarët klientë të tyre të jenë të informuar saktësisht, që veprimtaria e këtyre firmave të jetë sa më transparente dhe të publikojë bilancet periodike, siç ndodh me firmat e sigurimeve në Perëndim dhe kur ato dalin shumë të fituara, të shpërblejnë edhe klientët, ta zëmë, duke ulur nivelin e sigurimit të automjeteve.

Një shembull tepër flagrant më bën të dyshoj se mos firmat e sigurimeve e kanë kapur shtetin. Bëhet fjalë për makinat e huaja që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, e që janë kryesisht të bashkatdhetarëve emigrantë. Ato makina paguajnë sigurimin e rregullt në vendet nga vijnë dhe dënohen të paguajnë sigurim ekstra kur hyjnë në Kosovë, edhe pse sigurimet e përhershme që kanë, u vlejnë edhe për Kosovën. Në prag të verës së vjetshme e pata ngrit këtë shqetësim para ministrit të brendshëm dhe ai më pat premtuar se do t'i qasej me përkushtim për ta trajtuar këtë çështje. Më pastaj nuk jam informuar se deri ku ka shkuar "zbërthimi" dhe "riparimi" i kësaj çështjeje, mos ndoshta sigurimet kanë ndërhyrë për të vazhduar më tej plaçkitjen e emigrantëve tanë.

Se si mund të shpërdorojnë "mjegullnajën" sigurimet, do sjell për ilustrim një ndodhi. Para katër vitesh m'u desh të veja për varrim të një mik në Kosovë. Gjendesha ne Tiranë. Me mua erdhi edhe një mik nga Tirana me *jeep*-in e tij, i regjistruar e i siguruar në Tiranë. Në kufi, në të hyrë në Kosovë, na u desh të paguajmë 40 euro sigurim "ekstra", edhe pse automobili do të kthehej brenda dite në Tiranë. Po atë ditë, i revoltuar, i bëra një letër kryeminstrit Pandeli Majko, me kërkesë se duhej të ndërhynte për ta hequr reciprokisht atë sigurim "ekstra". Z. Majko, në vend të përgjigjes me shkrim, më foli në telefon për vështirësitë, pasi mund të mos pranonte UNMIK-u. E luta t'i bënte një shkresë z. Steiner, përmes së cilës do ta paralajmëronte se Shqipëria do ta hiqte njëanshmërisht sigurimin "ekstra" për makinat e regjistruara e të siguruara në Kosovë. Shoqërisht më premtoi se do t'i shkruante, edhe nëse do të provokonte ndonjë "keqkuptim". Pas rreth dy javësh Steiner shkoi në Tiranë dhe firmosi marrëveshjen për heqjen reciproke të sigurimit "ekstra". Miku Pandeli më telefonoi sërish, më dha sihariqin për marrëveshjen e firmosur dhe më tha si me të qeshur se shqiptarët e dy anëve të kufirit të kanë borxh që u bëre nxitës i heqjes reciproke të sigurimit "ekstra". Mbase firmat e sigurimeve tani mund të më hidhërohen, sepse u janë zvogëluar plaçkitjet përmes sigurimit "ekstra" që ua bënin pronarëve të makinave të regjistruara e të siguruar në këto dy

shtete. Mund të merret me mend se në një vit mund të qarkullonin në të dy drejtimet rreth 1 milionë makina, të cilat detyroheshin të paguanin të paktën nga 40 euro, që do të thotë rreth 40 milionë euro në vit. Shpresoj se qeveria jonë do të angazhohet me përkushtim që sa më parë të heqë edhe sigurimin "ekstra" për makinat e bashkatdhetarëve emigrantë.

Mund që është miratuar ligji përkatës për sigurimet private pensionale, sepse po dëgjoj herë pas here reklama përkatëse. Nëse po, sa janë të sigurta dhe transparente firmat që kanë filluar këtë veprimtari, pasi shteti ynë është i detyruar të mbrojë qytetarët e vet nga mashtrimet e shpërdorimet, gjegjësisht, të kontrollojë se si menaxhohen mjetet që paguajnë qytetarët për sigurime private pensionale. Në Gjermani sigurimet private pensinoale e kanë të ndaluar të nxjerrin jashtë shtetit kursimet e qytetarëve për pensione private. Kurse në Kosovë, për habinë time, maksimalisht 5 % e mjeteve të Kursyera në Trust të pensioneve mund të mbahen në Kosovë. Gjithësesi: absurde. Prandaj duhet rishikuar ligji përkatës, sepse mund të ndodh që ndërkombëtarët kanë imponuar një ligj që t'u shkojë për shtati atyre që kanë pasur për qëllim përvetësimin dhe tjetërsimin e kursimeve në Fondin e pensioneve.

3.f. Shëndetësia tashmë po menaxhohet si biznes, prandaj duhet të reformohet

Sigurisht që do të bëhesha i bezdisshëm po të ndalesha në analizën, sado të shkurtër, të gjendjes katastrofale në shëndetësi dhe të kriminalitetit të madh që po ndodh në këtë lëmi, pasi është shkruar, folur e përfolur me tepri. Por nuk do të ngurroja të numëroja disa krime kryesore, pavarësisht se Ministri aktual po mundohet të na bindë me të kundërtën, duke e stërpërsëritur: "Shëndetësia nuk është në krizë".

- "Provizioni" që u jepej njerëzve të ministrisë kur ajo shpallë dhe jep tender për blerje të ilaçeve të listës (në qeverinë e kaluar përflitet të ketë bërë hatanë këshilltari i ministrit të shëndetësisë...);

- Vjedhja e ilaçeve të listës pozitive nga depot "shtetërore" dhe nxjerrja e tyre në treg si kontrabandim i tyre;

- "Provizioni" që merrej / jepej kur licencoheshin panevojshëm barnatore të reja;

- "Provizioni" që merrej / jepej kur licencoheshin teprueshëm ambulanca e "klinika" private;

- "Provizioni" që merrej / jepej kur licencoheshin farmacistë të Maqedonisë e të Shqipërisë, edhe pse ata nuk vinin të punonin në Kosovë (sepse është kusht për dhënie të licencës për barnatore të kesh farmacist, pavarësisht faktit se në barnatore do të shesin të pakualifikuarit);

- "Provizioni" që merrej / jepej kur licencoheshin për tregtim ilaçesh edhe matrapazët, sikur ilaçet të ishin patate, pa pasur përfaqësim ekskluziv të ndonjë firme prodhuese farmaceutike;

- Vjedhja e ilaçeve në spitale;

- Mosangazhimi i dinjitetshëm i mjekëve në spitale, duke i porositur të sëmurit që të shkojnë në "ordinanca" të tyre private;

- Prishja e qëllimshme e pajisjeve të sofistikuara teknike në spitale, për të detyruar të sëmurët të shkojnë te privatët;

- Tolerimi i importimit dhe i tregtimit të ilaçeve ilegale nga Serbia, të palicencuara, të padoganuara e të pakontrolluara;

- Korruptimi i mjekëve për të lëshuar receta vetëm të ilaçeve të firmave që i kanë korruptuar;

- Punësimi hileqar i mjekëve në spitale me orar të plotë të punës, sa për të marrë pagë shtetërore, për të marrë ryshfet të kushtëzuar nga pacientët fatkëqij, për të vjedhur ndonjë ilaç atje dhe angazhimi i tyre i gjithëvullnetshëm në ordinanca private;

- "Provizioni" i detyruar që merrej / jepej për të licencuar ilaçe të reja etj. etj.

A ka rrugëzgjidhje për gjendjen katastrofale në sistemin shëndetësor? Sigurisht që ka.

- Duhet të fillohet nga reforma madhore që secili banor të sigurohet privatisht, në sigurimin "shtetëror", i cili duhet të themelohet, dhe në

sigurimin privat te firmat private. Ta zëmë, secili banor po të detyrohej të kishte sigurim bazë, minimal prej 10 eurosh në muaj, nëse nuk punon dhe 30 euro në muaj, nëse është në marrëdhënie pune, shëndetësisë do i krijohej buxhet "privat" më i madh se sa i tanishmi. Për ata që nuk kanë fare të ardhura dhe që janë të varfër, sigurimin "privat" të tyre do të duhej të paguhej nga buxheti i shtetit, kurse për të gjithë ata që janë të punësuar, do duhej t'u merrej përqindja nga paga. Për përshtatje të këtij niveli do të duhej të vendoste një komision ekspertësh që do përbehej nga ekspertë përfaqësues të qeverisë, të sigurimeve private, të shoqatës së pavarur të mjekëve, të shoqatës se spitaleve "publike", të shoqatës së tregtarëve grosistë të ilaçeve, të shoqatës së barnatoreve, etj. Ky do të caktonte nivelin bazë të sigurimit, tarifat mjekësore në spitale e ambulanca shtetërore, në "klinika", ambulanca e ordinanca private, të cilat do të paguheshin nga fondet e sigurimeve shëndetësore dhe jo më drejtpërsëdrejti nga pacientët. Gjithashtu, ky komision do të vendoste çmimin e ilaçeve, gjegjësisht blerjen e tyre nga prodhuesit, gjegjësisht nga përfaqësuesit ekskluzivë tregtues të tyre. Orientimi i çmimit tregtues të ilaçeve do të duhej të ishte çmimi bazë i prodhuesit, plus 20 për qind për tregtarët e mëdhenj dhe përfaqësues ekskluzivë të tyre, plus 30 për qind për barnatoret ose spitalet.

Për të reduktuar shkuarjen e pothuajse të panevojshme të qytetarëve të siguruar për t'u kontrolluar te mjeku, qytetari do duhej të jepte një herë në tre muaj 5 euro (si në Gjermani që paguhen 10 euro), kurse ata që nuk shkojnë fare nuk duhet ta paguajnë fare këtë shumë. Ky "trik" dhe "triku" që të paguanin vetë qytetarët nga 10 euro në ditë për qëndrim në spital, në Gjermani pat reduktuar vizitat e panevojshme mjekësore dhe qëndrimet e panevojshme në spital për rreth 15 për qind, gjë që kishte peshë, pasi disa njerëzve, sidomos të moshuarve, u ishte bërë ves të shkonin panevojshëm të mjeku ose në spital, ndonjëherë vetëm sa për të përballuar monotoninë e kohës.

- Licenca për barnatore e ambulanca të lëshohen vetëm në bazë të kuotës që do të caktonte komisioni në bazë të standardit, sa barnatore e ambulanca për sa banorë janë të nevojshme dhe licenca të reja

të lëshohen vetëm në ato lagje e fshatra, ku nuk ka fare barnatore e ambulanca ose ka shumë pak.

- Çdo pacient të zgjedhë vetëm një mjek "shtëpie" në ambulancë private ose shtetërore, ku do t'i mbahej kartela shëndetësore dhe të mund të ndërronte mjekun e "shtëpisë" vetëm pasi të ketë përmbyllur vitin.

- T'u merret licenca të gjithë grosistëve të ilaçeve importuese, që nuk mund të dëshmojnë se kanë autorizimin për përfaqësim ekskluziv, minimum të një prodhuesi, që ka të licencuar minimum një ilaç në BE dhe në Kosovë.

- Të gjitha ilaçet që janë të licencuara në BE të mos kenë nevojë për licencim ekstra në Kosovë, por vetëm të kontrollohen nëse vërtet janë të licencuara në BE.

- Ilaçet që nuk janë të licencuara në BE të mund të licencohen nga organizmat e autorizuar për licencim në Kosovë, vetëm nga prodhuesi dhe firma përfaqësuese ekskluzive e tij.

- Të nxiten prodhuesit vendës për të prodhuar ilaçe *gjenerike* në vend dhe t'u lehtësohet dhënia e licencave, nëse i plotësojnë kriteret për prodhim.

- Të trajtohet si kontrabandë çdo ilaç që nuk ka pullë "shtetërore" dhe barnatoreve, mjekëve privatë, tregtarëve që tregtojnë ilaçe të tilla ilegale, t'u merret licenca dhe të burgosen, kur t'u zihen ilaçe ilegale, dhe jo të dënohen vetëm me kundravajtje ose të mos denoncohen fare nga inspektorët kontrollues, vetëm pse marrin ryshfet.

Hap tjetër me rëndësi do të ishte aftësimi i klinikave speciale për të evituar që shteti të dërgojë pacientë jashtë vendit, me shpenzime të larta. Në këto klinika të punësohen mjekë nga jashtë që do të plotësonin nivelin profesional (deri sa të aftësohen mjekët vendës), duke reduktuar dërgimin e pacientëve jashtë vendit. Projekte për këtë mund të bënte komisioni i pavarur. Kam dëgjuar për gatishmëri të investitorëve që do të hapnin klinika të tilla dhe do sillnin mjekë me emër nga jashtë, me çka do të kursehej buxheti i shtetit duke mos pasur nevojë të shpenzojë

kaq shumë për të dërguar pacientë jashtë vendit. Në këto klinika do mjaftonte të paguheshin vetëm 20 për qind të tarifave që paguhen tani jashtë, për të njëjtin mjekim ose intervenim kirurgjik, por frikësohen nga makutëria e babëzitur "shtetërore" se nuk do u japin licencë, ose do të vazhdojnë të dërgojnë pacientë jashtë shteti, meqë dyshohen për lidhje korruptive me disa klinika ku dërgohen pacientët me pagesë nga shteti.

Edhe privatizimi i spitaleve është një zgjidhje dhe mjetet e fituara nga privatizimi i tyre mund të shfrytëzohen për të paguar sigurimin bazë të qytetarëve të papunë dhe të varfër. Kjo do e konsolidonte dhe do e shëronte shëndetësinë nga epidemia aktuale, pasi që një shëndetësi e sëmurë, nuk ka se si të shërojë të sëmurët (por ec e beso se këto reforma do t'i inicionte një ministër sharlatan dhe i babëzitur për të marrë "provizione" për tenderë e licenca dhe i cili, për këtë qëllim, ka emëruar nipin e vet si shef kabineti, siç më informuan në ministrinë e shëndetësisë).

Gjithçka është edhe më e thjeshtë se sa shpjegimet që bëra. I vështirë është vetëm vullneti i mirë i pushtetit për të bërë reformë.

3.g. Roli i emigracionit në zhvillimin e përshpejtuar

Dihet roli historik i emigracionit dhe i diasporës, në rend të parë, në rrjedhën e ngritjes së vetëdijes kombëtare (Rilindja Kombëtare Shqiptare e ka zanafillën tek diaspora shqiptare në Itali, në Rumani dhe në Turqi), pastaj kontributi në çlirimin e trojeve tona nga pushtuesit, po edhe roli i tij gjatë shtet-bërjes dhe shtet-ndërtimit. Kujtesën e kemi të freskët dhe e dimë se sa shumë ka kontribuar emigracioni ynë gjatë këtyre katër dekadave, fillimisht duke ndihmuar në shkollimin e fëmijëve e të afërmve, duke ndihmuar për mbijetesë sociale dhe ekonomike, e veçmas ndihmat dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e një numri sish në luftë për çlirimin e Kosovës.

Realitet është se në emigracion, nga Greqia deri në Finlandë, kemi mbi një milionë qytetarë të Kosovës, pothuajse kryesisht dhe tërësisht të etnisë shqiptare. Shteti zviceran ka statistika më konkrete për numrin e emigrantëve shqiptarë të Kosovës, që është diku rreth 240 mijë veta. Në Gjermani duhet të jenë mbi 600 mijë, në Suedi rreth 80 mijë, e kështu me radhë, kurse në shtete të tjera, numri tyre është më i vogël. Edhe përtej oqeanit duhet të kemi të paktën 200 mijë emigrantë. Ky numër kaq i madh i emigrantëve, mbi një e treta e popullsisë se Kosovës, është një humbje e madhe kombëtare, por është edhe një rast i madh për zhvillimin të përshpejtuar të shtetit tonë.

Nga numri i përgjithshëm i emigrantëve, rreth 700 mijë duhet të jenë në marrëdhënie pune, kurse të tjerët të moshës rinore, ose ndonjë grua që është amvise, si dhe pak pensionistë. Po të kishin gjithë këta vullnetin e mirë, i cili varet nga besimi se nuk do u keqmenaxhoheshin mjetet, dhe po të dinin se mjetet që do investoheshin në energjetikë, do u rriteshin rreth 30 për qind në vit, ky emigracion do të mund të investonte rreth 5 miliardë euro në TEC-e. Me këtë, në njëfarë mënyre, Kosova do ua kthente "borxhin" për kontributin që kanë dhënë emigrantët që katër dekada. Ata do të mund të vetorganizoheshin për t'i tubuar këto mjete dhe për t'i vetëmenaxhuar sikur shteti ynë të garantonte dhe të merrte me seriozitetin e duhur çështjen e investimeve të tyre. Kursimet, patundshmëritë, bizneset e emigrantëve tanë u rritën mesatarisht 3 deri në 10 për qind në vit në vendet ku gjenden. Përse të mos duan ata që investimet e tyre në energjetikë këtu, në atdheun e tyre, t'u rriten rreth 30 për qind në vit dhe kështu të motivohen kuadrot me përgatitje e përvojë të kthehen në Kosovë, për të përshpejtuar bashkarisht zhvillimin e gjithëmbarshëm ekonomik?

Dhe, po e patën të pamundur që të vetorganizohen për të bërë investim kaq fitimprurës për vetën e tyre, dhe kaq domethënës për zhvillimin e përshpejtuar të shtetit tonë, atëherë qeveria do duhej të angazhohej, duke ua kërkuar këto mjete, fillimisht si hua, me kamatë rreth 5 për qind në vit, duke u garantuar se do ua shndërronte në aksione kur TEC-i të fillonte me prodhimin e energjisë elektrike.

Vullneti i tyre tashmë për të investuar në zhvillimin e Kosovës (që unë do ta vlerësoja si një lloj ndihme patriotike), në rend të parë për interesa të tyre ekonomike, mund t'u rikthehet emigrantëve, nëse ata do të binden se klasa politike e Kosovës nuk i deshi ata vetëm sa për t'i shfrytëzuar deri në çlirim të Kosovës, që pastaj Kosovën e çliruar ta shndërronin në pashallëk privat, por për të krijuar mirëqenie për të gjithë.

Asnjëri nga politikanët dhe qeveritarët as që u kujtua që t'u ofrojë një përfaqësim simbolik emigrantëve në Kuvendin e Kosovës (siç ka vepruar Kroacia, Italia, etj.). Asnjëra qeveri nuk u kujtua të formojë ministri të emigracionit, siç e kanë disa shtete të botës që kanë më pak emigrantë se sa Kosova. Le të arsyetojmë se qeveritë e deritanishme nuk kishin kompetenca për t'u marrë me emigracionin, pasi UNMIK-u nuk ishte i predispozuar as që t'i pranojë që të regjistrohen emigrantët e Kosovës si banorë të Kosovës, e lëre më që t'i pranojë të rikthehen në Kosovë, kur disa shtete donin t'i kthenin ata që u kishte kaluar strehimi politikë. Qeveria e tanishme nuk do të mund të arsyetohet për mungesë të kompetencave, nëse do të vazhdojë të injorojë emigracionin. Të shohim si do të sillen në të ardhmen pushteti, policia, administrata, pasi u pavarësua Kosova. Deri tani jemi dëshmitarë që vetëm sigurimet private i "mirëprisnin" emigrantët për t'i plaçkitur me sigurim "ekstra", pa hyrë mirë automobilat e tyre në territorin e Republikës së Kosovës, ndonëse ato i kanë të siguruara. Deri tani jemi dëshmitarë se policët i "mirëprisnin" emigrantët që t'i gjobisnin për rregulla komunikacioni, për vendparkime "të ndaluara" etj. Deri tani administratorët shtetërorë i "mirëprisnin" emigrantët për t'i maltretuar gjatë lëshimit të dokumenteve personale, duke i kushtëzuar me ryshfete. Deri tani gastronomia i "mirëpriste" emigrantët vetëm për të rritur fitimet e tyre. Më në fund, edhe familjarët po i "mirëpresin" emigrantët pothuajse vetëm për hir të ndihmave financiare dhe mirëpritja familjare ka nisur të zbehet për shkak se emigrantët nuk po kanë vullnet e mundësi për të ndihmuar si përpara. Në fund të fundit, emigracioni ynë ka rëndësi edhe si potencial turistik, pasi rreth 500 mijë emigrantë që vijnë gjatë pushimeve verore,

mund të shpenzojnë në Kosovë një shumë të konsiderueshme gjë që shkon në dobi të ekonomisë së vendit.

Në fund të fundit, emigracioni ynë në Zvicër e BE ka rëndësi qoftë edhe vetëm si konsumatorë të prodhimeve bujqësore e blegtorale që Kosova ka nevojë t'i eksportojë.

Disa emigrantë u angazhuan të investojnë në Kosovë, por pushteti nuk ishte i gatshëm t'i këshillojë, se ku është më me leverdi që të investojnë, nuk ishte i gatshëm t'u krijojë lehtësira procedurale ose që t'i këshillojë që të mos i harxhojnë kursimet e tyre në ndërtimin e shtëpive luksoze e blerjen e banesave, pasi nuk është me leverdi që të investohet në to për t'i shfrytëzuar vetëm 2-3 javë në vit.

Siç është i dëshpëruar populli në Republikën e Kosovës, e shkaqet mirëfilli dihen, edhe më shumë është i dëshpëruar emigracioni. Le të shpresojmë që qeveria e tanishme e Republikës së Kosovës, që kryesohet nga ish-emigranti Hashim Thaçi, do të përkushtohet për t'ua kthyer vullnetin emigrantëve. Një gjest domethënës e ka bërë kryeministri Thaçi, duke emëruar emigrantë si këshilltarë për çështje të emigracionit e të diasporës. Sa mirë do të ishte që strukturat komunale të organizonin ndonjë mbrëmje rinore për rininë e emigracionit, ose ndonjë piknik, që t'ua bëjnë atyre më joshës vendlindjen e prindërve të tyre. Ndoshta, në të ardhmen e afërt, qeveria do të mund të ndajë mjete për të ndërtuar qendra pushimi e rekreacioni në bjeshkët e bukura të Kosovës për rininë tonë, brenda dhe jashtë shtetit, që atyre t'ua joshim më shumë Kosovën, që të njihen me njëri-tjetrin, të shoqërohen e të miqësohen.

Bota investon për të joshur turistë, kurse Kosovës nuk i shkon ndërmend për të joshur emigrantët e saj, qoftë edhe vetëm si turistë.

Në fund të fundit, se mos është më mirë që vetë emigrantët të organizohen për të ndërtuar në Kosovë qendra të vetat rekreacioni, për të organizuar lobingje për të mbrojtur interesat e tyre, duke gëzuar hisen e shtetit të Kosovës që u takon, pasi që për çlirimin e saj sakrifikuan shumë.

Në vend të mbylljes: Katarsis - "pastrimi i shpirtit"

Vërtet, duam apo nuk duam të bëjmë shtet të mirëfilltë? - kjo është pyetja. Në dukje sikur duam, por dukja nuk mjafton. Me rëndësi është përmbajtja, është përcaktimi i njëmendtë i secilit, gjegjësisht i të gjithëve. Tashmë mund të shihet e preket se në infrastrukturë rrugore e në arsim kemi suksese të mëdha. Kjo ndodh sepse do Qeveria dhe sidomos ministrat përkatës janë të përkushtuara. Le të shpresojmë se këto zhvillime të hovëzuar nuk përmbajnë ndonjë krimb brenda tyre. Do të ishte *gjynah* dhe e kobshme të lëshojmë shanset kaq të favorshëm, vetëm se disa pushtetarë kanë babëzi për pasurim të shpejtë, të pandershëm dhe marramendës, vetëm pse disa pushtetarë kanë babëzi për t'u bërë pashallarë të Kosovës. Secili mbase di se çfarë është e ndershme, çfarë përgjegjësie kemi dhe si duhet t'i dalim zot Kosovës. Nuk mjafton vetëm të duam, por të vendosim që të bëhemi qytetarë e shtetas të përgjegjshëm dhe këtë ta praktikojmë çdo ditë.

Nuk kemi dëshiruar që ta çlirojmë Kosovën vetëm pse kemi pasur shtytje romantike kombëtare, vetëm për shkak të "rendit të gjërave". Nuk jemi angazhuar për ta çliruar Kosovën pse e ëndërronim çlirimin dhe lirinë, por këto i kishim synim të hershëm, kushedi që sa shekuj. Nuk jemi angazhuar për ta çliruar Kosovën vetëm sa për ta çliruar, më në fund, nga pushtim

Kishim nevojë për përkrahje të miqve ndërkombëtarë dhe ishte njerëzore që t'i lusnim për përkrahje. Por tani nuk është e dinjitetshme që të presim pa fund që miqtë ndërkombëtarë të na ndihmojnë në ndërtimin e zhvillimin e shtetit tonë. Jo vetëm që nuk është e dinjitetshme, por mund të ndodh që kjo gatishmëri e tyre shpejt mund të konsumohet dhe ata mund të zhgënjehen nga mosdëshira dhe mosangazhimi ynë i njëmendtë për të ndërtuar shtetin tonë. Kam pasur rast të dëgjoj drejtpërsëdrejti opinionet e taksapaguesve të BE-së. Atyre po u zvogëlohet gatishmëria që të vazhdojnë të sakrifikojnë për shtet-bërjen e shtet-ndërtimin e shtetit

tonë, e lëre më që të sakrifikojnë edhe për zhvillimin tonë ekonomik e demokratik, siç ia hapëm sytë padenjësisht konferencës se donatorëve.

Shumë tematika kam lënë pa i trajtuar, me mendim se gjatë debatit do të plotësohen. Kurse këto që kam trajtuar e propozuar nuk më duket se janë iluzioniste, utopiste e futuriste. Gjithsesi, mendoj, janë të realizueshme, vetëm po të duam, secili sinqerisht e njëmendësisht. Jam kurioz dhe mirëpres ndonjë arsyetim e argumentim, se përse nuk mund të realizohen këto që kam propozuar, nëse ne, sinqerisht, njëmendësisht, vendosmërisht, **duam**.

Ndonjërit mund t'ia kem provokuar mërinë e zëtin e papërmbajtshëm kundër meje me vlerësimet kritike për të kaluarën, bazuar në kriteret e mia perceptuese dhe vlerësuese, por "u bëfsha shkja", siç më betohej ndonjëherë Babai, nëse i kam bërë i nxitur nga inati e urrejtja personale, por nga zemërplasja. Unë nuk urrej e nuk mbaj inat as ndaj atyre që gjithë jetën më kanë shpifur e më kanë akuzuar për vrasës, për përvetësues të ndihmave financiare të popullit, për shpërdorues të përgjegjësive që kisha, pasi dija se ishin viktimë të luftës speciale të pushtuesit dhe argatëve të tij mercenarë. Dhe që të jetë më e kuptueshme kjo filozofi imja, për ndokënd ndoshta naive, e kam të bazuar në analizat që u kam bërë angazhimeve të personaliteteve historike, që një pjesë të gjatë të jetës se tyre janë detyruar t'u shërbejnë pushtuesve, por në momente vendimtare janë vënë në shërbimit të popullit të vet, duke siguruar respekt të madh nga populli, brez pas brezi. Unë nuk i urrej as keqbërësit e përjetshëm, pasi, në fund të fundit, gjykoj se ata nuk kanë qenë "prodhues" autentikë të vetes së tyre, por "produkt" i rrethanave që imponon pushtimi shekullor, "produkt" i destruktivitetit biologjik, pasi të tillët nuk kanë aftësi për ta komanduar arsyeshëm e për ta kontrolluar veten e tyre. Nuk i gjykoj as ata keqbërës që ishin "produkt" i shantazheve e i mashtrimeve të pushtuesit që i cyti t'i shkaktojnë shumë të këqija popullit tonë, etj., etj. Sa herë jam bërë pishman pse kam urryer ndonjë UDB-ash, ose oficerë e politikanë që shumë gjatë i kanë shërbyer Beogradit pushtues, por kur populli përfundimisht vendosi dhe u angazhua për t'u çliruar nga Serbia pushtuese, ata kaluan me tërë

qenien e tyre në anën e popullit. Eh, sa shumë shqiptarë do të duhej të urreja për shërbimet që ua kanë bërë pushtuesve (deri edhe Gjergj Kastriotin, Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën etj.), po të ashpërsoja kriteret, siç duket normale dhe e logjikshme. Mbase pak do tepronin për t'i respektuar e admiruar.

Pres me shpresë dhe i gëzohem kësaj pritjeje, se mund të vijë momenti që edhe shqiptari i "keq" të bëhet qoftë edhe vetëm një ditë shqiptar i mirë dhe me kaq unë ndjehem i mjaftuar.

Po të ashpërsoja meritueshëm kriteret, atëherë e sot do të më duhej të urreja Amerikën, Francën, Anglinë, Gjermaninë etj., për formimin e mbretërisë serbo-kroato-sllovene (1919), për ndihmën e madhe që i dhanë RSFJ-së gjatë viteve 1948-1990 që të bëhet superfuqi ushtarake dhe politike, që të bëhet në gjendje të mbajë të pushtuar dhe të terrorizojë popullin tonë; që t'i urrej për përkrahjen që i dhanë Serbisë pushtuese gjatë viteve 1991-1998 për ta mbajtur Kosovën dhe popullin tonë të pushtuar, duke bërë ndaj tij krime makabër; që t'i urrej për përndjekjet që kam përjetuar në disa prej këtyre shteteve gjatë viteve 1978-2000, vetëm pse isha i angazhuar politikisht kundër Jugosllavisë e Serbisë pushtuese. E shihni, pra, pikërisht këto dhe shtete të tjera, në momentin më kritik, kaluan në anën e popullit tonë, për ta shpëtuar nga zhdukja fizike, dhe pikërisht këto dhe shtete të tjera përkrahën Kosovën që të bëhet shtet, dhe pikërisht këto dhe shtete të tjera, të bashkuara në NATO, po e mbrojnë Republikën e Kosovës nga rrezikimi pushtues serb, dhe pikërisht këto dhe shtete të tjera tani po angazhohen që ta ndërtojmë bashkarisht shtetin tonë. Sa mirë që kam duruar për të mos i urryer atëherë, sepse do të isha penduar shumë rëndë tani.

Po të ashpërsoja meritueshëm kriteret, siç do të dukej e logjikshme, më në fund, do të më duhej të urreja edhe vetën time për disa mendime e angazhime të gabueshme politike dhe jopolitike, të bëra, i shtyrë nga bindja dhe shtytja e brendshme se ishin mendime e angazhime të mira; po kështu do të më duhej të urreja edhe bashkëveprimtarët e mi për disa gabime të paqëllimshme e të qëllimshme.

Prandaj i kam "relaksuar" kriteret dhe vërtet kam kritere shumë të

shtrënguara që të marr vendim për të urryer njerëz.

Sa shumë po shpresoj se tani do të ndërgjegjësohen shumë bashkështetas, njerëzisht, qytetarisht e shqiptarisht, që ta bëjmë e ta ndërtojmë Republikën e Kosovës, sa më të mirë që të jetë e mundur, që ta përshpejtojmë zhvillimin ekonomik, demokratik e social.

Sa shumë po shpresoj, se tani do të ndërgjegjësohen shumë bashkështe-tas, që të zvogëlojnë mërinë e urrejtjen ndaj njëri-tjetrit, që të zvogëlojnë kriminalitetin, për të mos mbytur të rinjtë shqiptarë e botërorë me droga për përfitime personale kriminale, që të zvogëlojnë mërinë, urrejtjen e ndjenjën e hakmarrjes kundër bashkështetasve serbë dhe të tjerë minoritarë, dikur keqsjellës e keqbërës ndaj popullit tonë, sepse nuk ishin të ndërgjegjësueshëm njerëzisht, sepse shpërdoroheshin nga shpërdoruesit nacionalistë serbë, sepse ishin fatkëqij.

Sa shumë po shpresoj se tani do të ndërgjegjësohen shumë bashkështetas, që në vend të shpenzimeve për prostitucion, për blerje të panevojshme të automobilave luksoz, për ndërtim e blerje të vilave, panevojshëm të mëdha, do të investojnë në shtet-bërje, shtet-ndërtim e në zhvillim të përshpejtuar ekonomik të shtetit tonë, njëherit edhe për të mos lënë të vuajnë nga uria bashkështetas tanë, që mund të vuajnë urie jo për faj të tyre, jo për përtaci të tyre, jo për kulturë parazite të tyre.

Sa shumë po shpresoj se tani do të ndërgjegjësohen shumë bashkështetas, për të mos përvetësuar pandershëm pasurinë shtetërore, të shtyrë nga babëzia krimogjene për të vënë pasuri për "shtatë breza" pasardhës të tyre.

Sa shumë po shpresoj se tani do të ndërgjegjësohen shumë bashkështetas biznesmenë, që të kenë edhe ndërgjegje sociale për të **mos** trajtuar si skllevër të punësuarit në firmat e tyre, që të kenë ndërgjegje edhe sociale për t'i paguar meritueshëm e njerëzishëm për punën që bëjnë.

Më në fund, sa shumë po shpresoj se tani do të ndërgjegjësohet klasa jonë politike, pushtetarët, kryepartiakët, njerëzisht, qytetarisht e shqiptarisht, që të bëjnë më të mirën e mundshme për shtet-bërjen e

shtet-ndërtimin e shtetit tonë, që të bëjnë më të mirën e mundshme për zhvillimin e përshpejtuar ekonomik, demokratik e social.

I turpëruar do të jetë për jetë të jetëve secili që është i vetëdijshëm të gjykojë çka është njerëzore, qytetare e shqiptare, që është i vetëdijshëm të gjykojë çka është në interes të shtet-bërjes, shtet-ndërtimit, të zhvillimit ekonomik, demokratik e social, por qëllimisht dhe për të shuar babëzinë e tij krimogjene vazhdon të sillet e të veprojë prapë "shtazërisht", si keqbërës pervers, për interesa primitive personale!

* * *

Uroj të mirëkuptohem edhe kur nuk ia kam qëlluar, uroj të falem kur kam qortuar me tepri ndokënd ose pavetëdijshëm kam ofenduar ndokënd, uroj të përkrahen propozimet, nëse e meritoj përkrahjen; uroj të kundërshtohem arsyeshëm e paarsyeshëm dhe të kundërvihem me propozime më shumë e më pak të arsyeshme; uroj që lexuesi të ketë kohë e interesim për të debatuar e për të bashkëbiseduar me mua me dashamirësi e me kundërshti, për mendimet e paraqitura këtu.

Me këdo e në çdo kohë mirëpres debatin e bashkëbisedimin.

Mirëpres vlerësimet, përkrahjet, vërejtjet, sugjerimet, kundërshtimet.

Adresa elektronike: **ibrahim_kelmendi@yahoo.de**
dhe në numrin e telefonit +377 44 151959.

Prishtinë, shtator-tetor 2008

Recensione dhe vlerësime

Anatomi e një gjendjeje që pret rrugëdalje

Prof. dr. Shaban Sinani (Tiranë)

Autori i këtij libri, I. Kelmendi, është një emër i njohur për botën shqiptare, dikur si veprimtar i vjetër i lëvizjes klandestine dhe më pas edhe si njeri i letrave.

Përveç librit "Shqipëria - jashtë "Veriut" dhe "Jugut"", kushtuar ngjarjeve të mistershme të vitit 1997, gjatë zhvillimit të cilave I. Kelmendi nuk mund të mos ndodhej, siç ngjet së shumti me "kryengritësit e përjetshëm" të tipit të Che Guevara-s; dhe librit letrar-jetëshkrimor "Atentatet" kushtuar fillimeve të vështira e të rrezikshme të lëvizjes së organizuar politike në mërgim për zgjidhjen e "gjysmës tjetër" të çështjes kombëtare, kam pasur rast të lexoj dhe një tjetër libër të tij, ende të pabotuar, me përjetime të protagonistëve të mërgatës së hershme e të re shqiptare, nga shteti i vjetër dhe nga Kosova, për të cilin pata menduar se ishte ende shpejt të dilte në publik.

I. Kelmendi shkruan libra të vështirë. Libri "Sfidat e radhës" është një vijim tipologjik i punëve të tjera të tij në fushë të letrave. Njësoj si në tre librat e mëparshëm, ai i paraqitet lexuesit si një dëshmitar i ngjarjeve të jetuara, ku ai ka qenë vetë i pranishëm. Njësoj si në tre librat e mëparshëm, autori ia lejon vetes padisiplinën, "shkeljen e kufirit", deri tek pragu i anarkizmit. Njësoj si në tre librat e mëparshëm, ai nuk mjaftohet me pohimin e të vërtetave të lehta dhe i jep kurajë vetes të shkojë përtej rrethit të të njohurave të rëndomta dhe të shqiptojë lirisht mendjen e tij se si është realiteti i sotëm. Njësoj si në tre librat e mëparshëm, ai është edhe vetë subjekt i lëndës që shkruan, pjesë e trazimeve që nuk i ndahen, njeri gjithnjë i shqetësuar e në kërkim të ndreqjes së kohës.

Me librin "Sfidat e radhës", ndryshe prej shkrimeve të mëhershme,

I. Kelmendi për herë të parë vjen të shkruajë për gjendjen e Kosovës në ditët tona. Pas ndërhyrjes së ushtrive aleate në ish-Jugosllavinë e mbetur dhe kurorëzimit të fitores së lëvizjes çlirimtare në Kosovë (1999), kur grupimet politike të vendit zunë të organizoheshin, grupoheshin e rigrupoheshin në funksion të marrjes dhe ndërtimit të pushtetit, u duk se "revolucionari profesionist" I. Kelmendi e kishte gjetur veten "të tepërt" në jetën paqësore dhe tashmë e kishte marrë vendimin: thjesht ta kundronte atë që po ndodhte në vendlindjen e vet, me bindjen se, së paku, kthim prapa nuk do të mund të kishte dhe "një ditë do të bëhej më mirë". Një eko-distancë e pabesueshme ndaj të gjithë faktorëve politikë që po vepronin në Kosovë; një tërheqje gjithaq e çuditshme nga jeta publike; një heshtje që herë-herë të bënte "të pëllcisje si gjinkallë", sikurse shprehet një poet; më bënin t'ia mbivendosja gati pavetëdijshëm portretin e tij atij luftëtarit fanolist nga Kolonja, që pati shkruar me germa të mëdha në faqen ballore të murit të shtëpisë së vet: "Shqipëria u bë, por jo ashtu si e desha unë!".

Njerëzit e veprimit, midis të cilëve prej aq vitesh si shumë të tjerë e kisha renditur krejt vetvetiu edhe I. Kelmendin, zakonisht janë të heshtur. Ata heshtin edhe nëse i pyet. Disa herë prej modestisë, disa herë prej të vërtetave të frikshme që dinë, disa herë edhe për të ruajtur largësinë me të tjerët, që ua jep nami e lavdia. Ata ndërlidhin të shkuarën me të sotmen, mirëpo, kur kohët ndryshojnë, sidomos kur ka ndryshime thelbësore, si kalimi nga robëria në çlirim, nga lufta në paqe, e kaluara për disa nuk është aq e dëshiruar dhe po aq të padëshiruar janë dhe dëshmitarët e saj. Modestisht mundem disi ta pohoj dhe unë një fakt të tillë të hidhur. Midis galerisë së madhe të veprimtarëve ilegalë për çlirimin e Kosovës më janë paraqitur, pas lufte, edhe disa të tillë, që më dukej sikur do të kishin dashur ta harronin krejt atë kohë.

I. Kelmendi erdhi në fushë të letrave drejt e nga bota e konspiracionit, siç ishte gjithë lëvizja ilegale shqiptare në mërgim, por ca më shumë Lëvizja për Çlirimin e Kosovës. Si një prej figurave më të hershme të kësaj lëvizjeje, herë pas here shkruante dhe botonte në "Zërin e Kosovës", por përherë me një vështrim së jashtmi të gjithçkaje që

ndodhte brenda organizatës, të cilën ndoshta pikërisht disiplina dhe sekreti mundën ta ruajnë ashtu si arriti të jetojë e mbijetojë në kushte shumë të vështira deri në përmbylljen e misionit të saj themelor. Kur Kosova u hap dhe njerëzia u çlirua nga hija e makinerisë së mbikëqyrjes tërësore serbe, siç ndodh rëndom me luftëtarët ilegalë, edhe për I. Kelmendin pati përfolje e ndoshta ka pasur dhe presione për të mbetur tek roli i mëparshëm, pa veprim e pa fjalë, sepse koha e aksioneve shkoi dhe "hapja e gojëve" mund të mos ishte e pëlqyeshme. Por ai, ndryshe prej "kryengritësve për profesion", la njërën armë dhe mori tjetrën, la organizimin ilegal dhe iu kthye jetës publike, duke dëshmuar se njeriu, me të vërtetat e tij, mund të ndihmojë shumë që shoqëria të kuptojë vetveten, të shkuarën, të njohurat e të panjohurat.

Edhe libri "Sfidat e radhës" i tillë është. Kryemëvete dhe ai siç janë shqiptarët tradicionalë në përgjithësi; i pashtruar ndaj rregullave të reja të kohës paqësore derisa në mendje kishte përfytyruar diçka tjetër, më të rëndësishme; me formim e vetëformim europeist për të mos u ndërhyrë të tjerëve, "të angazhuarve", pa i lindur një përgjegjësi qytetare; I. Kelmendi priti gjatë dhe tani del para lexuesit për të paraqitur anatominë e tij të gjendjes në Kosovën e sotme, të asaj gjendjeje që zakonisht dhe jo pa arsye është nënçmuar, domethënë të gjendjes së brendshme, e cila, të paktën për një farë afati, edhe mund të mbetej dytësore, sa kohë që nuk kishin marrë përgjigje pyetjet më ekzistenciale të jetës së vendit, midis të cilave më e rëndësishmja ishte dhe mbetet: "Çfarë do të jetë Kosova në mjedisin ndërkombëtar të bashkësisë së popujve dhe shteteve?".

Kosova u bë një çështje europiane qysh në vitin 1999. Pastaj duhej të bëhej çështje e bashkësisë ndërkombëtare tërësisht. Ishte i kuptueshëm entuziazmi i kohës, edhe vetëkënaqja me dëbimin e ushtrisë serbe nga territori i Kosovës. Ishte i kuptueshëm gjithashtu kthimi i njerëzve tek hallet e tyre: gjetja e të humburve dhe të zhdukurve, kryerja e nderimeve të fundme ndaj tyre, ringritja e shtëpive, ardhja në normalitet. Të gjitha këto I. Kelmendi gjithashtu i mirëkupton në librin e tij të fundmë. Mirëpo, i provokuar nga shthurja e befasishme në këtë proces e vlerave

të mëparshme, e solidaritetit dhe e vetëdijes kolektive; por jo pa dhe një provokacion të brendshëm të vetë autorit, pa të cilin ndoshta nuk do të mund të kuptoheshin shumë prej shkrimeve të tij, me librin "Sfidat e radhës" I. Kelmendi nuk trembet për ta prishur qetësinë, për të rrezikuar rishtas status quo-në, për të tronditur ata të paktë që kanë fuqi të tronditen, për të shtruar çështjen tejet të vështirë, që rruga e mundimshme prej pushtetit (qeverisjes) drejt shtetit (barazisë me subjektet e botës së sotme) nuk është një çështje e vulosur me tapi, madje nuk është më as një çështje europiane apo euroatlantike, por më së shumti një çështje e brendshme e vetë popullit të Kosovës, e cila, tani e tutje, pasi ka marrë votat e solidaritetit, çdo votë të re duhet ta meritojë fort, duke dëshmuar para syve të botës se arrin t'i ushtrojë prerogativat e shtetësisë, se di të lundrojë në detet e rrezikshëm të pragmatizmit e të lobingut, se di të zgjedhë partnerë duke neutralizuar argumentet emocionalë kundër saj. Autori bën pjesë në atë rreth të ngushtë të pakënaqurish që nuk mund të gënjehen lehtë duke shtuar një herë në muaj një votë plus në listën e shteteve që e kanë njohur Kosovën, sepse peshojnë shumë "votat në grup": mbi 50 vende islamike që nuk munden ta kapërcejnë antiamerikanizmin e tyre për dashamirësi ndaj shqiptarëve; dhjetëra shtete gjysmë-sovjetike gjysmë-jugosllave që i bashkon në votën kundër lidhja gjenetike me Serbinë dhe po ashtu dhjetëra shtete të tjera, tek të cilat ende është në veprim kulti i simpatisë për ish-Jugosllavinë-lider të vendeve të "botës së të paangazhuarve".

I. Kelmendi, në librin e tij "Sfidat e radhës", u shërbehet lexuesve me një realizëm të ashpër, por jo të rreptësuar kot së koti. Ai sheh se ka një kushtëzim gjithnjë e më të fortë midis dukurive kompromettuese të sistemit që funksionon në Kosovë, të sistemit të qeverisjes, të sistemit të ndorimit të pasurive publike, të sistemit të dhënies dhe përfitimit të lëshimeve dhe indulgjencave, të sistemit të dhënies së meritave, të sistemit të ushtrimit të të drejtave, të sistemit të demokracisë qytetare dhe të sistemit të ndërtimit të së ardhmes, nga njëra anë, dhe njohjes ndërkombëtare të Kosovës si shtet. Ndryshe nga analistët e Shqipërisë shtetërore, të cilët, për shkak të një realiteti pak më ndryshe, të njëjtat

probleme i shtrojnë kryesisht si çështje të përsosjes së demokracisë dhe të forcimit të shtetit të së drejtës, I. Kelmendi me të drejtë trembet që korruptimi i një pjese të klasës qeverisëse në Kosovë mund të shpjerë deri tek korruptimi të paktën i përkohshëm i së drejtës për shtetësinë.

I mësuar nga jeta me gjithfarë situatash, për I. Kelmendin është shumë e qartë se shtetësia është diçka tjetër nga vetëqeverisja; se pavarësia e shpallur është diçka tjetër nga pavarësia e arritur; se 51 votat e njohjes së Kosovës si shtet nuk mjaftojnë për ta bërë atë shtet dhe nuk duhet të na bëjnë të ndihemi me shumë peshë politike ndërkombëtare, sepse ato janë më shumë zgjidhje të përbashkëta aleancash të rreshtuara; se rruga drejt shtetit vështirësohet edhe nga fakti se vendi gjendet nën një monitorim të gjithanshëm, ku edhe gabimi më i vogël kushton shumë. Pikërisht këtu vjen e shpëfaqet dhe nervozizmi i autorit, nervozizëm të cilit nuk i shpëtojnë as autoritetet publike, as institucionet e administratës, as mjekët e mësuesit, as fshatarët e fshatarkat, askush që tani mendon se është koha për të fituar në kurriz të situatës së mbarë, me e pa shtet, me e pa pavarësi, me e pa kontroll, me e pa përgjegjësi. Dhe ky është nervozizmi i një kryengritësi të pabindur, që, megjithatë, kur ka qenë rasti dhe koha e durimit, ka ditur edhe të bindet, por tani i duhet vënë mirë veshi, sepse dita që kalon e bën më të vonët reagimin.

Diagnostikimi që I. Kelmendi i bën gjendjes së Kosovës sot është tejet kritik. Kosova, në librin e tij, ngjan si një qenie që e ka zgjedhur rrugën, por për fat të keq nuk mund të bëjë rrugë të gjatë, sepse sëmundjet dhe dobësitë i janë ngatërruar nëpër këmbë, prandaj urgjente është të vetëshërohet, dhe të mos ndjekë shembullin e keq të Shqipërisë, sepse, tek e fundit, Shqipërisë nuk i anulohet e drejta e shtetësisë tani që po mbush 100-vjetëshin e vet, kurse Kosovës, në mos tjetër, mund t'ia vonojnë. Të gjitha të këqijat që janë pjesë e situatës së përshkruar nga I. Kelmendi në këtë libër në Kosovë e kanë efektin dyfish më të keq se në Shqipëri, ku e papritura më e madhe mund të jetë paqendrueshmëria e një qeverie apo zgjatja e tranzicionit, edhe kaq të tejzgjatur.

Mënyra si e përfytyron I. Kelmendi daljen nga krizat, duke iu drejtuar anatomikisht burimeve të brendshme të Kosovës, burime

që mundësojnë pasurimin individual dhe kolektiv të popullit e të qeverisësve, nëse ndorohen me strategji shkencërisht të përpunuara, si rruga më e efektshme për të ndaluar korrupsionin, mund të ngjajë si recidiv i mendësisë së dikurshme për mbështetjen në forcat e brendshme. Kjo mund të ndodhë vetëm në pamje të parë. Në të vërtetë I. Kelmendi e ka kaluar provën e ndonjë nostalgjie të mundshme me kohë. Ai nuk propozon ndonjë zgjidhje parimore, përjashtuese ndaj asistencës financiare të botës, por thjesht argumenton se Kosova ka mundësi të jetë një shtet që mban vetveten ekonomikisht, që mund të bëjë dhe pa salltanete sa kohë që aleanca atlantike është e instaluar aty, se shteti i Kosovës bëhet në Kosovë dhe vetëm njohja e tij do të ndodhë jashtë, pasi të jenë hequr të gjitha dyshimet, paragjykimet, mosnjohjet, keqkuptimet, nënçmimet. Autori, duke ndjekur parimin se të vërtetën e ndarë përgjysmë mund ta kthesh në një atentat kundër vetes, sepse gjysma tjetër veçse komploton kundër teje, ka zgjedhur më mirë të jetë deri-diku njëfarë kaçaku modern, duke qenë i bindur, por jo i lëkundur, që libri i tij mund të pritet edhe me refuzim prej njdonjë kategorie lexuesish, drejpërdrejt apo indirekt të cënuar.

Rruga drejt një shteti, në të cilën gjendet Kosova, nënkupton dhe rrugën drejt një historie, në kuptimin teknokratik të kësaj fjale, të një historie që shkruhet për shkollat e mësohet nga breznitë e reja. "Kosovo - a shurt history" e N. Malcolm plotëson një boshllëk. Por historia e Kosovës është ende vetëm në start. Shumë burime nuk gjenden më në arkivat e Prishtinës, sepse janë grabitur bashkë me pasuri të tjera. Një arbitrim ndërkombëtar i kësaj çështjeje, siç kanë bërë kroatët e sllovenët pas secesionit nga ish-Jugosllavia, duket i largët. Në rrethana të tilla, burimet që ofrojnë objektivisht protagonistët e kësaj historie, sidomos të pjesës së saj ilegale, marrin një vlerë të cilën nuk mund ta çmojmë thjesht nga bukuria e frazës apo qartësia e gjuhës, të cilat, meqë ra fjala, I. Kelmendi i shpërfaq me një shije gjuhësore shqiptare të vetvetishme, që përmban nderim për njësimin, edhe pse sot teknokratë dhe njerëz të letrave këtë duan ta quajnë thjesht "standardizim".

Qasje tjetërqysh ndaj politikës në Kosovë, ose ndesha e mirë librit "Sfidat e radhës"

Prof. Dr. Martin Berishaj (Lublanë, tetor 2008)

Publicisti I. Kelmendi në librin e tij më të ri "Sfidat e radhës", pa kompleks e fut Kosovën në gërhanë politike, duke ju rrëfyer në gjunjë, qytetarit politik shqiptarë, si besimtar i mirë, e njëkohësisht duke bërë me gisht kudo që ngec në ecatje elita politike kosovare.

Duke zbardhë proceset politike në Kosovë gjatë dhjetëvjetorit të kaluar, autori lehtësisht zhvesh konceptin e elitës politike deri ne palcë, me qëllim që të komunikohet me lehtë me të, jo nga pozita e nënshtrimit, por duke e edukuar fillimisht atë elitë, e po ashtu në të njëjtën kohë edhe qytetarin politik - shqiptarë. Qytetarit politik ia mëson hapat e parë të ecjes nëpër "teh të shtetit" shpesh duke e qortuar atë lidhur me atë se si duhet qas shtetberjes kosovare.

Në letra shqipe I. Kelmendi është i papërsëritshëm, edhe atëherë kur oponentët e tij politik janë të bindur dhe bindin të tjerët se atij i "ka kalua koha", ai shfaqet me ide të reja që imponojnë. Shpesh herë me guxim që kërcënon. Ai nuk i frikësohet shtetit dhe as "burrështetasve" që e prezantojnë politikisht atë shtet për gabim që bëjnë dhe që lënë pasoja për shtetas… Ai din të respektojë, por nuk e njeh dhe as nuk e pranon konceptin e paprekshmërisë së politikanëve.

Edhe kësaj radhe ai "hiç pa rrotulla" prek, nguc, por nuk është ngucakeq. Ai bën me gisht në belbëzime të politikanëve dhe elitës politike, por vetë nuk belbëzon, ai është serioz sepse

të tillë e përjeton situatën në të cilën gjendet Kosova. Ai shpalon idenë se nuk ka shtete të mëdha apo të vogla, shtete të reja apo të vjetra, por ka vetëm shtete që janë si subjekt i drejtës ndërkombëtare, të cilat kanë ligj dhe respektojnë ligjin, por njëkohësisht ka edhe shpërfytyrime organizative që e quajnë vetin shtet duke aluduar në Kosovë.

I. Kelmendi assesi nuk ka për qëllim, t'i qesin lexuesit "vetën nga qejfi", por, përkundrazi t'i shtojë atij vetëbesimin e duhur jo më si lexues, por si individ politik që në mënyrë sa më sovrane të kacafytet me devijime që bëjnë politikanët në emër të shtetit. Autori i mundëson lexuesit gjatë studimit të këtij eseu politik, kapërcimin virtual në individ politik - shtetas, me ç'rast e aftëson atë të përballet me gradualitet të zhgoglitjes së komunikimit me institucione shtetërore, në mënyrë tejet jokonvencionale (për rrafshin kosovarë), do të thosha në mënyrë kelmendjane, nga poshtë - lartë, duke e shtrua atë komunikim në nivel horizontal.

Këtu fillon emancipimi politik, jo më kolektiv kombëtarë, por individual, ku shtetasi nga afër "prek" një elitë tërësisht të papërgatitur për dimensionin kohë. Për ti "përkëdhel" pushtetarët, e njëkohësisht për ta shndërrua komunikimin "pa teklif" në nivel sa më të relaksuar, Kelmendi tak tuk, kësaj elite i qaset nga një aspekt krejtësisht njerëzorë, ai i aspektit të "ish emigranteve". Mirëpo, duke mos lejuar në asnjë moment që të bastardohet shteti dhe komunikim të behet shterpë, autori me mjeshtri të rrallë e kapërcen nivelin e kohës së tejshkuar (kur kjo elitë politike që është sot në pushtet, bënte politikë nga rrafshi politik i "ish emigrantëve") dhe i qaset funksionalizmit klasik, tendencës së daljes nga kjo situatë.

Strukturës së të menduarit funksional politik të autorit lidhur me shtet-bërjen, deshëm s'deshëm i paraprinë pragmatizmi i tij, që nganjëherë, krejt natyrshëm, duke

mos bartë në mënyrë mekanike modelet politike (sikurse e bënë pa asnjë filtrim elita politike kosovare), nuk heziton, por këshillon (edhe pa i kërkua kush këshill!) duke dhënë rrugëdalje aty dhe në ato çështje ku krejt elita politike është ngathë dhe vendnumëron.

Autori i vetëdijshëm se në praktikën politike kosovare ka vend të bollshëm për absorbim tjetërqysh për qasje të shtetbërjes, tenton që sa më mirë të përgatis lexuesin, duke e shty atë ti qaset, një herë vetës e pastaj edhe shtetit me formë të dekalogut politik, fillimisht duke i imponuar mësimin e pastaj duke e ligjëruar: se **"…. Kosova është Zoti yt, tjetër Zot mos të kesh dhe mos të adhurosh përpos sajë...!"**

Këtu plas sherri sepse siç cek autori, "... bashkështetasit tanë serbë për momentin janë penguesit kryesorë të shtetberjes dhe të shtet-ndërtimit të Republikës së Kosovës ." Këtu hapen dy çështje?

E para: Shtrohet pyetja:

• a e pranon bashkështetasi serbë bashkështetasin shqiptarë si bashkështetas? dhe nëse po, atëherë nuk na qenka pengues kryesorë të shtet-bërjes serbet por elita politike e Kosovës! dhe • nëse nuk e pranon asnjëra palë tjetrën si "bashkë"shtetas, atëherë, elita politike kosovare e me të Kosova si subjekt ndërkombëtarë, nuk ka formuar kushte as formale e as juridike (për deri sa nuk ka rezultat *de iure* të pranimit në rrafsh individual, qytetarë-shtetas, e në rend të dytë prapashtesës shqiptarë -serb) për të kapërcyer pragun e absorbimit të asaj me të cilën mburret elita politike - Kosova si shtet multinacional dhe multikultural.

Edyta:

• shtetasit e Kosovës (për këtë debat: serbë dhe shqiptarë) lajthiten nga po kjo elitë e cila për të ikur nga përgjegjësia e

vetë, bënë gisht në ta dhe i ngarkon me faj se janë penguesit kryesor të shtet-bërjes dhe të shtet-ndërtimit!

• Vetëdijesimi i shqiptarëve, se me serbë janë të barabartë para ligjit dhe u nënshtrohen atyre pa përjashtim, është po aq rrugë e mundimshme, sa që është pranimi individual - si individ politik e pastaj si shtetas; një herë i individit- shtetasit shqiptarë nga ana e individit - shtetasit serbë të Kosovës; e pastaj të shtetit të Kosovës.

• Si njëra palë po ashtu edhe tjetra, qenien e vetë politike e shohin brenda kornizës së lëvizjes së bllokuar e që u është mohuar e drejta e konceptimit të subjektivitetit kolektiv si formacion fiks -nacional -, për ta përvetësuar pozitën e "shtetasit faktik" të Kosovës.

Vlerësim mbi librin "Sfidat e radhës"

Valbona Myteveli M.A. (Gjermani)

"Sfidat e radhës", i autorit Ibrahim Kelmendi, është një libër shumë informativ për mbarë kombin shqiptar, i cili prek problemet reale, të dukshme e të padukshme, politike, shoqërore dhe ekonomike të shtetit të dytë shqiptar në Ballkan, Kosovës. Libri "Sfidat e radhës" të përball më një realitet të brendshëm të vështirë, por të ndryshueshëm në Kosovë.

"Sfidat e radhës" është një libër që prek gjithë shtresat e popullsisë, punëtorë e intelektualë, qeveritarë e qytetarë e fshatarë. Ne duhet të interesohemi për ndërtimin e shtetit tonë, thotë Kelmendi, *"siç interesohet* njeriu *për të krijuar familje dhe për të ndërtuar shtëpi të tij*." Në këtë mënyrë ai e ngre shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin në një nga çështjet më elementare, primare dhe të dëshirueshme për popullin e Kosovës.

I. Kelmendi me anë të librit të tij kërkon të rrisë moralin dhe vetëdijen e popullsisë së Kosovës. "*Synimi ynë i përgjithshëm, se* sa, kur *dhe* si *mund ta bëjmë shtetin tonë sa më të pavarur dhe sa më sovran, na bën që të jemi më konstruktiv, më optimistë, më të përmbajtur dhe më pak euforikë. Prandaj duhet të* vetëdijesohemi*, sa më shumë që të jetë e mundur, për përgjegjësitë tona konstruktive në kohë dhe hapësirë."* - shkruan I. Kelmendi në libër.

Bashkëjetesa midis shqiptarëve dhe serbëve, përkatësisht marrëdhënia midis shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë, zë një vend kyç në këtë punim. Pse? Sepse kjo çështje kushtëzon dhe vështirëson ardhmërinë e Kosovës, por ajo nuk do arrijë të bëjë të pamundur rrugëtimin e Kosovës drejt pavarësisë së plotë dhe demokratizimit të vendit. Ç'zgjidhje ofron Kelmendi mbi bashkëjetesën midis shtetasve serbë e shqiptarë? *"Bashkështetasit tanë serbë duhet t'i përkrahim e*

t'i ndihmojmë që të kthehen në tokat, shtëpitë e banesat e tyre, duke u premtuar fqinjësi njerëzore dhe duke u garantuar së do mirëpriten e trajtohen si bashkëqytetarë të barabartë. ë...ç Serbët ekstremistë duhet t'i lirojmë nga detyrimi që të jetojnë në Republikën e Kosovës, nëse bashkëjetesën nuk e dëshirojnë." parashtron ai.

Por përballja e Kosovës me Serbinë nuk kufizohet vetëm në mosnjohjen e Kosovës nga ana e Serbisë, as vetëm me vështirësitë që Serbia i sjell Kosovës në veri të saj, tema të cilat mund të lexohen çdo ditë në gazetat elektronike. I. Kelmendi ngre në këtë libër si problem ndërhyrjen ekonomike të Serbisë, cila fatkeqësisht, direkt dhe indirekt, mbështetet nga shqiptarë, të cilët ende nuk e kanë zgjeruar botëkuptimin e tyre mbi *pavarësinë* ekonomike të Kosovës, duke pasur parasysh "*vetëm interesat e tyre të ngushta e primitive"*. Kelmendi iu referohet ilaçeve dhe mallrave ushqimore, të importuara pa doganë e *tvsh* nga Serbia. Ai e cilëson këtë tregti si një veprim anti-shtetberës dhe anti-shtetndërtues. Por kuptohet, që në këtë tregti marrin pjesë dy palë: pala serbe, që ofron mallrat dhe pala shqiptare, që i fut në treg këto mallra. Dhe palën e dytë Kelmendi e dënon me të drejtë për mungesë vetëdije. - Vetëdija mungon edhe në rastin kur tokat lihen djerrë dhe blegtoria nuk funksion. Sepse, siç argumenton Kelmendi, përfitimi nga investimi në një depo-frigoriferi, parë edhe në interes shtetëror, është më frutdhënës, se hapja e një kafeneje apo benzinate.

I. Kelmendi nuk pajtohet me injorancën dhe mendjeshkurtësinë e individëve shqiptarë, që e bëjnë të mundur këtë tregti, sepse kjo është në dëm të shtet-njohjes ndërkombëtare të Kosovës.

Edhe krimi i organizuar në Kosovë nuk i shpëton analizës kritike të I. Kelmendit. Krimi i organizuar prek gjithë shoqërinë, shkruan Kelmendi, sepse *"secili pjesëtar i këtij krimi të organizuar është pjesëtar i një familjeje në Kosovë"* dhe prej tyre rrezikohet rinia e Kosovës dhe ajo në Perëndim. Prandaj ai shpall "Luftë frontale kundër krimit "tonë" të organizuar!" Kelmendi akuzon përhapjen e korrupsionit në të gjitha sferat e jetës, prej të cilit del "*i vjedhur vetëm populli"*. Pse dhe si duhet

luftuar korrupsioni: Sepse ai nuk dëmton vetëm demokratizimin dhe ecurinë e vendit, por ul edhe gatishmërinë e ndihmës për shtet-bërjen e shtet-ndërtimin e Kosovës. Lufta kundër tij duhet të nisë, sipas mendimit të Kelmendit, me ndërgjegjësimin e pasojave "*të këtij lloj kriminaliteti, kaq shumë të përhapur, kancerogjen e kompromettues"*.

Ç'u bë me shpirtin e sakrificës, solidaritetin, dhe guximin e popullit për mbrojtur dinjitetin kombëtar në vitet 1990-99të? Pse organizimi politik në ditët e sotme është i plogësht dhe drejtuesit e partive në vend "*vetëkënaqen me "vizita" të rralla, që i bëjnë anëtarësisë në bazë dhe ... fjalime "të flakta" politike e patriotike..."*? Pse nuk angazhohen intelektualët në jetën politike të Kosovës. Këto pyetje analizohen dhe sqarohen nga I. Kelmendi në librin "Sfidat e radhës". Kritika nuk mungon as për shoqërinë civile dhe OJQ-të e shumta. Regjistrimi i aq e kaq OJV-ve, rezulton Kelmendi, nuk është dëshmi e një shoqërie civile të zhvilluar, sepse ende ka shumë punë për t´u bërë në lidhje me mirëmbajtjen dhe pastrimin i ambientit, në të cilin jetojmë dhe punojmë.

Populli i Kosovës ju ka bërë ballë sfidave nga më të ndryshmet gjatë historisë së tij. Kësaj radhe populli i Kosovës duhet ti bëjë ballë sfidave, që ka sjellë procesi i shtet-ndërtimit. *"Sikur nuk jemi angazhuar si e sa duhet që kur Kosova u çlirua nga pushtimi serb",* rezulton nga analiza e I. Kelmendit mbi gjendjen politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë. Prandaj le të jetë ky libër, me gjithë sfidat që përshkruan e analizon, një shtysë për ndërgjegjësimin, organizimin dhe lindjen e një vetëdije të re në Kosove, e kudo në treva të banuara nga shqiptarë. Sepse problemet dhe sfidat e Kosovës nuk janë vetëm të Kosovës, por të mbarë kombit shqiptar!

Njeriu i sfidave që në fushën e ideve shtron "sfidat e kohës"

Bedri Islami *(Gjermani)*

E rëndësishmja tek libri i Kelmendit është e ardhmja e Kosovës. Ai e sheh mundësinë e zhvillimit dhe të ringritjes së ekonomisë, të mendimit politik dhe social të Kosovës, sjell fakte, argumente, shembuj, lakon rrugë nëpër të cilat kanë kaluar shtete të tjerë, thekson idenë se nëse gjithsecili prej nesh e pastron oborrin e tij, atëherë gjithë Kosova është e pastër, çka do të thotë se nëse secili mendon për Kosovën, zhvillimin e saj, për ndërtimin e shtetit; nëse gjithsecili e vendos sinqerisht një gur, atëherë mund të ndërtohet e ardhmja.

Përkitazi me librin "Sfidat e radhës" **të autorit** I. Kelmendi**.**

Që Ibrahim Kelmendit i pëlqejnë sfidat dhe të fton të debatosh rreth tyre, kjo është tashmë një gjë që dihet. Kjo është në natyrën e tij, ndoshta e gjithë jeta e tij politike ka kaluar përmes sfidash, herë pas here ata kanë qenë kaq afër njëra tjetrës, saqë ka qenë e pamundur të dallosh kufirin mes tyre. Tani vjen një ditë që Kelmendi shtron në fushën e ideve "Sfidat e Kohës", si pjesë e qenësishme e mënyrës së tij të të menduarit dhe të të konceptuarit të punëve, të gjërave, të së shkuarës dhe të asaj që do të vijë.

Mund të jesh ose të mos jesh dakord me të, mund të jesh i kënaqur ose jo, mund të gjesh shumë nga mendimet e tua nëpër rreshtat e "Sfidës" së

Kelmendit ose fare pak gjëra; mund ti rikthehesh atyre ose mund ti lësh krejtësisht mënjanë; por indiferent ndaj tyre nuk mund të jesh. Ose do të shfryhesh kundër tyre, dhe në këtë rast, nëse je kundërshtar i Kelmendit mund të thuash "po ky çfarë dreqin kërkon", mund të jesh mik i tij, dhe të gjesh në të pjesë të vyera edhe të mendimit tënd; ose mund të jesh i paanshëm dhe të kesh burrërinë të konfirmosh se, edhe kësaj radhe, Kelmendi, i befasishëm si gjithnjë, ka sjellë diçka që shumë njerëz nuk e kanë pritur.

Le të vihemi tek të parët dhe të themi se "çfarë dreqin kërkon" Kelmendi, pra pse nuk rri në punën e tij dhe në hallet e tij, në atë qoshe apo mes ku e ka vënë jeta?

Mund të thuhet kështu, mirëpo Kelmendi është nga ata njerëz që kurrë nuk ka qenë vetëm në "qoshen" e tij dhe kurrë nuk ka kërkuar mesin e artë. Ai, në të vërtetë, kurrë nuk e ka parë vetëm "punën e tij". Nuk e ka kërkuar këtë "qoshe" as në vitet e para kur u largua nga Kosova dhe u përfshi në sfidën e përpjekjeve për të rrëzuar dhe dëbuar pushtetin e dhunshëm serb në Kosovë, i cili, vetëm deri në vitin 1947 i kishte shkaktuar popullit shqiptar të atjeshëm më shumë se 86 mijë viktima. Pra thënë shkurt e saktë, kishte vrarë më shumë se 86 mijë shqiptarë. Kur e kishte nisur Kelmendi këtë SFIDË, ai kishte qenë ndër të paktët, ndër shumë të paktët, po ashtu do të ishe ndër të paktët nga ai grup të paktësh që do e vazhdonte, dhe edhe në më të paktët që do e çonte deri në fund. Kështu që pyetja se "çfarë dreqin kërkon", mund të bëhet për këdo tjetër, por si vështirë të bëhet për Kelmendin. Kështu që Sfidat e sotme janë vazhdim i sfidave të djeshme, por në një rrethanë të re, krejt tjetër si atëherë, sepse vetë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur e detyrojnë një gjë të tillë. Jam krejt i bindur se Kelmendi është i lumtur që kësaj radhe merret me këtë SFIDË, se sa me sfidat e dikurshme. Pra është një pyetje e kotë edhe nga ata që e bëjnë.

Miqtë e Kelmendit, të cilët, ashtu si edhe kundërshtarët e tij, nuk janë

të paktë, kanë edhe ata mendimin e tyre. Kush e ka njohur nga afër e ka të vështirë të zemërohet me të, edhe kur, me disa nga sfidat që lëshon nuk janë të një mendimi. Miqtë e kanë besuar gjithnjë atë, megjithëse ka pasur edhe miq të përkohshëm, të cilët bënë mirë që shkuan, ashtu si ka pasur edhe njerëz, nga të cilët Kelmendi ka bërë gabim që është larguar. Kjo është jeta. Unë bëj pjesë në radhën e miqve të Kelmendit, ndoshta nga më të afërtit e viteve të fundit, të paktën e 15 viteve të fundit, mirëpo nuk desha të gjykoj librin sipas këtij prizmi. Për vete e di se ky është një libër që jo vetëm është i vyer, por edhe i domosdoshëm.

Është dashur ta bëjnë shumë vetë këtë libër, është dashur të kalojë përmes shumë hallkave, është dashur që në vend të studimeve të kota dhe titujve shkencorë të pabukë, të ndalen pikërisht në këtë sfidë, sepse mbi të gjitha është sfida e përballimit të jetës në Kosovë.

Unë do të përpiqem të jem i paanshëm në gjykimin tim, e megjithëse e di se është e vështirë. Sidoqoftë, ata që do të duan të gjykojnë mendimin tim, përpara se të thonë se "kjo është fjala e një miku", le të lexojnë me vëmendje, deri në fund, librin e ri të Kelmendit.

Si shumë të tjerë, librin në formën e tij të përfunduar, e lexova përmes faqes me prestigjioze të internetit në gjuhën shqipe, **www.pashtriku.org**. Më është bërë zakon tashmë që çdo mëngjes, në fillimin e punës, të futem në këtë faqe interneti. Nuk e kam bërë këtë disa kohë më parë, jam i detyruar ta bëj tani, pasi është bërë e domosdoshme për të ditur më shumë dhe më gjerësisht. Për fat të keq, disa gazeta në gjuhën shqipe si "Epoka e re" nuk është në internet, kështu që "dashurinë time të vjetër" për shtypin në Kosovë, pra për "Epokën", filloi ta mbushë kjo faqe interneti.

Pasi e lexova librin, thuajse me një frymë, pasi lexova fjalën e thënë mjeshtërisht nga njëri prej mjeshtreve më të mëdhenj të fjalës shqipe, profesor doktor Shaban Sinanit, së pari, më janë kujtuar kur në fillimin e luftës e më pas, në shtëpinë e vogël të këtij të fundit, bënim

mbledhjet e gjata të Kryesisë së Lëvizjes Popullore të Kosovës, më janë kujtuar dhjetëra e dhjetëra shokë që kalonin përmes këtij Njeriu të jashtëzakonshëm, pastaj edhe nata e fundit para se me Rifat Jasharin të ktheheshim në Kosovë, kur në njërën nga dy dhomat që kishte e gjithë banesa, fjetëm disa burra që ishin nisur në rrugën e rikthimit. Kosova në të vërtetë i ka shumë borxhe këtij Njeriu, në mos i vetmi, më i rëndësishmi, në përkrahjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mu kujtuan të gjitha këto, dhe vetëm nëse i ke ditur këto, mund të dish edhe shkakun përse ajo parathënie e librit është aq e saktë, aq e argumentuar shkencërisht, pasi në të njeriu i shkencës, profesor doktor Shaban Sinani, është pleksur me atdhetarin e madh Shaban Sinani.

Pastaj unë i shkrova autorit. Po e sjell këtë kumt të parë ose, më saktë, këtë mendim të parë, ashtu si e kam shkruar.

Miku im Ibrahim,

sot e fillova ditën duke lexuar ne internet librin tënd të ri "Sfidat e radhës". Megjithëse ishte i njohur për mua, pasi e kam lexuar ne variantet e dërguara, tani pas redaktimit, edhe gjuhësor, u ndjeva rishtas i befasuar. Dhe e gjithë ajo që është thënë në parafjalën e librit nga profesor Shaban Sinani (nuk do të kishe mundur dot të gjeje parathënës më të mirë), është e merituar, deri në imtësi.

Natyrisht unë do të kisha mundur të shtoja edhe ndonjë gjë në këtë parafjalë, e cila, ka folur edhe përmes librit, por që të ja bëja të qartë edhe një herë atyre që ose nuk e kanë harruar, ose nuk e kanë ditur sepse nuk kanë dashur ta dinë, ose bëjnë sikur nuk e kanë ditur: kryefjala e këtij punimi është në ndjenjën tënde për Kosovën. Është një libër që dëshmon edhe një herë se sa fort dhe sa kuptueshëm, nganjëherë deri në dhimbje, e do ti vendin tënd, i do njerëzit e tu. Kjo ishte ajo që më përcolli sot që në mëngjes herët, pasi kam filluar të lexoj që pas orës pesë e gjysmë. U ngrita sepse nuk kisha gjumë, kjo po me ndodhë kohët e fundit, hyra në internet, sepse është bërë zakon, si njeriu që sheh çdo ditë postën e tij; ndesha në një shkrim për Lëvizjen që më kishte

dërguar "Pashtriku", dhe kur hyra aty, tek Pashtriku, gjeta materialin tënd, tashmë në formë të plotë, të tejmbushur me mirësi, me mendim të analizuar, pa asnjë lloj mllefi, në vendin e duhur dhe, mendoj unë, nga njeriu i duhur.

Them nga njeriu i duhur, pasi ti je, në këtë kohë mizore, aspak mirënjohëse, njeriu më i paanshëm, pasi nuk je as në qeveri, as në pushtet, as nuk ke qenë; nuk je as në opozitë, sepse edhe atë e sheh me syrin e paanshëm; nuk je as i mërzitur dhe nuk ke asnjë lloj mllefi. Je njeriu i duhur pasi, në gjithë këto vite ke mbledhur në vete përvojën e mosdurimit të së keqes, dhe këtë nuk e ka gjithkush; ke mbledhur vitet mes një vendi që të ka mësuar; nuk je bërë kurrë konformist dhe të gjitha, së bashku me dijeninë e thellë, e ke thënë ndershmërisht.

Nuk do të doja të kisha filluar një mëngjes më mirë se kaq. Nuk do të doja të kisha një fillesë më të mirë se kjo. Nëse do të isha zyrtar i Kosovës apo i Tiranës do të kisha mbajtur librin tënd me vete.

Ata mund të mendojnë se i dinë të gjitha këto, por më beso se nuk dinë as një të pestën e tyre: Edhe nëse i dinë pjesë pjesë dhe në koka të ndryshme, nuk janë bërë kurrë bashkë, asnjëherë për ti mbledhur të gjitha në një libër, për ti thënë shkoqur, hapur, saktë dhe për ti përmbushur ato.

Shumë njerëz, edhe ata që të njohin, do të ndjehen disi të habitur. Sepse kanë pritur prej teje më shume mërzi në libër, ngaqë, jo rrallë, të matin me kutin e tyre. Do të ketë njerëz që do të thonë se "çfarë i duhet", "çfarë fiton", do të ketë të tjerë që do të llogaritin se "kujt ia ka futur" dhe "cilin ka marrë në mbrojtje".

Nga të gjitha këto mjegulla, e vetmja që më pëlqen, është e fundit, hamendja se në krah të kujt je dhe se në krah të cilit nuk je, sepse tregon, edhe se nuk kanë dashur të dëshmojnë se të njohin mirë, përsëri e ndjejnë se mendimi yt është i fuqishëm.

Ky është një libër që nuk duhet të rrijë në konturet e një faqe interneti. Duhet të botohet.

Kjo ishte letra ose mesazhi im i parë për librin e ri të Kelmendit.

Është i sjellë saktësisht si e dërgova atij mëngjesi të herët. Sidoqoftë, thënë sinqerisht, megjithëse është një libër që sjell hapësirën e tij, përsëri ai sjell edhe një herë, rënien e disa tabuve ose tentimin për shembjen e tyre.

Le të marrim njërin prej tyre, i cili është sjellë çuditërisht në libër: qëndrimi i Kelmendit ndaj një figure si Miladin Popoviç. Është një figurë e njohur në Kosovë dhe në Shqipëri, për të cilin, sipas kohëve të ndryshme, janë sjellë mendime të ndryshme, por që kohët e fundit, me ose pa të drejtë, është cilësuar si njëri ndër rrënuesit e idesë së bashkimit të shqiptarëve në një shtet të vetëm. Kelmendi mendon se ai ishte një njeri që ndryshe nga sa është thënë vitet e fundit, ai ishte ndër të paktët politikanë jo shqiptarë që e donte një bashkim të tillë, ndaj edhe e vranë. Të jetë e mundur kjo? Të jetë e mundur që pesëdhjetë e ca vite më parë, republika e Kosovës, të ketë pasur "njohjen" e parë malazeze nga një njeri i tillë? Kelmendi e sjell këtë shembull në kontekstin e asaj që me njerëz të kombësive të tjera edhe mund e duhet të bisedohet, duhen të ndërtohen ura të ndërsjella për ngushtimin e hapësirave.

E rëndësishmja tek libri i Kelmendit është e ardhmja e Kosovës. Ai e sheh mundësinë e zhvillimit dhe të ringritjes së ekonomisë, të mendimit politik dhe social të Kosovës, sjell fakte, argumente, shembuj, lakon rrugë nëpër të cilat kanë kaluar shtete të tjerë, thekson idenë se nëse gjithsecili prej nesh e pastron oborrin e tij, atëherë gjithë Kosova është e pastër, çka do të thotë se nëse secili mendon për Kosovën, zhvillimin e saj, për ndërtimin e shtetit; nëse gjithsecili e vendos sinqerisht një gur, atëherë mund të ndërtohet e ardhmja.

Në libër ka edhe shembuj, përvoja, sjellje e qëndrime të cilat mund të mos jenë të përshtatshme për Kosovën në stadin e saj të zhvillimit; ka fakte të cilat, edhe pse në vete qëndrojnë, nuk mund të përbëjnë risi për Kosovën.

Kjo është në degëzimet e atyre që duan të thellohen në libër. Kelmendi vjen kësaj radhe si erudit, por është i bindur se shumëçka mund të shtohet apo edhe të pasurohet në librin e tij. Një gjë që mund të

bëhej më mirë do të ishte në sendërtimin e idesë se çfarë përfitimi do të kishte një treg i hapur ndërshqiptar, krijimi i një zone të lirë ekonomike mes Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe pjesës shqiptare në Maqedoni; çfarë përparësish do të kishte, a do të mund të realizohej krijimi i një blloku të madh të punës, të idesë dhe të përvojës ndërshqiptare.

Mund të ketë, por unë i rri besnik deri në fund frazës së fundit që shkrova menjëherë pas leximit të librit: Duhet të botohet. Shtoj edhe më tej: duhet bërë pronë e debatit. Ai na ka ftuar. Më mirë se gazetarët, publicistët apo shkrimtarët, këtë mund ta bëjnë njerëzit e shkencës. Koha është e tyre.

Demistifikimi, realizmi dhe udhërrëfimi

Shpend VINCA (gazetar, Strugë)

(Vlerësim për dorëshkrimin "Sfidat e radhës", të autorit Ibrahim Kelmendi)

Ibrahim Kelmendi është ndër intelektualët e paktë në Kosovë që di të nuhas, hulumtoj, mendoj, shtroj, gjithsesi edhe të kritikoj, por mbi të gjitha të jap edhe rrugëzgjidhje për çështjet që shtron. Kelmendit nuk i mungon guximi, madje, ai di të jetë edhe tepër i drejtpërdrejtë, por mbi të gjitha ai ka stilin dhe metodën e tij të shtrimit të çështjeve me të cilat merret. Në këtë punë, pakkush e di se sa e mundimshme është, i ndihmon edhe përgatitja e mbi të gjitha përvoja dhe dija që posedon nga shumë lëmi të jetës.

Dorëshkrimi, i cili dëshiroj që sa më parë të botohet, që nga titulli, "Sfidat e radhës" dhe me nëntitullin "Kosova: Rruga e mundimshme drejt shtetit", të provokon, të nxit jo vetëm ta lexosh, por edhe të merresh me të dhe me idetë që shtrohen në të.

Ibrahim Kelmendi shfaq shqetësimet dhe sfidat e radhës që i presin shqiptarët, ai mendon zëshëm për shtet-bërjen dhe shtet-ndërtimin, duke nisur nga periudha të ndryshme kohore, e mbi të gjitha, Kelmendi për herë të parë publikisht del me idenë se si duhet vepruar me serbët që pushteti serb instaloi në Kosovë nga viti 1990, kur ai pohon se jo të gjithëve dhe jo me automatizëm duhet tu jepet shtetësia e Republikës së Kosovës. Këtë ai e argumenton dhe e shpjegon me mjeshtri dhe pasi të kesh lexuar tekstin e Kelmendit vërtet detyrohesh të mendosh rreth kësaj çështjeje.

Ibrahim Kelmendi, kur flet për serbët në shtetin e Kosovës bën një krahasim se si jetojnë komunitetet e tjera në shtetet rreth Kosovës, ku

janë shumëfish numerikisht më shumë se sa janë serbët në Kosovës. Kelmendi duke u marrë me këtë çështje pohon se "mjafton vetëm të bëjmë një krahasim me shtetin fqinj të Republikës së Maqedonisë dhe do të shohim se sa më shumë të drejta u janë rezervuar e garantuar serbëve në Kosovë në krahasim me të drejtat që kanë shqiptarët në Maqedoni. Në Maqedoni mbi 35 për qind e popullsisë janë shqiptare etnikë. Ata nuk i kanë as 50 për qind të drejtave që ka popullsia serbe, e cila përbënë vetëm rreth 5 për qind të popullsisë së Republikës së Kosovës". Përmes një paralelizmi ku përfshihen edhe shqiptarët në Serbi autori i tregon lexuesit se shqiptarët edhe pas gjithë atyre që kanë hequr nga serbët, megjithatë janë zemërgjerë dhe u ofrojnë shumë më shumë të drejta se sa ofrojnë shtetet fqinje për numër shumëfish më të madh se sa janë serbët në Kosovë.

Ibrahim Kelmendi sfidën e radhës për shtetëbërjen e Kosovës e sheh edhe te lufta kundër krimit të organizuar, kundër korrupcionit të institucioneve. Në këtë pjesë Kelmendi është bindës dhe me argumentet që ofron, por edhe më shumë se si duhet vepruar tregon se ai jo vetëm që di të kritikojë, por di të japë edhe vizionin se si duhet vepruar dhe kush duhet ta bëjë atë.

Është krejt e natyrshme që autori i librit, Ibrahim Kelmedni, veprimtar i lëvizjes kombëtare, autor i disa librave që në këtë libër analizon periudhat e ndryshme nëpër të cilat ka kaluar Kosova. Gjithsesi, jo rastësisht, ai ndalet më gjatë në vitet e fundit të shekullit XX, edhe më shumë te ngjarjet e pas vitit 1999. Kelmendi demistifikon "njëshin" e Kosovës, të partisë dhe të pushtetit paralel, ai di të veçojë lëvizjen gandiste nga "rezistenca pacifiste" dhe lufta çlirimtare. Kelmendi nuk ngurron të fajësojë individët, (edhe pse emrat mungojnë), të cilët me ose pa vetëdije në situate të caktuara janë bërë pengesë e zhvillimit të proceseve.

Njeri me informacione të bollshme nga sfera e zhvillimit demokratik, Ibrahim Kelmendi flet për zhvillimin demokratik në Kosovë, duke e quajtur fazën në të cilën kalon Kosova "Faza parademokratike e

shoqërisë shqiptare", ku ai demistifikon subjektet politike, "njëshat", ku gjithçka ka, por mungon demokracia e brendshme, e cila është e domosdoshme për zhvillimin e një vendi demokratik. Me të drejtë ai flet për demokratizimin e brendshëm të partive politike, por flet edhe për qasjen ndaj të kaluarës.

Shtetëbërja dhe shtet-ndërtimi pa zhvillim ekonomik është fjalë boshe. Mu për këtë Kelmendi një pjesë të mirë të dorëshkrimit ia kushton (mos)zhvillimit ekonomik të Kosovës. Pasi jep një pasqyrë realiste për atë se si ka shkuar zhvillimi i Kosovës dhe ku është Kosova sot, Kelmendi përmes analizave të bëra tregon se ku duhet të orientohet zhvillimi i Kosovës. Përvoja perëndimore gjithsesi se i ka ndihmuar që të jetë i qartë dhe konciz, analitik dhe bindës në tezat e tija. Kelmendi flet për zhvillimin e Kosovës ku bazën e vë tek energjia elektrike e cila do të prodhohej nga TEC-et. Është e natyrshme që lexuesi mos ketë informacione për këtë sferë, por autori përmes analizave, të dhënave dhe shembujve konkret bëhet bindës për tezat që shtron, dhe, shpresoj, me to do të merren ekspertët e energjetikës. Ai flet edhe për procesin e privatizimit ku pohon se Qeveria e Kosovës duhet të çlirohet nga mania e privatizimit. Rëndom shtetet e zhvilluara evropiane privatizojnë vetëm ato firma që nuk japin fitime, kurse ato që japin, i mbajnë për vete, për të pasuruar buxhetin e shtetit, i cili rrit mirëqenien sociale të qytetarëve, zhvillon infrastrukturën, etj. Thënia "privatizojnë vetëm ato firma që nuk japin fitime" është një sinjal i mjaftueshëm se si duhet të veprojë Qeveria e Kosovës dhe jo vetëm ajo.

Dorëshkrimi "Sfidat e radhës" lexohet me interes dhe është jo vetëm një libër që pasqyron një realitet, që demistifikon një periudhë dhe "njëshat" e asaj periudhe, por është libër i cili tregon se ku çalon shoqëria kosovare, çka ajo duhet të bëjë, kush duhet ta bëjë dhe si duhet të veprojë.

"Sfidat e radhës", besoj, është me interes që të përkthehet dhe të botohet edhe në gjuhë të huaja, sepse do të ishte një dokument që do t'u shërbente pushtetarëve të Republikës së Kosovës, dhe jo vetëm

atyre, në takimet me autoritetet e huaja, duke ua dhënë atyre versionin e përkthyer.

"Sfidat e radhës", është libër që do tu shërbej shqiptarëve, pavarësisht se ku jetojnë dhe veprojnë.

Autori e mbyll dorëshkrimin me *katarsisin,* i cili shpresoj se nuk do t'i shërbej autorit për t'u mbrojtur nesër apo pasnesër, nëse shtetëbërja dhe shtet-ndërtimi ecin ngadalë edhe pse, ç'është e vërteta, autori, Ibrahim Kelmendi, e ka thënë fjalën e tij, e pastroi shpirtin e tij, por ai duhet të ngre zërin nëse edhe pas botimit të këtij libri proceset nuk ndryshojnë.

"Më në fund, sa shumë po shpresoj se tani do të ndërgjegjësohet klasa jonë politike, pushtetarët, kryepartiakët, njerëzisht, qytetarisht e shqiptarisht, që të bëjnë më të mirën e mundshme për shtet-bërjen e shtet-ndërtimin e shtetit tonë, që të bëjnë më të mirën e mundshme për zhvillimin e përshpejtuar ekonomik, demokratik e social". Kështu shpreson autori, por a thua do të lëvizin proceset ashtu si rekomandon ai? Mbetet të shihet.

"Sfidat e radhës" është libër të cilin duhet ta lexojnë dhe rilexojnë, në radhë të parë pushtetarët dhe partiakët. Nuk thuhet më kot se këmbana bie për ata që kanë vesh.

Dhe, në fund, nuk dëshiroj që autori i librit, pas botimit të tij, pas promovimeve dhe përurimeve të zhgënjehet sepse shtet-bërja dhe shtet-ndërtimi i Kosovës do të vijojë me të vjetrën. Këtë nuk ia dëshiroj autorit, i cili edhe me këtë libër dëshmon se ka dije, informacione, guxim dhe sistem mendimi të formuar intelektual për proceset dhe rrjedhat e tyre.

Dhe, krejt në fund autorin, Ibrahim Kelmendi e përgëzoj për mundin që ka dhënë dhe për guximin me të cilin i shtron analizat e tija.

Demokracia dhe sfidat e saj shqiptare në optikën publicistike të Ibrahim Kelmendit

Xhevat Ukshini (Gjermani)

Ibrahim Kelmendi, publicist me profil tepër origjinal, në një hark kohor prej dhjetë vitesh na sfidon për të tretën herë, këtë herë me librin e tij "Sfidat e radhës", me guximin e tij jo vetëm për të nyjëtuar të vërtetat që i kemi përditë përballë dhe s'kemi guxim t'i shohim në sy, por për më tepër me alternativat e argumentuara bindshëm që na ofron si rrugëzgjidhje.

Kelmendi në këtë libër në mënyrën analitike dhe sintetizuese merret me trajtimin e problematikës politike dhe ekonomike. Kosova ka para vetes një periudhë të vështirë të ndërtimit të shtetit dhe të ekonomisë së saj të rrënuar në mënyrë sistematike në të paktën dy dhjetëvjeçarët e saj të fundit nën sundimin serb. Më parë, siç dihet, Kosova në sferën politike është qeverisur me mjetet e diktaturës policore të pushtuesit, kurse në aspektin ekonomik ajo përbënte për Serbinë dhe Jugosllavinë një rajon të pasur që qeverisej me metodat koloniale, një rajon fitimprurës i eksploatimit të lëndëve të para të papërpunuara që plaçkiteshin pamëshirë. Pas Luftës së Dytë Botërore Kosova në eksportin e përgjithshëm të Jugosllavisë merrte pjesë me rreth 25 %, në një kohë që si territor ishte më pak se 5 %. Siç duket, fqinji ynë serb e ka të vështirë të mësohet me këtë humbje, prandaj dhe po i përdorë serbët minoritarë si një mjet shantazhi për të minuar procesin e shtet-ndërtimit.

Edhe në këtë libër kritika e Kelmendit nuk është *ex catedra* dhe as rrënuese, por kritikë konstruktive, deri në fund, e njeriut që e jeton intensivisht këtë realitet, i cili patjetër duhet parë me syrin e kritikës,

e njeriut që brengoset për vendin e tij, që ka para vetes shanse dhe rreziqe po aq të mëdha. Veprimtaria publicistike të Kelmendit, që nga koha e ushtrimit të saj në shtypin ilegal, fillon qysh në fund të viteve '70 dhe pastaj vazhdon përgjatë tre dhjetëvjeçarësh, e përshkon si një fill i kuq synimi për të vënë rregull në mendim, në gjuhë dhe në përdorimin e saj interaktiv në qarqet ilegale ku ai me veprimtarinë e tij ishte i involvuar, me një fjalë, vënien e një rendi në veprimin praktik politik që për qëllim kishte çlirimin kombëtar. Në kohën e monizmit guximi i tij për ta përdorur mendjen e vetë pa tutori ideologjike është quajtur ndonjëherë anarkoliberalizëm, një tipizim që mund të pranohet, nëse kjo fjalë shikohet me një sy filologjik. Ky nocion duhet shkoqitur në përputhje me synimet e angazhimit të Kelmendit në këtë periudhë dhe me vonë. "Anarkist" kushtimisht mund të quhet, sepse fjala anarki ka brenda vetes mungesën e sundimit, rrëmujën dhe mosnjohjen e autoriteteve. Kelmendi ishte i tillë. Ai e donte anarkinë në kuptimin e mungesës së sundimit serb, të shthurjes së rendit që i ishte imponuar kombit shqiptar dhe që detyrimisht do të çonte në stërkeqen e forcave të tij reale. Kelmendi nuk do të lodhej kurrë së vepruari kundër këtij rendi dhe së kritikuari në publicistikën e tij të mprehtë këtë synim të pushtuesit. Duke mos e pranuar këtë rend dhe duke punuar pa ndëprerë për shembjen e bazave të tij, ai, me plotë kuptimin e fjalës, mund të quhet varrmihës i sundimit të huaj, pra një anarkist në perspektivën e atyre që donin një rend të hekurt, të stabilizuar, një shtrat Prokrusti për shqiptarët. Këtë lloj autoriteti shtetëror Kelmendi nuk e ka njohur kurrë. Nëse cilësimi "anarkist" vinte nga njerëz që ishin po ashtu në mënyrë aktive apo pasive (pjesa dërmuese) kundër sundimit serb të Kosovës, atëherë mund të thuhet se Kelmendi ka dhënë argumente të forta që i hedhin poshtë këtë terminologji politike. Që kur në hapësirën shqiptare u etablua demokracia, me të gjitha mangësitë e saj që i njohim, ai është treguar më i disiplinuar shumë herë se ata që i drejtuan kritika nga më të ndryshmet ndaj tij, jo gjithherë të prirë nga parimet, shumë më tepër për ta eliminuar si kundërshtar në lojën politike. Edhe libri i fundit hedh një rreze drite mbi mendimin e tij politik që s'ka pasur asnjëherë asgjë të

përbashkët me nocionin e anarkizmit në kuptimin e mirëfilltë të saj .

Kelmendi ishte dhe vazhdon të mbetet liberal. Ndër liberalët më të njohur të Evropës do të mjaftonte të përmenden Hans-Dietrich Genscher-i dhe Wolfgang Ischinger-i, dy personalitete gjermane që bota shqiptare i njeh mirë dhe i respekton thellësisht. Me këtë të fundit, pas shpërthimit të luftës çlirimtare, Kelmendi takohej për ta informuar për synimet e çlirimtarëve. Atë që e bënin në fushën e betejës luftëtarët, shumë prej tyre me pozita udhëheqëse miq të tij, ai e barte në kancelaritë e shtetit më të fuqishëm në Evropë, e shtetit që i ka mbështetur shqiptarët në mënyrë konsekuente dhe me shumë takt - për shkak të hipotekave historike nga e kaluara - në rrugën e tyre të vështirë drejt lirisë. Pa një imigracion shqiptar në botën gjermanishtfolëse është tepër e vështirë të mendohet inkurajimi dhe mbështetja e kryengritjes. Pra, nga kjo që u tha, Kelmendi na del një liberal e një liberator i vërtetë, siç do të thoshte Noli. Fjala liberal, veç tjerash, etimologjikisht ka të bëjë me lirinë dhe prirjen drejt lirisë, si paraardhësit e tij të lavdishëm kelmendas, autori i këtij libri e kishte trashëguar si diçka reziduale në shpirtin e tij. Lirinë ai donte mbi të gjitha, lirinë kombëtare, por edhe atë individuale, sepse do të përbënte një apori në filozofinë politike të angazhohesh për lirinë e kolektivitetit dhe të mohosh lirinë e individit. Kelmendi gjakonte një shoqëri të lirë kombëtare që do të ecte me ritmin e kontinentit ku ai bënte pjesë me gjenet, konstitucionin shpirtëror, kulturën dhe gjeografinë e tij, jo një rend autoritar, pavarësisht bazës së tij ideologjike. Liria e individit dhe përgjegjësia e tij sociale janë dy nga kërkesat fondamentale të iluminizmit evropian që këto prirje të natyrshme të qytetarit të emancipuar që po vinte, i përpunoi në kushtet e sundimit të autokracive monarkike të kohës së re.

Publicistika e Kelmendit në trajtën e librit vjen relativisht vonë, pas përvojës së tij të gjatë si analist i fenomeneve politike-kombëtare njëzetvjeçare, me librin "Shqipëria – jashtë "Veriut" dhe Jugut"", në një çast që pa mëdyshje përbën një cezurë historike për gjithë shqiptarët në Ballkan. Me këtë libër të guximshëm, që për objekt ka pranverën e trishtuar të vitit 1997, Kelmendi nxori në shesh të vërteta të hidhura

për autorët dhe shkaktarët e vërtetë të këtyre proceseve shtet-rrënuese të atij viti, që, me gjithë mbrapshtinë e tij, në vetvete mbante embrionin e një rrëmuje tjetër shtet-ndërtuese. Në një kohë kur rezignimi shqiptar kishte kapur kulmet, Kelmendi i bën një prerje të tillë ngjarjeve, të cilat zbulojnë para lexuesit dimensione të paimagjinueshme të këtij realiteti, një botë optimiste dhe aspak deprimuese. Shumëkush bërtiste atëbotë se Shqipëria po rrënohej përfundimisht, kurse Kelmendi si një njohës i politikës botërore, njohës i thellë i proceseve historiko-politike të atdheut të tij dhe si një vëzhgues i vëmendshëm në vendin e ngjarjes, nuk e përqendronte vështrimin e tij vetëm në një segment të atij universi që ishte përfshirë nga turbulenca, në dukje absurde, por në tërësinë e tij kishte diçka që emetonte sinjale shpresëdhënëse. Derisa të tjerët e kishin përqendruar shikimin në rrënimet, kaosin e pashpresë, dëshpërimin vetëmohues e vetëposhtërimin medial dhe akuzonin shqiptarin për paaftësi shtetmbajtëse, për mungesë vullneti politik, për ndërtimin e demokracisë apo Evropën për zhdukjen e shqiptarëve nga skena botërore, Kelmendi e kishte kthyer shikimin mikroskopik tek proceset regjenerative të indit tonë kombëtar, tek lindja e një tendence të re që do të shkojë duke u rritur më pas në një lëvizje kombëtare të vërtetë për çlirim.

Me librin tjetër, romanin autobiografik "Atentatet", në një vështrim retrospektiv, Ibrahim Kelmendi na shpie nëpër shtigje të rrëpira nëpër të cilat ai kishte ecur vetë dhe së bashku me shokët e tij, atje ku e kishte çuar veprimtaria e tij politike-patriotike. Në këtë libër ai na shpalos një realitet heroik e tragjik, por hera herës edhe komik dhe jo rrallë tepër cinik të veprimtarisë ilegale dhe gjithçkaje që e përcillte atë si *nusprodukt*. Lëvizja ilegale shqiptare përcillej këmba-këmbës nga shërbimet e fshehta jugosllave e serbe, ishte një ndeshje ku nuk kursehej asgjë, vrasje, burgosje, tradhti, infiltrime,

etiketime me synim të fshehjes së gjurmëve dhe të shkaktimit të përçarjes, një luftë e vështirë ku për llogari të pushtuesit punonin jo pak shqiptarë, hapur dhe fshehtas. Në këtë libër, ku ai vetes nuk i thur ditirambe lavdie, na e shpalos një botë të veprimit ilegal, ku veç idealistëve dhe njerëzve të dhënë me gjithë shpirt pas kauzës së kombit të tyre, gëlon edhe një galeri e tërë idiotësh, spiunësh, mashtruesish të të gjitha ngjyrave dhe shërbëtorë të përjetshëm të të huajve. Nëse ai me veten nuk është butë, s'ka përse t'i kursej as të tjerët që ishin zhytur thellë në ujërat e provincializmit mendor. Për një pjesë të personazheve të kësaj vepre biografike ai formulon akuza të rënda dhe gjykime asgjësuese. Ka kaluar mjaft kohë që nga botimi i këtij libri dhe përgjigjet në pyetjet që shtron ai në adresa qartësisht të lexueshme nuk janë dhënë. As mediat dhe institucionet shqiptare nuk e kanë vënë ujin në zjarr për të hedhur dritë mbi njërën nga vrasjet më enigmatike të çerekut të fundit të shek. XX, por një gazetë e përditshme gjermane, "Neue Rheinische Zeitung" më 17.10.2007, pra disa muaj më vonë, pas botimit të këtij libri, vrasjes së Jusuf Gërvallës i kushton një shkrim shumë të gjatë ku spikat dyshimi se procesi hetimor nuk ka qenë i paqortueshëm, se procedurat hetimore dhe gjyqësore janë shkelur për shkak të influencave politike, se, thënë shkurt, nuk ka pasur vullnet politik për të zbuluar vrasësin a vrasësit . Me një fjalë, gazetari gjerman Alexander Goeb kërkon rihapjen e çështjes.

Ibrahim Kelmendi nuk ka shkruar asnjëherë artikuj e libra që janë thjesht produkt i kulturës libreske, e cila s'i mungon, dhe i zotërimit të parimeve formale të sintaksës së shqipes, të cilën e zotëron për mrekulli, por artikuj e libra me mendim të distiluar, të dendësuar gjatë viteve, i cili rrënjët i ka tek përvoja personale. Me pasionin e veprimtarit politik ai artikulon ide të guximshme, të cila ti parashtron pikërisht në kohën e duhur, kur ato mund dhe duhet të jenë vepruese. Një shembull mjafton

për ta ilustruar analizën e tij të pakompromis të realiteti të sotëm politik e partiak të Kosovës. Ibrahim Kelmendi me të drejtë e konteston validitetin e vendimit e presidentit Sejdiu për të shpallur hero Ahmet Krasniqin, i cili, siç dihet, nuk ka kurrfarë kontributesh në luftën çlirimtare. Fjala e Kelmendit ka peshë, nuk është thjeshtë lëvozhgë pa mendim brenda dhe, mbi të gjitha, nuk bie erë konformizmi e servilizmi. Të vërtetat e thëna pas kohës, nuk janë vetëm gjysmëgënjeshtra, por një mëkat shumë më i rëndë, përpjekje subtile për të manipuluar me to realitetet e mëparshme në konstelacione të reja të interesave vetjake e grupore. Kelmendi është armik i kësaj forme të hipokrizisë intelektuale mjaft të përhapur në kohën tonë . Ai shumë herë e ka dëshmuar veten si një polemist i shkathtë dhe trim, që beson në fuqinë e fjalës. Shpeshherë shtruarja e çështjeve nga ai, pyetjet e pakëndshme që bënte janë keqinterpretuar si një prirje për paaftësi nga ana e tij për të vepruar brenda një kuadri të dhënë. E vërteta është se në to shpërfaqet shqetësimi i njeriut që devijimet i anticipon përmes analizës së trendeve politike të pafavorshme. Protesta e tij përmes fjalës në publik kanë qenë përherë në shërbim të esullimit dhe të luftimit të mitologjive vërtet provicincialiste në politikën tonë. Pyetjet e shtruara drejt dhe në kohën e duhur, nuk thuhet kot, e përmbajnë gjysmën e përgjigjes së tyre brenda.

"Sfidat e radhës" është një libër që sfidon kohën tonë dhe njerëzit e kësaj hapësire. Që në pasusin e parë Kelmendi përmes një fjalie konstatuese e formulon mirënjohjen tonë për Perëndimin euroatlantik që krijoi hapësirë për të zhvilluar luftën tonë çlirimtare në kushtet e një mbështetje të hapur mediale, politike dhe, në fund, edhe ushtarake. Perëndimi na dha shansin, kurse lirinë e paguam me gjakun tonë. Në fakt ai përmes kësaj mirënjohje e gjykon edhe një prirje mitizuese sot tek persona dhe qarqe politike në Kosovë që luftën

tonë përpiqen ta reklamojnë si fryt vetëm të zgjuarsisë për veprim dhe të marrjes së vendimeve vizionare në momentin e duhur. Në disa pjesë të librit Kelmendi artikulon akuza të tërthorta e herë të drejtpërdrejta për politikat kadrovike që janë realizuar në këto vitet e fundit. Kelmendi si vëzhgues politik i proceseve nuk fshihet pas modestisë së rrejshme kur shtron pyetje dhe ofron përgjigje. Prirja për të monopolizuar rezultatet, të cilat, siç shkruan ai qysh në fillim, vetëm brenda kornizës sonë shqiptare, bile kosovare, është një fenomen me të cilin merret Kelmendi pa fije mëshire. Kelmendi edhe si veprimtar politik, i detyruar të vepronte në ilegalitet, nuk e ka vuajtur sëmundjen e ngushtimit të shikimit vetëm në interesa e organizatës së tij, por e ka gjykuar vetë atë me një ndjenjë esull e gjykim objektiv. Pas krijimit të realiteteve të reja pas 12 qershorit të 1999, Kelmendi, si një njeri me pasion politik dha kontribute publike doli me iniciativa shpeshherë në dukje të parë çoroditëse. Por ai kishte qëllime të larta, madje edhe të tilla që e kalonin kornizën tonë kombëtare dhe ballkanike. Ai vepronte si një evropian i bindur, i cili në fillim të këtij shekulli nuk dëshiron të lejojë grindje dhe inate të vjetra, që proceset e pajtimtare dëshiron t'i promovojë madje edhe në forma aspak të zakonshme. Ato që përjetoi Ballkani në fillim të viteve '90-ta, nuk mund të harrohen lehtë dhe as do të harrohen, këtë kurrë s'e ka kërkuar Kelmendi, por ai ka kërkuar vazhdimisht që të përdoret mendja dhe vetëm mendja për të dalë nga shtjella ku ndodhemi dhe si fitimtarë të dalë nga konjunkturat e politikës botërore në fund të shekullit të kaluar do të duhej të bënim gjithçka që ta braktisim këtë zonë të rrezikshme për interesat tona kombëtare.

Lexuesi në librin "Sfidat e radhës" gjen diçka që nuk e gjen në secilin libër, ai gjen aty analiza shkencore me formulime të kuptueshme, thellësi gjykimi që nuk ka nevojë për ornamente intelektualiste. Ai i sheh me dyshim sistemet

qeverisëse, përdorimin e pasurisë publike për qëllime private, predimensionimine meritave... Kelmendi ia heq cipën lakrorin përderisa dukurive negative u vë emrin e vërtetë dhe nuk lejon që ato të fshihen pas frazeologjisë unitet-ruajtëse në kinse kohërat e rrezikimit të pavarësisë dhe fryteve të arritura. Pavarësia rrezikohet në radhë të parë përmes korrupsionit dhe të kuptuarit reduksionist të demokracisë si një formë që e duron korrupsionin kinse të pashmangshëm në periudha transitore. Përvojat e Shqipërisë e bëjnë Kelmendin që të vë theksin në luftimin që në embrion të këtyre praktikave shoqërore dhe politike. Kelmendi në këtë libër ka përpunuar një *instrumentarium* të tërë, jo aq voluminoz, por shumë preciz që mund të shërbejë për analizimin e fakticitetit shqiptar dhe për sinteza befasuese të mendimit politik shqiptar.

I. Kelmendi nuk ka aspak iluzionin që sovraniteti i shpallur dhe i njohur nga bota perëndimor do të thotë autonamitikisht sovranitet faktik. Mosshkathtësia e veprimit brenda kornizës së dhënë dhe mosaftësia për të zgjeruar hapësirën e veprimit në arenën ndërkombëtare mund ta çojnë Kosovën në vështirësi të reja dhe në humbjen *de facto* të asaj që është fituar *de iure.* Ibrahim Kelmendi disa herë është i ashpër në vlerësimet e tij, por kjo nuk do të thotë se ai nuk ka të drejtë. Ai tërheq vërejtjen që procesi i tranzicionin, që aq mbrapshtë është formësuar në Shqipërinë postkomuniste, të mos bëhet edhe fat i Kosovës.

Mendime për punimin "Sfidat e radhës"

Mr. Hajdin Abazi (Prishtinë)

Kushdo që e njeh drejtpërdrejt Ibrahim Kelmendin, si njeri dhe si veprimtar politik, vetvetiu e ka të qartë dhe e kupton stilin e tij të të shprehurit, qasjen dhe trajtimin e temave që janë të njohura nga shumëkush prej nesh, por që ai i problematizon me sens.

Refleksionet politike, të përmbledhura në këtë vëllim intelektualisht provokativ, shprehin shqetësimin e kohës, pasqyrojnë një sërë proble-mesh serioze me të cilat ballafaqohet shoqëria jonë në periudhën e pasluftës dhe të tranzicionit të shumëfishtë.

Autori i ka përcjellë me kujdes zhvillimet në Kosovë e rreth saj, dhe nga gama e madhe e problemeve, ai veçon disa prej tyre – sikurse janë aspektet e shtet-bërjes dhe shtet-ndërtimit, lakorja demokratike dhe aspektet ekonomike të Kosovës – të cilat i trajton shkurt, qartë, pa ekuivokë, pa tabu dhe depërton drejt e në thelb të tyre. Ai i shpupurish ato duke i riaktualizuar, duke i vënë në fokus dhe duke i treguar me gisht. Lidhur me të gjitha këto, autori shprehet me guxim qytetar, ashtu sikurse është tipike për të edhe në jetën e përditshme, vetëmse këtu mendimet i ka të kondenzuara, të formuluara me mprehtësi dhe me kulturën e tij të të shprehurit.

Ky shkrim më i ri i autorit nuk është thirrje për uniformim të mendimit, përkundrazi – ai mund të merret si thirrje për këndellje në të reflektuar dhe si zgjim i kureshtjes intelektuale për t'u shprehur lidhur me fenomene të cilat i hasim në përditshmërinë tonë. Ai i identifikon problemet, i shpreh ato dhe parashtron pikëpamjet e tij alternative. Pikërisht për këtë, gjithkush që dëshiron të shohë më ndryshe një pjesë të problemeve me të cilat ballafaqohet Kosova, të njohë një mendim alternativ dhe që dëshiron të preokupohet me brengat ekzistuese të zhvillimit shtetëror, demokratik dhe ekonomik, do të duhej t'i lexonte refleksionet politike të Ibrahim Kelmendit të titulluara "Sfidat e radhës".

Në kushtet e volitshme mbinë farë e keqe

Mehrije (Daci) Haxhisefa

Në thënien e autorit I. Kelmendi, se "mundësit e rrethanat reale në kohë, hapësire dhe jo dëshira kanë kushtëzuar, kanë udhëzuar apo edhe e kanë bërë këtë gjendje si është sot", pajtohem plotësisht.

Në një gjendje siç ishte Kosova pas lufte, në një anarki të brendshëm dhe me një tendencë për shtetformim, gjetën kushte të favorshme ata te cilët autori i cilëson si persona që i janë gëzuar këtij realiteti, ata që turpërohen nga te qenit shqiptarë, ata që sillen si te mos ishin shqiptarë (që ndoshta çdo të dytën fjalë e shqiptojnë në anglisht apo në gjuhë të tjera).

Nisur nga një pikëpamje më të gjerë, nuk jam edhe aq e mendimit se kemi pas shumë të mira nga ndërhyrja e të huajve edhe pas lufte, së paku jo në këtë masë sa t'i gëzohemi atij sundimi të tyre.

Pastaj bindja ime personale është se nuk mundem t'u besojmë aq shumë të huajve. Ndoshta ka të bëjë kjo më shumë, mbase me mitin e krijuar te ne apo faktin (tema diskutabile), se nga jashtë na ka ardhur gjithnjë "taksirati". Mirëpo kjo është temë e cila do duhej diskutuar në rrethana krejt tjera nga njerëzit që e njohin këtë fushë. Ishte veç një bindje e një qytetareje.

Unë do flisja për sferën sociale, peripecitë dhe gjendjen aktuale në këtë sferë.

Në kushtet siç ishim ne, e që vazhdojmë deri diku të jemi ende, kanë ngre krye shumë dukuri negative dhe kanë lulëzuar ato që kanë parë përfitim nga kjo gjendje, ta zëmë edhe disa nga OJQ, sepse në asnjë mënyrë nuk do i përgjithësoja.

Por i kthehemi realitetit:

Nëse me të gjitha këto OJQ dhe një shtet tani më nuk arrihet të behët një rregull në funksionimin e kësaj sfere, atëherë ku mbetet faji? Te

askush, sigurisht, apo mbase tek të gjithë ne.

Nëse asgjë nuk kemi trashëguar, atëherë ketë veti e kemi mbase të lindur, sepse fajin nuk dimë ku ta lëmë.

Bërja e shtetit (institucioneve përkatëse) përgjegjës për adresimin e dhunës që ndodhë në sferën „private", për një mori problemesh sociale mbetet ende shumë e vështirë. Por ti kthehemi diskriminimit dhe formave të tij në këtë sferë.

Gur themel për parimet e mos diskriminimit në Kosovë konsideroj ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës në këto fusha:

Ligji mbi Familjen dhe Shërbimet Sociale.

Ligji mbi të Drejtën Familjare.

Ligji mbi Barazinë Gjinore.

Ligji Kundër Diskriminimit.

Ku jemi tani me këto ligje ? Në një gjendje pak a shumë ku edhe ishim. Si arsye, e cila është demoduar tashmë, dalin punonjësit e gjykatave e prokurorive, të cilët arrestojnë, se sipas „kësaj" e "asaj" arsye, nuk është shqiptuar masa ndëshkuese në një rast të caktuar.

Jemi te padisiplinuar e të papërgjegjshëm në radhë të parë vet ne. Nga këta NE janë të përbëra (kjo strukturë) edhe institucionet ligjvënëse. Çdo tendencë për të minimizuar problemet aktuale i bënë ato edhe më të mëdha dhe më të rrezikshme për një kohë tjetër.

Është shumë e ndërlikuar sfera sociale edhe në shtetet ku janë të rregulluara „gjërat", dekada më herët, e lëne më në Shtetin tonë të ri. Mirëpo mbes pranë bindjes se rruga të cilën jemi duke e bërë tani jep pakë shpresë, po nuk është e kënaqshme në asnjë mënyrë.

Angazhimi për çdo gjë kërkon në radhë të parë një korrektim vetanak. Ne jemi ata qe bashkë e bëjmë këtë popullatë, nëse çdo njëri do bënte përpjekje që të përmirësoj vetën, familjen, një gjë e tillë do rezultonte me përmirësim të gjithë shoqërisë. E kjo është ajo që synojmë pothuaj se të gjithë. Në këtë rast duhet përmendur dukuria që është shumë prezent në shoqërinë tonë, veç tjerash, e kjo është dhuna.

Nuk mund të margjinalizohet dhuna, është krim nëse behët një gjë e

tillë. Janë diçka tjetër faktorët e jashtëm qe e kushtëzojnë deri diku një sjellje më agresive (vite të tëra represioni, traumat nga lufta, papunësia dhe mungesa e perspektivës, gjendja shumë e rëndë sociale), por ne asnjë rast ajo nuk ka justifikim.

Është pafalshme, pavarësisht se ku dhe ndaj kujt ndodhë dhuna në familje, në rrugë, në shkollë, etj. Një mënyrë e tillë e veprimit veç sa krijon kandidat tjerë potencial që nesër prapë do gjenerojnë dhunë dhe gjendja në sferën sociale do përballet ende (me dekada tjera) me problemet e njëjta. Duke mos përmendur se do japim një shembull të një shoqërie të pacivilizuar dhe jo humane.

Dhuna ne baza gjinore?:

Në asnjë mënyre nuk do bëja gabimin të them: e drejta e gruas apo e burrit mjafton që të drejtat janë rregulluar me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e njeriut qysh në vitin 1948, e ne që kemi kohë e shpesh edhe "shkak" merremi ende me probleme të cilat në gjenezë janë inekzistenete. Sepse fajin më të madh për pozitën e gruas në shoqërinë tonë e ka gati gjithnjë vetë gruaja, gjithnjë duke menduar në këtë kohë, ne gruan aktuale e cila shumicën e kohës i kushton serialeve televizive e as çerekun e asaj kohe ngritjes së sajë personale (nëse jo në shkolla atëherë se paku në shtëpi ka mundësinë e tillë), apo mbase i pëlqejnë privilegjet qe i krijohen ku burri bartë barrën e ekonomisë së familjes, etj.

Më herët përmenda ligjet e miratuara për rregullimin e kësaj katrahure sociale dhe bindjen se një numër i këtyre problemeve ishin rregulluar nëse kishte ekzistuar një koordinim korrekt mes institucioneve ligjvënëse dhe atyre të shërbimit civil.

Kontrabandimi, korrupsioni dhe matrapazllëqet tjera që ndodhin në sytë tanë kanë një mbështetje në vetë organet e ligjvënies. Një neglizhim nga ato ekzekutive e kështu me radhë, varësisht nga kompetenca e secilit organ. Nuk mund të thuhet se nuk ka përmirësime. Po ka, por jo në masën e duhur sa për të rregulluar një çështje të vetme deri në fund.

Kërkohet në radhë të parë një korrigjim në strukturën e të punësuarve

në këto organe, në strukturën e njerëzve që punojnë aty. Pastaj kërkohet një monitorim në aplikimin e ligjit dhe vënien e rendit .

(...) Shembull: Si mund të punoj si gjykatës në sferën e dhunës në familje njeriu i cili në shtëpinë e tij e rrah gruan dhe nuk turpërohet që këtë ta thotë edhe në pranin e palës së dëmtuar, një tjetër që vjen nga familja mafioze është vënë të gjykoj veprat e rënda penale në fushën e kontrabandimit e trafikimit. Ndonjëherë të krijohet përshtypja se çdo gjë është e kurdisur për së prapthi.

Andaj privilegji që pata për të lexuar këtë studimi (Sfidat e radhës), më bënë optimiste, më kthen besimin që shpesh nuk e kam, se një ditë ky vend do jetë ashtu siç e ëndërruan të parët tanë, ashtu siç mbet në sytë e të vrarëve tanë, ashtu siç është aktualisht në peripecitë e përditshme të këtij populli që përballet me fukarallëk dhe veç këtij kryqi edhe me padrejtësi të shumta që shteti i ngarkon pa dashje në kurriz, apo i le ashtu sepse nuk di si të veprojë.

Jemi shtet i ri, janë shumë dukuri të reja, mjerisht një numër i madh i tyre negative, është një krize e përgjithshme sociale dhe mbetët të shpresojmë në një të ardhme më të mirë siç e paraqet edhe autori i këtij libri në një studim shumë të denjë për çdo njërin nga pushtetarët. Mendoj se nëse me këso hollësi e analiza do i futeshin problemeve aktuale (përgjegjësit ne sferat e caktuara), gjendja do ishte pak më e mirë. Nuk kërkojmë të pamundurën por së paku të ndihet prej atyre qe vazhdojnë sakrificën edhe sot e kësaj dite, atyre që presin në rend për tu punësuar, atyre qe jetojnë në kushte të varfërisë së skajshme, atyre që kanë emrat në gurët e këtij shteti tashmë.

“Sfidat e radhës” vërtetë sfida të radhës

Hajdar Muneka (Malajzi)

E kam lexuar me një frymë e me shumë vëmendje “Sfidat e radhës”, hedhur në letër nga miku im, publicisti i mirënjohur shqiptar Ibrahim Kelmendi. Me ndjenjën e përgjegjësisë qytetare të një njeriu tejet të angazhuar për vendin ku ka lindur, e të cilit i ka kushtuar të gjithë jetën e tij, autori e përshkruan Kosovën martire si një fëmijë të ardhur në jetë pas një pritje të gjatë, shumë të gjatë. Pas një shtegtimi të lodhshëm e shumë të mundimshëm, zana është kthyer pranë djemve në mrizin e saj. Por trupi i saj është drobitur e sfilitur nga rrebeshet e shumta dhe padrejtësitë e historisë së kohëve moderne. Trupi i saj delikat e plot varrë ka nevojë për shërim e përkujdesje të vazhdueshme. Vetëm djemtë e saj mund t’i japin nënës frymë, gjak e shpresë. Ta ruajnë që trupin e saj të mos e brejnë sëmundje të tjera si krimi ekonomik e politik, korrupsioni dhe anarkia.

Falë eksperiencës së tij të gjatë në mërgim, Ibrahimi sjell në kujtesën e lexuesve shembuj të shumtë pozitivë e negativë nga vendet ku ai ka punuar e jetuar. Ai e shtron si imperativ të kohës formimin e vetëdijes së individit për të krijuar e menaxhuar vetë shtetin e brishtë të Kosovës me standardet evropiane e ato botërore. Historikisht shqiptarët kanë qenë pjesë e pandarë e këtij realiteti. Libri përshkruhet nga ideja e moçme shqiptare se “ta mbash është shume më vështirë se sa ta fitosh”. Për Ibrahimin shprehja legjendë “Bac u kry”, nuk duhet t’i vërë njerëzit në gjumë. Baca pret shumë më tepër nga djemtë e shqipes kosovare e asaj mbarëshqiptare. Puna,

mundi e përkushtimi tani kanë filluar. Çdo tullë e vënë pa kujdes në themelet e kësaj ngrehine do të jetë me pasoja për të ardhmen tonë të afërt e të largët.

Trim është ai që din të falë, thotë Ibrahimi. Ky është një nga mesazhet më të rëndësishëm që autori kërkon ta përçojë tek lexuesit e për të cilin shoqëria kosovare ka nevojë më shumë se kurrë. Ai lëshon kushtrimin e shembjes së kullave të urrejtjes e dasive etnike, fetare e raciste. Ai vetë i ka falur të gjithë, edhe ata që e ndoqën dhe e persekutuan duke ia nxirë të gjithë jetën, edhe ata që pa asnjë bazë e fakt e akuzuan për vrasës e shpërdorues fondesh e besimi. Ka falur deri edhe UDB-ashët e Rankoviqit e të Millosheviqit. Atashimi në familjen evropiane kërkon tolerancë, mirëkuptim reciprok. Jeta është e barabartë dhe e shtrenjtë për të gjithë.

Libri "Sfidat e radhës" nuk është një rreshtim mekanik faktesh e ngjarjesh. Përkundrazi, shembujt në të janë sjellë për të ilustruar ide e rrugëzgjidhje reale të shumta që autori i tij vë në dorën jo vetëm të njerëzve të thjeshtë, por mjaft të vlefshme edhe për ata që marrin dhe ekzekutojnë vendime të rëndësishme shtetërore. Ai është shkruar me një gjuhë të thjeshtë, të pastër e shumë të spikatur për të gjitha shtresat e shoqërisë. Ne këtë libër çdo gjë mbetet e hapur. Titulli i tij i gjetur mjaft mirë tregon se shoqërinë kosovare e presin sfida edhe më të mëdha në të ardhmen dhe se periudha që ajo po kalon nuk është asgjë tjetër veçse një sfidë e radhës.

Tani e ka radhën shtet-ndërtimi

Ekrem Krasniqi (Bruksel)

'Dasma' e pavarësisë po merr fund. Tash ka ardhur koha e shijimit të saj nga banorët. Pushtetarët duhet urgjentisht t'i japin fund thellimit 9 vjeçar të problemeve të shumta e të përditshme, të cilat po e rëndojnë shumë cilësinë e jetës së kosovarëve.

Ky do të ishte thelbi i përmbajtjes së 'Sfidat e radhës' dhe porosia e autorit Ibrahim Kelmendi.

Autori prek problemet më të rënda dhe më urgjente të Kosovës dhe popullit të saj përmes ideve të tija tërheqëse për shtet-bërjen, zhvillimin demokratik dhe zhvillimin e ekonomik.

Brenda këtyre 3 kapitujve autori rendit mirë çështjet kyçe me të cilat vazhdon të përballet Kosova dhe kosovarët.

Idetë dhe sugjerimet e tija, aq sa tentojnë të ndihmojnë orientimet për pushtetin dhe tërë klasën e tashme politike për dalje nga kriza e madhe ekonomike që po vërshon Kosovën, po aq, në të njëjtën kohë, tingëllojnë si një lloj besimi nga ana e autorit se kjo gjeneratë politikanësh nuk po është në gjendje të gjej fillin e lëmshit të ngatërruar, që rezulton: Kosova të jetë vendi më i varfër në kontinentin evropian, për shkak të paaftësisë profesionale të saj për një gjë të tillë edhe përkundër 'dëshirës'.

Mirëpo analiza e sugjerimeve të Ibrahim Kelmendit, sidomos për dy kapitujt (zhvillimi demokratik dhe zhvillimi ekonomik) janë aq të thjeshta në shikim të parë sa që lexuesi mund të ketë dyshime nëse kjo gjeneratë politikanësh vërtetë është e përkushtuar për të ndryshuar gjendjen.

Pranimi apo perceptimi i korrupsionit masiv në Kosovë nga një pjesë e madhe e popullatës si një dukuri 'normale' është rreziku më i madh që i kanoset vendit, përkatësisht pikërisht kësaj popullate.

Autori me të drejtë shpreh shqetësimet e tija për këtë dukuri

vërshuese mirëpo ai duket se ka dëshiruar të mos sfidojë mungesën e përkushtimit të qeverisë (qeverive) për të mbajtur premtimet e tyre që nga përfundimi i luftës. Ai dëshiron të besoj se kjo klasë politikanësh janë të interesuar t'i japin fund gjendjes së mjerueshme ekonomike-sociale të kosovarëve dhe pazhvillimit të vendit, mirëpo përmbajtja e shkrimit sikur vë në dyshim sinqeritetin e institucioneve kosovare pa dëshirën e autorit.

Vetëm një gjendje e këtillë të perceptimit të 'profesionit të të korruptuarve', pushtetarët e dikurshëm, të tashëm dhe të ardhshëm do të mund të vazhdonin shkatërrimin e ekonomisë së Kosovës pa asnjë therrë në këmbë.

'Sfidat e radhës' duhet të shihet edhe nga një këndvështrim tjetër. E ai është pjesë e një segmenti të proceseve demokratike në të cilat synon Kosova: Nuk janë pushtetarët të vetmit ata të cilët mbajnë të drejtën e ideve dhe vendimeve për të ardhmen e vendit dhe banorëve të saj.

Individët, grupet, po ashtu kanë të drejtën të jenë pjesë e këtyre proceseve. 'Shoqëria civile', term ky i përdorur në kohën e sotme, duhet të ketë vendin e vet në debatin për të ardhmen e vendit, e jo vetëm institucionet të cilat deri më tash nuk ia prishin njëra tjetrës dhe vazhdojnë 'rehatinë', të shkëputur nga problemet e zgjedhësve të tyre edhe përkundër 9 viteve të mundimshme të varfërisë e pa-zhvillimit ekonomik e social.

Ide që presin të realizohen

Rexhë Iberdemaj (Gjermani)

Autori Ibrahim Kelmendi po i jep në dorë lexuesit edhe librin e tij "Sfidat e radhës".

Për ata që e njohin nga afër Kelmendin, paraqitja e tij me këtë libër nuk është befasuese, por e pritur. Ka mbi 20 vite që bashkëveprojmë, disa prej këtyre viteve në Lëvizjen Popullore të Kosovës. Asnjëri nga ne, më tepër se sa ai, nuk qe sulmuar nga sigurimet e ndryshme jugosllave, serbe dhe evropiane, por asnjë nga ne nuk do të kishte mundur t'i përballonte aq burrërisht ato sulme, pa u thyer asnjëherë para tyre. Megjithëse kisha përshtypjen se, sa më shumë e sulmonin, aq me shumë i rritej vullneti për punë, prapë se prapë ndihej se vuajtjet e tij shpirtërore kanë qenë shumë më të mëdha se sa kemi mundur t'i marrim me mend.

Njohja dhe puna e përbashkët, edhe pse jo për kohë të gjatë, me Jusuf Gervallen dhe Kadri Zeken, dhe veprimtaria e përbashkët për rritjen dhe forcimin e radhëve ilegale e çlirimtare, mbeten udhërrëfyese për të. Një rast tepër i veçantë në radhët ilegale të Kosovës.

Ibrahim Kelmendi me idetë, mendimet dhe veprimet e tij bënte që herë pas herë edhe brenda Organizatës të mos kuptohej drejtë dhe me kohë. Por kjo nuk e pengonte për të punuar dhe vepruar, meqë ishte thellë i bindur se, edhe pse ndonjëherë me vështirësi, prapë se prapë shumë ngjarje që bënë kthesa historike në Kosovë dhe viset tjera kanë në themel mendimet dhe veprimet e tij.

Për dallim nga shumë të tjerë, Ibrahim Kelmendi para së të merrte qëndrim mbi një çështje, ai paraprakisht bënte

analiza mirë e qetësisht të menduara me veten e tij dhe me shokë më të ngushtë, atëherë dhe vetëm atëherë, i paraqiste dhe i arsyetonte, që ne t'i vlerësonim. Sipas mendjeve, kush e vlerësonte si anarkist, i padisiplinuar, mendjemadh, vrasës, etj, por shumica e bashkëveprimtarëve e çmonim për të mençur, patriot, modest.

Të çudiste gjakftohtësia e tij se si i pranonte këto vlerësime e ç'vlerësime.

Libri "Sfidat e radhës" është vazhdimësi e filozofisë së tij politike, me qëllim kryesor, që ai të jetë i kuptueshëm dhe sa me i qartë për lexuesin, por edhe me porosi tejet të dallueshme, se punët e mëdha, jo rrallë, bëhen duke u marrë me punë të vogla.

Me shumë shembuj të qartë nga jeta e përditshme, nga ato gjëra që i kemi aq pranë e nuk ua dimë vlerën, por edhe në pamundësi t'i realizojë vetë, natyrshëm, si është në karakterin e tij, shpesh herë, tepër i çiltër, na bën thirrje që të bëhemi pjesë e mendimeve të tij, që këto të realizohen në praktikë, dhe atë për të vetmin qellim: Shtet-bërjen e Kosovës.

Ibrahim Kelmendi në "Sfidat e radhës" shtet-bërjen e sheh si një gjë të përgjithshme dhe njëkohësisht të veçantë, si detyrë mbi detyrat për secilin, me një shtrirje që nga shtëpiakja e deri të akademiku.

Edhe pse i vetëdijshëm për keqkuptimet e mundshme, idealizmi i tij, i një njeriu të përkushtuar deri në vetëmohim, e shtyn që të kërkojë angazhim dhe punë nga qytetarët, pushteti, gjykatat, OJQ-të, partitë, sepse me vete mban një frikë të brendshme, se ne, me gjithë sakrificat tona, dhe ndihmat e mëdha të Bashkësisë Ndërkombëtare, mund ta zgjasim shtet-bërjen e Kosovës.

Situatën e djeshme dhe të sotme në Kosovë i paraqet siç i sheh ai, po vetëkuptohet, nga këndvështrimi i tij, duke ofruar

mundësinë e debatit më përkrahës dhe kundërshtues. Këtë ia mundësojnë ndërthurjet, duke bashkuar në një shtjellim njohuritë e thella mbi zhvillimet shoqëroro-politike të shoqërisë shqiptare dhe atyre Perëndimore, në veçanti ato gjermane.

Ibrahim Kelmendi në "Sfidat e radhës" nuk ngurron t'i paraqesë problemet, e as t'i kritikojë shkaktarët e tyre, edhe pse jo gjithmonë deri në fund. Apostrofon Bashkësinë ndërkombëtare, pushtetin, partitë dhe qytetarët. Kjo për Kelmendin është maksimë jetësore. Shumë është i prirur të arsyetojë shkaktarët, gjithmonë për hir të qëllimit kryesor: Shtet-bërjes së Kosovës. Kjo e shtynë atë të falë dhe arsyetoj, edhe atëherë kur është i vetëdijshëm se për disa ngjarje e faktorë pjesëmarrës, faktet janë të shumta. Për të zbutur këtë "lëshim" të tij, ai me shembuj shumë të thjesht, por domethënës, na e freskon kujtesën me ngjarje të ndryshme nga e kaluara dhe e sotmja.

Mirëpo analizat e tij, filozofia e tij politike, situata historike dhe proceset e pakthyeshme, ia forcojnë bindjen se marrja e tepërt më të kaluarën e çfarëdo lloji qoftë ajo, merr energji dhe humb kohë në shtet-bërjen e Kosovës. Ai është thellë i bindur se faktori kohë është kryesori, duke na bërë thirrje që problemet që kanë ekzistuar e ekzistojnë, le të jenë fushë e specialistëve, organeve të specializuara shtetërore dhe kohës.

Sidomos, janë me vlerë idetë për zgjidhjen e problemeve ekonomike, energjetike, sistemit bankar, shëndetësor, të punësimit. Zgjidhjet që preferon ai janë shumë praktike dhe të realizueshme. Zgjidhja e tyre në bazë të modelit perëndimor, e sidomos atij gjerman, sigurojnë mirëqenie, zhvillim ekonomik dhe shtet-bërje më të përshpejtuar të Kosovës. Krijimi i një strukture të ekonomisë nacionale, të

cilën e kanë të gjitha vendet e zhvilluara, mbi bazën e të cilës do të behej më shpejt shtet-bërja e Kosovës, është jetike dhe e domosdoshme për autorin.

Ibrahim Kelmendi në "Sfidat e radhës", duke njohur në thelb angazhimin e mërgatës në të mirë të Kosovës, por edhe duke ndierë ftohtësinë shtetërore ndaj saj, kërkon riaktivizimin e saj në të mirë të vendit. Kjo duhet të jetë e dobishme për të dy palët, për Kosovën dhe për emigracionin. Ai, me gjithë optimizmin që shfaq tek organet shtetërore që do të ndihmojnë këtë riaktivizim, sidomos në aspektin e ndërsjellë ekonomik, në formë të investimeve, prapëseprapë nuk i përjashton nga përgjegjësia e vetorganizimit edhe mërgimtarët.

Shumë gjëra Ibrahim Kelmendi nuk i thotë deri në fund, jo pse nuk i di, as pse i mungon guximi, por pse i mbetet besnik idesë së tij se çdo gjë duhet thënë dhe shkruar në kohën e duhur. Ai më shumë dëshiron të provokojë mendimin e të tjerëve që të hapet debati mbi çështjet madhore që ka ngritur. E, besa, i ka ngritur guximshëm. Në rrethana normale, ky do të ishte një vizion politik për shtet-bërjen e Kosovës dhe zgjidhjen e shumë problemeve të shoqërisë kosovare. Për të realizuar këto ide në praktikë, Ibrahim Kelmendi nuk ka hapësirë vepruese politike, prandaj ia paraqet opinionit, i bindur thellë se, si në të kaluarën, edhe sot, edhe pse më vështirësi, këto do të gjejnë zbatim. Mbetet të shihet se sa do të jetë këtë herë pjesëmarrës në zbatimin e tyre.

Po të mos shkruante kështu, Ibrahim Kelmendi nuk do të ishte Ibrahim Kelmendi.

„Sfidat e radhës“ do sjell telashe të mëdha

Salih Kabashi

Librin tënd në tentative e kam lexuar. Kujtoj se po bën punë të madhe (nuk po e teproj), e cila do të të sjell pokështu telashe të mëdha. Ti po ua nxjerr çelet në lendinë të gjithëve. A pajtohem me gjithçka ke shkruar. Sigurisht jo. Por mund të them se je i fuqishëm në daravitjen e mjegullave të hiperoptimistëve tanë të dalldisur. Po bën mirë, pra, që po i bën budallenj këta “sevdalinjtë e Pavarësisë”, siç do t’i quaja unë.

Aktualisht jam vërtetë i zënë, por besoj se brenda dhjetë ditësh do të çlirohem pak e pastaj besoj se do të kesh diçka nga unë. Mik i dashur, kurajë!

Vetëm një revolucionar i përjetshëm mund të shkruajë diçka të tillë

Prof. A. Vinca (Prishtinë)

Për mungesë kohe nuk munda ta lexoj në tërësi tekstin tënd. Por i bëra, si thuhet, një lexim diagonal. M'u duk me shumë interes, përveç të tjerash, edhe ngaqë merresh me probleme konkrete të jetës së njerëzve në Kosovë e jo vetëm me "politikë të madhe". Vetëm një revolucionar i përjetshëm, siç është I. Kelmendi, që nga aktiviteti i tij shumëvjeçar ilegal dhe legal (pas vitit 1990, përkatësisht 1999), nuk ka realizuar asnjë privilegj, mund të shkruajë diçka të tillë. Edhe të jetuarit në Perëndim dhe njohja e realitetit politik, social e ekonomik të vendeve të zhvilluara demokratike evropiane si Gjermania, ta ka hapur, sigurisht, horizontin e vrojtimit të problemeve. Një problem i madh i Kosovës si shtet (fjalë që ende nuk mund të shkruhet pa tundimin për ta vënë në thonjëza), por edhe si shoqëri, është babëzia: mentaliteti i të pasuruarit, të grabiturit, të përfituarit. Mirë e ke vërejtur dhe trajtuar këtë problem. Për t'u lavdëruar është edhe marrja me probleme të imëta, pa të cilat nuk mund të funksionojë një shoqëri e organizuar dhe e qytetëruar. Shembulli i gruas nga Norvegjia, që pastron oborrin e shkollës dhe, madje, edhe nevojtoret është shumë instruktiv. Pikërisht kjo vetëdije na duhet ne. Por po të them se shitoret tona (të ashtuquajturat minimarkete) jo vetëm që s'i kërkojnë shishet e birrës, fjala vjen, nga konsumatorët, por edhe kur ndodh që klienti ua kthen ato pas përdorimit, refuzojnë t'i marrin. Jam dakord me vlerësimin që i bën trajtesës sate Shabani (Sinani). Ti i thua gjërat shkoqur dhe përpiqesh t'i vesh pikat mbi **i**, ashtu siç ndodh sot me pak njerëz në Kosovë dhe në diasporë. E përgëzoj Kelmendi për guximin dhe qëllimin e mirë.

Në zhvillimin e Suedisë, nga skamja në një shtet demokratik, kanë luajtur rol vendimtar lëvizjet popullore

Ulmar Qvick (shkrimtar suedez)

Kam lexuar deri tani vetëm listën e përmbajtjes, dhe jam i bindur se materiali juaj është me interes të madh. Ju keni prekur shumë faktorë me rëndësi në situatën e sotme të Kosovës dhe me rëndësi për të ardhmen.

Fatkeqësisht tani për tani më mungon koha për të studiuar imtësisht punimin Tënd. Barra e punës sime është shumë e madhe, për këtë duhet të "fajësojmë" bashkatdhetarët tuaj në Suedi! Po punoj përditë me përkthimin e dëftesave, diplomave, certifikatave, ankesave....

Për punë kulture nuk kam kohë! Kjo është e vërteta lakuriqe.

Një faktor që ndoshta duhet të studiohet më shumë në realitetin kosovar është puna e organizatave në bazë. Ju keni "NGO" edhe në Kosovë. Në zhvillimin e Suedisë, nga skamja në një shtet demokratik, kanë luajtur rol vendimtar lëvizjet popullore: kundër keqpërdorimit të alkoolit, për liri fetare dhe sidomos lëvizja punëtore. Dhe në një vend, ku njerëzit janë mësuar të kenë besim vetëm tek familja, fisi, ndërsa pushteti më përpara ka qenë në duart e armikut shekullor, ndërtimi i shoqatave lokale, rajonale dhe kombëtare, ku njerëzit bashkëpunojnë pa marrë parasysh përkatësinë familjare, shoqërore dhe politike, janë me rëndësi të madhe. Sigurisht disa organizata të tilla ekzistojnë edhe sot, por puna për të krijuar kushte teorike dhe materiale për mirëbesim, për zhdukjen e traditave të dëmshme, thjesht për të ardhmen demokratike, kërkojnë edhe më shumë. Ndoshta shqiptarët në mërgim mund të japin një kontribut të vlefshëm në këtë fushë, me atë përvojë që kanë fituar nga jeta në shtetet ku jetojnë. Vetëm kaq tani për tani!

Cila është sfida e radhës?

Fatos Aliu (Prishtinë)

Libri i ri, "Sfidat e radhës", i veprimtarit të dalluar të lëvizjes, Ibrahim Kelmendit, jep një pasqyrim të zhvillimeve të Kosovës së pasluftës, nga një këndvështrim i veçantë.

Lidhur me të arriturat e "pavarësisë" së Kosovës, mbeten të hapura shumë dilema e çështje, se kishim apo jo kapacitete të mjaftueshme të ndërtimit të shtetit, meqë, çështja "*Sui Generis"* e procesit të gjertanishëm politik për zgjidhjen e "statusit" politik të Kosovës, nuk doli nga trajtimi i Kosovës si çështje koloniale nga ish-Jugosllavia, që kërkon zgjidhje sipas parimit të vetëvendosjes dhe dekolonizimit, por tek modeli i ri kolonial - eksperimental. Rrjedhimisht, *Pavarësia a la Ahtisari* shihet si një realitet dhe arritje në kontekst të rrethanave ndërkombëtare, të mundësive dhe kapaciteteve shqiptare. Ky pozicionim edhe kuptohet, duke marrë parasysh zhvendosjen e kahershme të lëvizjes kombëtare nga programi i bashkimit kombëtar në atë për Republikën e Kosovës, pra, në kah të parcializimit të çështjes shqiptare, sidomos në vitet e 90-ta, pas shpërbërjes së Jugosllavisë.

Me librin paraprak, *Atentati*, autori ka përshkruar katrahurën e planifikuar, për zhvendosjen e binarëve të lëvizjes kombëtare, me vrasjen e veprimtarëve të shquar për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar, të vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Vlen të theksohet se Ibrahim Kelmendi nuk heziton të demaskojë sistemin e korruptuar piramidal të Kosovës, keqbërësit dhe krimin e organizuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë, rrjetën e riorganizuar e të sforcuar me Serbinë, implikimin e abuzuesve me autoritetin dhe shtetin, por edhe të japë sugjerimet për zhvillimet ekonomike, sidomos në fushën e energjisë dhe minierave të Kosovës, me disa kalkulime interesante, që provokojnë dhe sfidojnë shoqërinë dhe politikat inerte të

Kosovës, për t'u marrë më seriozisht dhe aktivisht, me vlerësimin, me shfrytëzimin dhe menaxhimin sa më racional dhe efektiv të resurseve të Kosovës, në mënyrë që të krijohet hapësirë për investitorët vendës nga të gjitha trojet dhe emigracioni.

Autori me të drejtë shpreh shqetësimin për heshtjen që i bëhet Konferencës së Bujanit, kësaj ngjarje historike, që themel kishte parimin e vetëvendosjes, që duhej potencuar më së shumti, sidomos pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, organizatës trashëgimtare të Luftës Antifashiste të LDB, krah të cilës ka luftuar edhe populli shqiptar në të gjitha trojet e veta shqiptare.

Tani çështja që ka mbetur pa përgjigje do të ishte: A do të jetë zbatimi i vetëvendosjes sfida e radhës, që edhe shqiptarët ta realizojnë aspiratën historike të bashkimit kombëtar?

Libër që meriton respekt

Prof. Nexhmedin Spahiu
(Profesor i lëndës "Politika e Vendeve të Ballkanit" në Universitetin e Prishtinës.)

Libri meton të jetë një program afatgjatë qeveritar. Natyrisht, për të qenë një program i plotë nevojitet të ketë edhe shumë fusha të tjera të jetës se një kombi që po lind. Gjithsesi, i tillë siç është, ky libër meriton respekt.

Ideja për Ushtrinë e Kosovës është pjesa më guximshme dhe më e qëlluar. Nëse Kosova nuk ka arritur të çlirohet vet, ajo as që do të arrijë të mbrohet vet. Krijimi i iluzionit në ketë drejtim do të mund të qonte klasën politike në aventura politike me pasoja katastrofale. Mospasja e një ushtrie reale domosdo e len një shtet pa sovranitet, por një sovranitet real për Kosovën është i tepërt të kërkohet tani. Madje në Ballkan, përveç Serbisë, e cila deri diku është sovrane, por që se shpejti as ajo nuk do ta ketë ketë sovranitet, të gjitha shtetet tjera në rajon nuk janë më sovrane. Pjesa formale e Ushtrisë (Gardës) sigurisht që duhet të ekzistojë për të bërë roje nderi para institucioneve shtetërore. Angazhimi i pjesëtarëve të TMK-së në detyra të këtilla, sigurisht që do t'ishte gjë më me mend dhe më me respekt për dinjitetin e atyre që morën pjesë aktive në çlirimin e Vendit, se sa pensionimi i tyre.

Merita kryesore e librit është se është nder të parët e këtij lloji dhe kësisoj duhet të shërbejë si nxitje për intelektualet për të menduar dhe punuar në ketë drejtim.

Ky botim u mundësua me ndihma financiare nga disa miq.

Për të gjithë miqt dhe qytetarët vullnetmirë, që duan të me ndihmojnë për ribotim, bashkë me vlerësime të reja që do rezultojnë nga debati, si dhe për libra të tjerë që po i përgatis për botim, do ju lutesha ta bëni përmes xhirollogaris sime bankare:

Raiffeisenbank në Prishtinë
Xhirollogaria: 1501030000582464

Ua shpërblefsha me të mira.

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

321(496.51)

Kelmendi, Ibrahim
Sfidat e radhës : (Kosova : rruga e mundimshme drejt shtetit) / Ibrahim Kelmendi. - Prishtinë : Epoka e Re, 2008. - 160 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-8503-1-5

Tirazhi: 10 000